
Shkurt 2017
Numri: 107
E përmuajshme

ETIKA

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Ta jetosh ISLAMIN pa e përdorur atë

PROGRESI
BOTIME

Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.

TË RINJ

Një kështillë
1001 mësime
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro






Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Editorial

بسم الله الرحمن الرحيم

I Dërguari i Allahut (a.s.), në një hadith fisnik ka thënë: *"Njerëzit e parë që do të gjykohen në Ditën e Kiametit janë këta:*

I pari është një njeri i rënë dëshmor. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'ia kujtojë mirësitë që ia pati dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do ta pyesë: "Atëherë, çfarë ke bërë kundrejt këtyre mirësive?" Ai do të thotë: "O Zoti im! Kam rënë dëshmor për Ty." Allahu do t'i thotë: "Gënjeve! Ti ke luftuar vetëm që të të thonë trim dhe kështu u tha për ty." Për atë jepet urdhër dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në Xhehenem.

I dyti është ai njeri që e mëson dijen, ua mëson atë të tjerëve dhe veçanërisht lexon Kuranin Fisnik. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'ia kujtojë mirësitë që ia pati dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do ta pyesë: "Atëherë, çfarë ke bërë kundrejt këtyre mirësive?" Ai do të thotë: "Kam mësuar dije. Dijen ua kam mësuar edhe të tjerëve dhe kam lexuar Kuran për Ty. Allahu do t'i thotë: "Gënjeve! Ti ke mësuar dije vetëm që të të thonë dijetar dhe ke lexuar Kuran vetëm që të të thonë lexues i Kuranit. Prandaj, kështu u tha edhe për ty." Për atë jepet urdhër dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në Xhehenem.

I treti është një njeri që Allahu i Lartësuar i ka dhënë pasuri. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'ia kujtojë mirësitë që ia pati dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do ta pyesë: "Atëherë, çfarë ke bërë kundrejt këtyre mirësive?" Ai do të thotë: "Të gjithë pasurinë time e kam harxhuar në rrugën Tënde." Allahu do t'i thotë: "Gënjeve! Ti e ke harxhuar pasurinë tënde vetëm që të të thonë bujar. Prandaj, kështu u tha edhe për ty." Për atë jepet urdhër dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në Xhehenem." (Muslim, Imare 152.)

Revista ETIKA

Shkurt 2017
VITI: XI
NUMRI: 107

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 340 6182

E-MAIL
rev.etika@gmail. com

WEBSITE
www.progresibotime.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni : 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur
se materialet e sjella në redaksi
pavarësisht nëse botohen apo jo
nuk i kthehen autorit. Koha e botimit
të një materiali përcaktohet
nga redaksia. Honoraret e shkrimeve
autoriale ose përkthimeve duhet të
vini t'i tërhiqni pranë
Shtëpisë Botuese "Progresi"
ose pranë zyrave të përfaqësimit
në Kosovë dhe Maqedoni.



Përmbajtja









5 **Marrëdhënia ndërmjet Islamit dhe të vërtetës**
Ahmet Tashgetiren

8 **Islami kërkon myslimanë**
Nuredin Jëlldëz

10 **Besim i përsosur dhe vepër e mirë**
Ali Riza Temel

13 **Dhënia në rrugë të Allahut dhe lëmosha sipas Pejgamberit (a.s.)**
M. Sami Ramazanollu

16 **Udhëzimi i Kuranit Fisnik dhe gjendja e njeriut**
Duran Ekizer

20 **Të udhëtosh do të thotë të kujtosh**
Edison Çeraj

24 **Frika**

25 **Sekreti i rinisë në moshë të thyer**



A nuk ka një kurë për autizmin? 28
Mikro Univers

Të kuptosh Kuranin, natyrën dhe historinë 30
Një Ajet

Mbështetja tek Zoti... si zogjtë! 32
Një Hadith

Es-Selam 40
Ilir Hoxha

Ismail Faruki 42
Personalitete botërore Islame

Mos punoni! Pushoni! 45
Idris Arpat

Katror, pastaj kub, më pas busull 46
Edison Çeraj

Këshilla drejtuar studentëve 48
Naim Drijaj

Unë jam një udhëtar i shkretë në rrugët e jetës 49
Mehmet Dinç

Cilat firma duhet të zgjedhim për veshjet tona? 52
Shefika Kaja Meriç







Marrëdhënia ndërmjet ISLAMIT DHE TË VËRTETËS

Ahmet Tashgetiren

Kur të bëhet fjalë për marrëdhënien me Islamin, të parashtrosh një pyetje si: "Ta përdorësh apo ta zbatosh Islamin?" – dhe ta shfaqësh "përdorimin e Islamit" si një alternativë në këtë pyetje, domethënë, të flasësh për përdorimin e Islamit kundrejt zbatimit të tij, me të vërtetë do të thotë të sjellësh në rendin e ditës një rrezik mjaft të madh. Marrëdhënia e pashkëputshme me Islamin sigurisht se është "zbatimi" i tij. Sigurisht se Islami ka ardhur për t'u zbatuar dhe përjetuar. Islami, si një tërësi e rregullave që Allahu Teala ia ka dërguar njeriut dhe si një shenjë e besimit dhe besnikërisë së dëlirë ndaj Allahut të Madhëruar, do të jetë shenjë e "besnikërisë ndaj Allahut Teala" e besimtarit aq sa përjetohet dhe zbatohet me sinqeritet.

Për këtë arsye, "sinqeriteti" është pranuar si një disiplinë shumë themelore në marrëdhënie me fenë. Allahu i Lartësuar kërkon nga besimtarët në Kuranin Fisnik që "ta zbatojnë fenë me sinqeritet ndaj Tij". Mirë, por çfarë do të thotë ta përdorësh fenë apo Islamin? Ta përdorësh fenë, me kuptimin më të qartë të saj, do të thotë që njeriu të mos e zbatojë atë për hir të Allahut Teala, por ta shndërrojë atë në material përfitimi të interesave vetjake. Siç është sinqeriteti një vepër e zemrës, edhe përdorimi i fesë për interesat vetjake është një devijim i saj. Pra, është një rrëshqitje dhe devijim i zemrës.

Feja, në të vërtetë e gjen vlerën e saj reale me pjekurinë shpirtërore edhe pse është një institucion që ka edhe dimensionin e sjelljeve me natyrën që i sistemon të gjitha marrëdhëniet e njeriut në këtë botë. Edhe hadithi fisnik i njohur i të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i cili fillon: "Veprat vlerësohen sipas nijeteve..." – standardin e cilësisë së çdo gjëje që e bëjmë ne e lidh me "nijetin – qëllimin – synimin", i cili është një vepër shpirtërore. Domethënë: Përse e bëre atë punë? Cili ishte qëllimi yt në kryerjen e asaj pune? Ndërsa fusha në të cilën hetohet nijeti

është shumë e qartë: "Kënaqësia e Allahut Teala, apo ndonjë hesap tjetër?"

Kënaqësia e Allahut është esenca e fesë, ndërsa të gjitha hesapet e tjera janë përdorim/shfrytëzim i fesë. Për shembull, "shtirja" shpreh një devijim shpirtëror për të cilin besimtari paralajmërohet me insistim në Kuranin Fisnik dhe në hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në mënyrë që të qëndrojë sa më larg saj. "Shtirja" është një hesap i tmerrshëm që bëhet për të parë dikush aktivitetet fetare, në mënyrë që të shfrytëzohen mundësitë, fama etj. Domethënë, të të shohin namazin, të të shohin agjërimin, të të shohin infakun, të të shohin xhihadin dhe të të thonë: "Bravo!" Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që një aktivitet fetar të mos e bësh për Allahun Teala, por për të fituar vlerësimin e njerëzve prej të cilëve pret edhe shpërblimin. Në Islam kjo vepër quhet "shirk i fshehtë". Domethënë, ky është një devijim i besimit që ka influencuar në zemër. Pra, është shoqërim ortakërie kundrejt Allahut të Madhëruar.

I Dërguari i Allahut (a.s.), në një hadith fisnik ka thënë: *"Njerëzit e parë që do të gjykohen në Ditën e Kiametit janë këta:*

I pari është një njeri i rënë dëshmor. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'ia kujtojë mirësitë që ia pati dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do ta pyesë: "Atëherë, çfarë ke bërë kundrejt këtyre mirësive?" Ai do të thotë: "O Zoti im! Kam rënë dëshmor për Ty." Allahu do t'i thotë: "Gënjeve! Ti ke luftuar vetëm që të të thonë trim dhe kështu u tha për ty." Për atë jepet urdhër dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në Xhehenem.

I dyti është ai njeri që e mëson dijen, ua mëson atë të tjerëve dhe veçanërisht lexon Kuranin Fisnik. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'ia kujtojë mirësitë që ia pati dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do ta pyesë: "Atëherë, çfarë ke bërë kundrejt këtyre mirësive?" Ai do të thotë: "Kam mësuar dije. Dijen ua kam mësuar edhe të tjerëve dhe kam lexuar Kuran për Ty. Allahu do t'i thotë: "Gënjeve! Ti ke mësuar dije vetëm që të të thonë dijetar dhe ke lexuar Kuran vetëm që të të thonë lexues i Kuranit. Prandaj, kështu u tha edhe për ty." Për atë jepet urdhër dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në Xhehenem.

I treti është një njeri që Allahu i Lartësuar i ka dhënë pasuri. Ai do të sillet në audiencën e Allahut. Allahu do t'ia kujtojë mirësitë që ia pati dhënë. Edhe ai do t'i pohojë ato. Allahu i Lartësuar do ta pyesë: "Atëherë, çfarë ke bërë kundrejt këtyre mirësive?" Ai do të thotë: "Të gjithë pasurinë time e kam harxhuar në rrugën Tënde." Allahu do t'i thotë: "Gënjeve! Ti e ke harxhuar pasurinë tënde vetëm që të të thonë bujar. Prandaj, kështu u tha edhe për ty." Për atë jepet urdhër dhe tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë derisa të hidhet në Xhehenem." (Muslim, Imare 152.)

Kur të bëhet fjalë për marrëdhënien me Islamin, të parashtrosh një pyetje si: ***"Ta përdorësh apo ta zbatosh Islamin?"*** *– dhe ta shfaqësh* ***"përdorimin e Islamit"*** *si një alternativë në këtë pyetje, domethënë, të flasësh për përdorimin e Islamit kundrejt* ***zbatimit të tij****, me të vërtetë do të thotë të sjellësh në rendin e ditës një rrezik mjaft të madh.*



Këtë hadith fisnik duhet ta lexojmë me shumë kujdes, në mënyrë që ta kuptojmë se sa ndjeshmëri e përpikëri duhet të shfaqim kundrejt dimensionit shpirtëror në ato që bëjmë e veprojmë përgjatë jetës sonë në këtë botë. Njeriu mendon se ka bërë xhihad, se ka sakrifikuar jetën e tij, se ka mësuar dije, se ua ka mësuar dijen njerëzve të tjerë dhe se e ka harxhuar pasurinë e tij në rrugë të Allahut Teala. Edhe në tubimin e madh që do të bëhet në Kiamet do të thotë në audiencën e Allahut (xh. xh.): "Këto i kam bërë për Ty." Por atij do t'i jepet përgjigjja: "Ti i ke bërë këto, në mënyrë që të të thonë hero, të të thonë dijetar dhe të të thonë bujar." Pastaj tërhiqet zvarrë me fytyrë për tokë dhe hidhet në Xhehenem.

Domethënë se rrëshqitja e zemrës e bëka njeriun të besojë se ai po i bëka këto "për hir të Allahut Teala", por ja që në të vërtetë, përparësi u jepet hesapeve vetjake. Domethënë se njeriu mund t'ia veshë dëshirave vetjake makijazhin "kënaqësia e Allahut".

Kur në Kuranin Fisnik flitet për klerikët e Ehli Kitabit / ithtarëve të librit (çifutët dhe të krishterët),

thuhet se ata i shesin/këmbejnë ajetet/argumentet e Allahut me diçka krejt të pavlerë" dhe se ata, me këtë vepër që bëjnë, nuk fusin gjë tjetër në barkun e tyre përveçse "zjarr". ***"Pa dyshim, ata që fshehin çfarë ka shpallur Allahu në Libër dhe e këmbejnë atë me diçka tjetër të pavlerë, do të gëlltisin në barkun e tyre vetëm zjarr. Në Ditën e Kiametit, Allahu nuk do t'u flasë atyre, nuk do t'i pastrojë*** *(nga gjynahet)* ***dhe do t'u japë dënim të dhembshëm."*** (Bakara, 174) Përsëri në Kuranin Fisnik thuhet se dijetarët e Ehli Kitabit kanë bërë manipulime me kuptimet e ajeteve të Allahut Teala:

"Në mesin e hebrenjve ka nga ata që i nxjerrin fjalët nga konteksti i tyre dhe i thonë Profetit: "Dëgjuam, por nuk të bindemi"! dhe "Dëgjo, mos dëgjofsh!" dhe "Ra'iná!", duke shtrembëruar (shprehjet) ***me gjuhën e tyre dhe duke shpifur për fenë. Po sikur ata të kishin thënë: "Dëgjuam dhe u bindëm!" dhe "Dëgjo!" e "Shikona neve!", kjo do të ishte më e mirë dhe më e drejtë për ata. Allahu i mallkoi ata për shkak të mohimit të tyre, prandaj ata nuk besojnë, përveç një numri të vogël."*** (Nisa, 46)

"Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhamed) ***përherë do ta vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit."*** (Maide, 13)

"O i Dërguari i Allahut! Mos u brengos për ata që zhyten shpejt në mosbesim, qofshin nga ata që me gojën e tyre thonë: "Besojmë", ndërkohë që zemrat e tyre nuk besojnë apo prej hebrenjve, të cilët trillimet i dëgjojnë shumë, (madje) ***dëgjojnë edhe ata që s'kanë ardhur te ti. Ata i ndryshojnë vendet e fjalëve*** (në tekstet e shenjta) ***dhe thonë: "Nëse*** (shpallja) ***ju është dhënë kështu, pranojeni e, nëse nuk ju është dhënë kështu, atëherë, ruhuni e mos e pranoni". Kur Allahu dëshiron ta lërë dikë në humbje, ti nuk mund të bësh asgjë për ta penguar Atë. Këta janë të asaj dore të cilët Allahu nuk dëshiron t'ua pastrojë zemrat. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në jetën tjetër ka ndëshkim të rëndë."*** (Maide, 41)

Edhe këtë ajet fisnik le ta lexojmë me vëmendje: ***"Me të vërtetë, një grup ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre*** (ndërsa e lexojnë atë)***, që ju të mendoni se ai farë leximi është prej Librit*** (që ka zbritur Allahu)***, kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit. Ata thonë: "Kjo që lexojmë është nga Allahu", por ajo nuk është nga Allahu. Ata flasin gënjeshtra për Allahun, duke qenë të vetëdijshëm për këtë."*** (Al Imran, 78)

Shembulli i Ehli Kitabit, për të cilin njoftohemi në Kuranin Fisnik, padyshim se nuk është një e dhënë historike. Çdo tip njeriu që përmendet, tregon orientimet e mundshme njerëzore që përbëjnë shembull për të gjitha kohërat. Në këtë mënyrë, tregohen orientimet e drejta dhe të devijuara të tyre. Nëse e analizojmë ajetin fisnik të mësipërm, e kuptojmë qartë se pikërisht ky është "përdorimi dhe shfrytëzimi i fesë". Përsëri në Kuranin Fisnik qortohet Ehli Kitabi në lidhje me "ngatërrimin e të vërtetës me të pavërtetën" dhe "fshehjes së të vërtetës": ***"O ithtarët e Librit! Përse e pështjelloni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?"*** (Al Imran, 71)


Të gjitha këto janë paralajmërime për besimtarët që jetojnë në kohëra të ndryshme. Ne nuk kemi rrugë tjetër përveçse marrëdhënien tonë me Islamin ta formojmë brenda kornizës së sinqeritetit e pastërtisë që kërkon Allahu i Madhëruar. Veprat shpirtërore kërkojnë një ndjeshmëri të lartë. Padyshim se çdo vepër që e bëjmë e ka një kundërvlerë shpirtërore. Besimtari nuk lejon që asnjë vepër e tij të fitojë një natyrë që mund të cilësohet si "shfrytëzim i fesë apo përdorim i fesë për interesa vetjake".

Një njeri që e shfrytëzon fenë me vetëdije patjetër duhet t'i bëjë vetes një "test besimi". Ndoshta ai mund të jetë prej atyre që e kanë bërë zot epshin e tyre. Njeriu është një krijesë që e shfrytëzon për interesat e tij edhe besimin ndaj Allahut (xh.xh.). Këtë lloj njeriu duhet ta shtjellojmë në një kategori të veçantë.

Ne le të shikojmë veten tonë! Ndërkohë që jemi besimtarë, ndërkohë që shqetësohemi për Ahiretin, ndërkohë që përpiqemi për të mos na shkuar veprat dëm në audiencën e Allahut Teala. Le të mundohemi që të mos jemi prej atyre të humburve për shkak të devijimeve shpirtërore. Gjithashtu le të përpiqemi që të mos ndëshkohemi në botën e përhershme duke na u thënë: Xhihadi nuk të është pranuar, sepse e ke bërë për shtirje. Dija nuk të është pranuar. Lëmosha nuk të është pranuar. Namazi nuk të është pranuar, etj.

Cilësia e marrëdhënies sonë me Islamin është shumë e rëndësishme, sepse është jetike. Për këtë arsye, duhet të përpiqemi që të mos futemi në telashe ditën kur raportet e zemrave tona të mbarten në mahsher.

ISLAMI
kërkon myslimanë



Nuredin Jëlldëz

Feja që kishin umetet e tjera para nesh ishte një fe e pastër siç është Islami sot. Feja që sot njihet me emrin Judaizëm, ishte një fe e vërtetë para se të shfuqizohej. Edhe Krishterimi ishte një fe e vërtetë. Që të dyja fetë kanë pasur librin e tyre të vërtetë. Edhe pejgamberët i kanë pasur pejgamberë të vërtetë. Ata që do t'u besonin atyre feve, do të hynin në Xhenet. Madje, kanë hyrë. Adhurimet e tyre ishin adhurime të sakta. Dhikri i tyre ishte dhikër i saktë. Faltoret e tyre ishin vende në të cilat adhurohej Allahu Teala. Kurbanet që i thernin ishin burim sevapesh për ata. Ata fitonin grada te Allahu i Lartësuar kur largoheshin nga njerëzit dhe shkonin nëpër shpella për ibadet. Ata që duronin fitonin dhe ata që luftonin bëheshin luftëtarë/dëshmorë. Çfarëdo që kemi ne dhe që e konsiderojmë fe, në këtë apo atë mënyrë, e kanë pasur edhe ata. Konceptet Xhenet, Xhehenem, Peshore, Sirat etj., i kanë pasur të njëjtë edhe ata.

Ndërsa sot nuk jemi në të njëjtën rrugë me ithtarët e atyre feve nisur nga aspekti i të qenët në rrugë të drejtë. Ne besojmë se ata janë krejtësisht në rrugë të gabuar. Madje, në një rrugë aq të gabuar saqë nuk mund të rregullohet. Madje besojmë se çifutët dhe të krishterët nuk janë qoftë edhe pak në rrugë të drejtë. As fetë e tyre dhe as librat që kanë në duar, për të cilët thonë se janë të zbritur nga Allahu, nuk kanë aspak pjesë nga e vërteta. Tashmë ato nuk ekzistojnë.

Këtë të vërtetë e dimë kështu dhe e besojmë pa kushte dhe komente. Ata i shohim si njerëz që kanë nevojë për udhëzim. Përse? Përse i shohim kështu ithtarët e atyre feve

të cilat besojmë se kanë qenë të vërteta? Fetë për të cilat po flasim, a nuk janë judaizmi i Musait, (a.s.) dhe krishterimi i Isait (a.s.)? Sigurisht se këtu ka një kontradiktë. Ne po flasim për dy fetë e vërteta të dy pejgamberëve të mëdhenj. Madje, po flasim për fetë për të cilat themi: "Edhe ato kanë qenë Islam".

Sot, ne si myslimanë nuk mund ta harrojmë asnjëherë një të vërtetë. Për shkak se nuk e kemi harruar këtë të vërtetë, jemi të ndryshëm me çifutët dhe të krishterët. Ajo e vërtetë është: Edhe të krishterët, edhe çifutët kanë futur në fenë e Allahut mendjen dhe dëshirat njerëzore. Edhe pse një pjesë të këtyre e kanë fshehur nën maskën e ibadetit, ata kanë formuar një judaizëm dhe krishterim në përputhshmëri të plotë me dëshirat dhe interesat e tyre. Ata asnjëherë nuk kanë thënë haptazi: "Ne po e lëmë fenë." Madje, kanë luftuar me ata që kanë shfaqur një sjellje të tillë. Për këtë arsye, kanë pohuar se janë çifutë dhe të krishterë të devotshëm. Ata kanë bërë faltore madhështore. Fetarinë që nuk e kishin në zemrat e tyre, janë përpjekur ta reflektojnë në grumbujt e gurëve të këtyre faltoreve. Në vend se të merreshin me të ardhmen e tyre, janë marrë me veprat e njëri-tjetrit. Fetarinë që nuk mundën ta përjetonin përgjatë natës duke adhuruar Zotin (xh. xh.) me përkushtim, u përpoqën ta përjetonin ditën nëpër faltore dhe e mashtruan veten e tyre me këtë.

Islami kërkon myslimanë. Ai nuk ka nevojë për rregullatorë. Njeriu i dorëzuar ndaj Zotit (xh.xh.), është mysliman, sepse Islam do të thotë dorëzim ndaj Allahut Teala.


Umetet para këtij umeti kanë bërë xhihad / kanë luftuar me ata që nuk ishin ithtarë të feve të tyre, por edhe ata vetë nuk kanë hezituar t'i përshtatnin fetë me dëshirat e tyre. Kur e shikonin veten në vështirësi, i komentonin ose i fshinin ajetet e librit që kishin në duart e tyre. Ndërsa rregullat që iu pëlqenin, i bënin parime të aprovuara. Ata që gjendeshin në krye si klerikë të fesë, punuan për ta. Edhe ata punuan për klerikët e fesë. Ata e kënaqën njëri-tjetrin dhe pandehën se fituan pëlqimin e Allahut. Ryshfetin që ia dhanë njëri-tjetrit e konsideruan si lëmoshë të dhënë në rrugë të Allahut. Ata ishin të lumtur me këto që bënë dhe pandehën se do të fitonin Xhenetin. Njerëzit i bënë zota klerikët e tyre. Edhe klerikët u shpërndanë atyre tapitë me garanci të Xhenetit. Në këtë mënyrë formuan një treg në të cilin ishte i kënaqur si ai që jepte, si ai që merrte. Si rezultat, e humbën fenë dhe ranë në shkatërrimin e përhershëm.

Ndërkohë që po fillonte ky fund i tmerrshëm, ata filluan të mos shikonin ndonjë problem në ndërhyrjen ndaj të gjitha dispozitave të Allahut Teala. Ndërkohë që duhej t'i nënshtroheshin fesë, shfaqën guximin për ta bërë fenë që t'u dorëzohej atyre. Ata e bënë këtë dhe e pëlqyen atë që bënë. Ata e duartrokitën njëri-tjetrin. Ndërsa ata që nuk e përkrahnin ecurinë, i vranë dhe i shkatërruan. Për tolerimin në fe, qoftë edhe individual, menduan se do të qëndronte aty ku filloi dhe pandehën se nuk do të kishte dëme duke thënë se është një dispozitë apo dy dispozita (duke menduar se është ndërhyrje e tolerueshme). Por ja që rezultati nuk ishte ashtu. Një bidat që konsiderohej i vogël në Kuds, u shndërrua në shirk derisa arriti në Stamboll.

Procesin e shfuqizimit të këtyre dy feve, ne si umet e mësojmë nga Kurani Fisnik dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Në këtë mënyrë, e shohim qartë përfundimin e ndërhyrjes në fenë e Allahut Teala edhe nëse bëhet me nijet të mirë. Padyshim se, edhe nëse funksionon ky proces, për Islamin nuk ka rrezik që të shfuqizohet dhe të sillet një fe tjetër. Nuk ka, elhamdulillah. Feja islame nuk do të shfuqizohet dhe nuk do të sillet ndonjë fe tjetër ngaqë njerëzit bëjnë ndërhyrje, por do të mposhten ata që bëjnë ndërhyrje. Ata që duan t'i japin formë të re fesë, do të arrijnë të ndikojnë vetëm te njerëzit që kanë përreth dhe te njerëzit që mashtrohen prej tyre. Feja islame nuk mund të dëmtohet deri në rrënjët e saj. Kjo e vërtetë është sihariq për sa i përket fesë sonë. Ndërsa si individë jemi të detyruar ta paguajmë çmimin e rënies në këtë proces. Për këtë arsye, deviza jonë që duhet ta njohim dhe ta mbrojmë është:

Islami kërkon myslimanë. Ai nuk ka nevojë për rregullatorë. Njeriu i dorëzuar ndaj Zotit (xh.xh.), është mysliman, sepse Islam do të thotë dorëzim ndaj Allahut Teala. Prandaj, mysliman do të thotë njeri i dorëzuar ndaj Allahut. Ata që nuk i dorëzohen Allahut Teala, do t'i dorëzohen shejtanit. Kështu ka qenë fundi i paraardhësve që janë përpjekur ta manipulojnë fenë.

BESIM I PËRSOSUR
dhe vepër e mirë



Ali Riza Temel

Besim do të thotë t'i konfirmosh dhe t'i pranosh bazat, të cilave u është vërtetuar në mënyrë absolute saktësia e tyre, që pejgamberët i kanë marrë nga Allahu Teala për t'ua predikuar njerëzve. Konfirmimi me zemër në besim është themelor. Ndërsa pohimi me gjuhë është i nevojshëm për ta njohur njeriun se është prej myslimanëve dhe nga përqasja për të punuar sipas atij besimi. Dijetarët e havarixhëve, shiave dhe mutezilëve kanë vënë edhe kushtin e veprës për vlefshmërinë e besimit.

Në qendrën e fesë ndodhet besimi. Të gjitha fushat e jetës fitojnë vlerë dhe kuptim sipas kësaj qendre. Mohimi i besimit është në mospërputhje me të kuptuarit.

Edhe pse ndërmjet dijetarëve myslimanë është çështje shumë e debatuar tema nëse vepra është apo jo një pjesë e besimit, askush nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim për faktin se ndërmjet besimit dhe veprës ka një lidhje mjaft të fortë nga këndvështrimi i tërësisë së jetës fetare. Sepse, besimi ndaj dispozitave bazë të fesë e bën të domosdoshëm sistemimin e jetës sipas atyre dispozitave. Reflektimi i besimit në jetë shikohet nëpërmjet veprës. Besimi e bën veprën më produktive dhe të kuptimtë. Ndërsa vepra është shkak për forcimin e besimit. Mendimi i dijetarëve të Ehli Sunetit, të cilët nuk e konsiderojnë veprën si një pjesë të besimit, nuk do të thotë se vepra është e parëndësishme dhe se mjafton vetëm pohimi me gjuhë. Ky mendim i Ehli Sunetit është vetëm për të refuzuar mendimin e havarixhëve dhe mutezilive, të cilët thonë se njeriu mund ta humbasë cilësinë e besimtarit për shkak të mangësisë së veprës. Për këtë arsye, ky mendim duhet të komentohet në këtë formë: "Përderisa një njeri vazhdon të besojë me zemër, ai duhet të konsiderohet besimtar."

Një njeri që e thotë shehadetin duke besuar, dome-

thënë, një njeri që i beson njësimit të Allahut Teala dhe i pranon e përvetëson profecinë e Muhamedit (a.s.) dhe bazat e Islamit që ai i ka marrë nga Allahu i Madhëruar dhe ua ka predikuar njerëzve, konsiderohet besimtar. Në këtë mënyrë, ai shpëton nga të qëndruarit e përhershëm në Xhehenem.

Çështja nuk është vetëm për të shpëtuar nga të qëndruarit e përhershëm në Xhehenem, por që njeriu të përparojë drejt përsosmërisë duke e ndërtuar veten moment pas momenti nën ndriçimin e shpalljes, të përparojë duke u përpjekur sa më shumë për ta fituar pëlqimin e Zotit (xh.xh.) dhe të arrijë pjekurinë e një "besimtari shembullor e të përsosur". Të mos harrojmë se kjo është e mundur vetëm nëse kemi një besim në gradën "jakin" dhe duke e zhvilluar e mbrojtur këtë besim me vepra të mira. Besimi pa vepra të mira është si pema pa fruta. Besimi i vërtetë është besimi që jep fryte në formën e veprave të mira.

Të thuash: "Besova." – është një shprehje vullneti. Njeriu hyn në kufirin e Islamit duke thënë shehadetin. Siç e bën nënshtetësia të domosdoshëm zbatimin e ligjeve të shtetit, edhe ai njeri që deklaron se është besimtar është i obliguar t'i zbatojë rregullat e Islamit në raport me mundësinë që ka. Ky zbatim i ligjeve të Islamit e tregon veten në praktikimin e tyre.

Një besim që nuk reflektohet në vepra përbëhet nga një pohim abstrakt. Vepra është specifika më e rëndësishme që e ndan filozofinë nga religjioni. Shkaku që pejgamberët janë më ndikues se filozofët është se ata kanë sjellë një sistem të lidhur me praktikën dhe një stil jete. Mbi të gjitha, ata e kanë zbatuar pikërisht vetë këtë sistem.

Jeta nga një këndvështrim është provim i nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.). Në fakt, ky është edhe qëllimi i krijimit tonë. Ky provim realizohet me vepër, madje, me veprën më të bukur. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: ***"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh."*** (Mulk, 2)

Për shkak të lidhjeve të forta që kanë me njëritjetrin, besimi dhe vepra e mirë janë përmendur bashkë në gjashtëdhjetë e dy vende të Kuranit Fisnik. Madje, disa dijetarë besimin e kanë konsideruar vepër të zemrës. Në përgjithësi besimi shpreh veprat në lidhje me zemrën, ndërsa Islami shpreh veprat në lidhje me trupin. Ndërsa adhurimi i Allahut Teala sikur e shikon Atë, është grada e Ihsanit.

Kur besimi të forcohet dhe të kthehet në një gjendje kënaqësie, edhe veprat nuk janë më të vështira. Si rezultat, bëhen të dëshiruara. Tri janë shenjat e një besimi që i është arritur shija dhe kënaqësia. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, e ka shprehur kështu këtë çështje: ***"Kush i ka tre gjëra, ai do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit. Të jetë Allahu dhe profeti (a.s) më i dashur se çdo gjë tjetër, ta dojë tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë kthimin në mosbesim, siç urren të hidhet në zjarr"*** (Tedrixhi Sarih, hadithi nr: 9.) Dashuria ndaj Allahut Teala dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), është e mundur vetëm duke vepruar në përputhje me pëlqimin e tyre. Ai që është i sinqertë në dashuri nuk heziton për t'i plotësuar kërkesat e atij që e do. Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Allahut (a.s.), asnjëherë nuk kërkojnë prej nesh gjëra që nuk mund t'i bëjmë dot, sepse ata na duan ne më shumë seç e duam ne veten tonë.



Vepra që kërkohet prej nesh nuk është një vepër e zakonshme, por një vepër e mirë, madje, më e mira. Të jetosh do të thotë të veprosh. Prandaj, e rëndësishme është që veprat të jenë të mira dhe të dobishme.

Vepra që kërkohet prej nesh nuk është një vepër e zakonshme, por një vepër e mirë, madje, më e mira. Të jetosh do të thotë të veprosh. Prandaj, e rëndësishme është që veprat të jenë të mira dhe të dobishme. Kur Allahu Teala flet për cilësitë e besimtarëve që do të shpëtojnë, shprehet: ***"Të cilët shmangen nga gjërat e kota dhe të padobishme."*** (Mu'minun, 3) Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Shenja që tregon se njeriu është myslimani i mirë, është lënia e gjërave të padobishme."* (Tirmidhi, Zuhd, 11.)

Harxhimi i kohës me vepra të padobishme në këtë botë ku kemi ardhur për t'u sprovuar nuk është një punë që mund ta bëjë një besimtar i vetëdijshëm. Për këtë arsye, të gjithë jetën e kësaj bote, e cila është sa një orë, duhet ta kalojmë nga fillimi e deri në fund me bindje dhe përkushtim ndaj Allahut të Madhëruar. Kjo botë është vendi i nënshtrimit ndaj Allahut Teala, ndërsa bota tjetër është vendi i shpërblimit. Këtu bëhet fjalë për besimtarin e përsosur. Ndërsa ata që nuk

e marrin seriozisht botën e përhershme, gjithmonë i pret pendimi. Vlerësimi i mundësive dhe shanseve që ka dhënë Allahu i Lartësuar duke e shndërruar të përkohshmen në të përhershme, do të ishte vepra më e zgjuar. Mirësitë prej të cilave njeriu nuk përfiton, nuk janë mëshirë por vështirësi. Llogaria është e pashmangshme në këtë botë dhe në botën tjetër. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Robi nuk mund të largohet nga audienca e Zotit Ditën e Kiametit pa u marrë në llogari për katër gjëra:*

-Ku e ka harxhuar jetën?

-Çfarë veprash ka bërë?

-Ku e ka fituar dhe shpenzuar pasurinë?

-Ku dhe si e ka vjetruar trupin?" (Tirmidhi, Kijamet, 1.)

Fetaria nga një pikëpamje është marrëveshje me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.). Pejgamberi ynë i nderuar ua ka marrë fjalën sahabëve të tij në çështje të ndryshme. Një herë mori fjalën prej sahabëve të nderuar për të "mos i shoqëruar ortak Allahut asnjë gjë, për të mos vjedhur, për të mos bërë imoralitet, për të mos e vrarë njeriun, të cilin Allahu e ka bërë të paprekshëm, përveçse kur të ketë ndonjë arsye të ligjshme, për të mos i vrarë fëmijët, për të mos shpifur tani dhe në të ardhmen dhe për t'iu bindur atij në çështjet e ligjshme". (Buhari, Iman, 11; Muslim, Hudut, 41; Tirmidhi, Hudut, 12.)

Problemet e myslimanëve gjithmonë kanë buruar nga dobësia në besim dhe mangësia në vepra. Myslimanët e parë, të cilët kishin besim të përsosur dhe vepra të mira, i gjunjëzuan armiqtë e fuqishëm në epokën e lumturisë dhe për një kohë të shkurtër mundësuan përhapjen e shpejtë të Islamit në shumë vende të botës.

Jetën është e mundur që ta shndërrojmë në adhurim me nijet të mirë dhe përpjekje. Qëllimi i përbashkët i myslimanëve është në mirësi. Edhe Allahu i Lartësuar dëshiron kështu: ***"Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t'ju mbledhë të gjithëve; Ai është i Fuqishëm për çdo gjë."*** (Bakara, 148) Në Islam është inkurajuar gara në fitimin me rrugë të lejuara, është lejuar gara për harxhimin në rrugë të duhura, është inkurajuar gara në marrjen e dijes e urtësisë dhe në të vepruarit me to. Një garë e tillë nuk është konsideruar zili, por është vlerësuar si ambicie pozitive.

Jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili është shembull për ne në çdo çështje, është aksion nga fillimi e deri në fund. Ai në përgjithësi i ka kaluar netët me Zotin (xh.xh.) dhe ditët me robërit. Përveç të tjerash, na ka këshilluar që ta mbjellim fidanin që kemi në dorë, edhe nëse është duke ndodhur Kiameti. Çdo vepër e mirë që bën njeriu është lëmoshë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: *"Njeriu duhet të japë lëmoshë për çdo nyje të tij në çdo ditë që ka dhënë Allahu:*

-Të pajtosh dy vetë është lëmoshë.

-Të ndihmosh dikë për të hipur në kafshën e tij apo t'i ndihmosh për të ngarkuar ngarkesën në kafshën e tij, është lëmoshë.

-Të thuash një fjalë të mirë është lëmoshë.

-Të largosh nga rruga ndonjë gjë që i shqetëson kalimtarët është lëmoshë. Të urdhërosh të mirën dhe të ndalosh nga e keqja është lëmoshë.

-T'i buzëqeshësh vëllait është lëmoshë." (Rijazu's-Salihin, Hadithi nr: 19, 124, 250.)

Njeriu i mençur nuk e harxhon kot kapitalin e jetës. Ai bën përgatitjet e duhura për ditët e ardhshme dhe jetën e përhershme. Po ashtu, nuk e kalon kohën me imagjinata dhe iluzione. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e përkufizon kështu njeriun e mençur dhe atë të mjerë: *"I mençur është ai që e sundon veten dhe që punon për jetën pas vdekjes. Ndërsa i mjerë është ai që shkon pas dëshirave të tij dhe shpreson prej Allahut gjëra boshe."* (Ramuz, 1/229.)

Një besim që nuk shndërrohet në vepra, por që përbëhet vetëm prej fjalëve, nuk të shpie te shpëtimi i vërtetë. Në këtë botë të sprovës besimi duhet të vërtetohet me vepra. Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik: ***"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu t'i dallojë ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë."*** (Ankebut, 2-3) ***"Atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri që do t'ua shlyejmë të këqijat dhe do t'u japim shpërblim më të mirë se puna që kanë bërë."*** (Ankebut, 7)

Njeriu fiton vlerë me veprën e tij. Siç ka thënë edhe Zija Pasha: "Njeriut i shihet puna, jo guna." Napoloni ka thënë: "Fjalët boshe janë sëmundje." Një njeri që nuk punon është si një makinë e dalë prej varrezave të makinave. Allahu Teala thotë: ***"Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar."*** (Nexhm, 39) ***"Thuaj: "Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë."*** (Teube, 105)

Përfundimisht, kuptimi i jetës dhe qëllimi i nënshtrimit ndaj Zotit është që të kemi një besim të përsosur, zbukurimi i këtij besimi me vepra të mira dhe fitimi i pëlqimit të Allahut Teala... Zoti (xh.xh.), na bëftë prej atyre që e arrijnë këtë! Amin!...

M. Sami Ramazanollu

Dhënia në rrugë të Allahut dhe lëmosha sipas Pejgamberit (a.s.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në disa hadithe fisnike të tij:

"Nëse i gjithë mali i Uhudit do të bëhej flori dhe do të ishte i imi, nuk do të më pëlqente që as një flori i vetëm të qëndronte qoftë edhe një natë te unë. Vetëm nëse është ndonjë flori i mbledhur për të paguar borxhin." (Buhari, Muslim)

*

"Kur ta paguash zekatin e pasurisë tënde, atëherë e ke shlyer (borxhin e zekatit) që e ke detyrim." (Tirmidhi, Ibn Maxhe)



Sa mirësi e madhe është t'i zbatosh urdhrat e Allahut Teala! Veçanërisht kryerjen e obligimit të zekatit, me të cilin gëzohen dhe gjallërohen të varfrit e shkretë. Në sajë të kryerjes së kësaj vepre, besimtarët do të futen në grupin e të lumturve në Ahiret siç do të arrijnë edhe prehjen shpirtërore në këtë botë.

*

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë: *"Nëse e paguan zekatin e pasurisë tënde, patjetër që e ke larguar të keqen (e asaj pasurie) nga vetja jote."* (Hakim)

Kuptimi leksikor i fjalës zekat është dëlirje dhe pastërti. Ndërsa në kuptimin terminologjik do të thotë që njeriu të ndajë një pjesë të caktuar nga pasuria e tij dhe t'ua japë atyre që e meritojnë. Ngaqë malli pastrohet në këtë mënyrë, është quajtur zekat.

Dispozitat e zekatit janë të shkruara në literaturën e jurisprudencës islame.

*

I Dërguari i Allahut, (a.s.) thotë: *"Ruajuni nga zjarri duke dhënë si lëmoshë qoftë edhe një pjesë të një hurme. Nëse nuk e keni edhe këtë, ruajuni nga zjarri me fjalë të bukura dhe gjuhë të ëmbël."*

"Lëmosha patjetër e shuan zemërimin e Zotit dhe e parandalon vdekjen e keqe." (Tirmidhi)

*

"Kur njeriu ta sigurojë jetesën e familjes së tij duke shpresuar sevap për këtë, kjo është një lëmoshë për të. (Domethënë, atij i shkruhet sevap lomëshe)." (Buhari, Muslim)

*

"Kur të dëshirosh të japësh lëmoshë, mos e vono!"

*

"Kur njeriu të vdesë, i ndërpriten veprat. (Domethënë, nuk i ngelet gjë për të bërë sevap apo mëkat.) *Përveç në këto tri raste:*

*1- Sadakatu'l-xharije, lëmosha që rrjedh gjithmonë (*që vazhdon edhe pas vdekjes si ndërtimi i një çezme, xhamie, shkolle etj.).

2- Dija e dobishme që i vazhdon ndikimi e begatia edhe pasi njeriu të vdesë (ngaqë ka edukuar nxënës dhe ka bërë libra të dobishëm).

3- Fëmija i mirë që lutet për prindin pasi ai të jetë shpërngulur për në Ahiret." (Buhari, Muslim)

*

"Lëmosha më e mirë është t'u japësh ujë të tjerëve." (Ahmed ibn Hanbel)

*

"Nëse robi jep lëmoshë një dirhem përgjatë jetës së tij është më mirë se njëqind dirhemë që mund t'i japë në momentin e vdekjes." (Ebu Davud)

*

"Lëmosha që jep një mysliman, ia shton jetën atij dhe e mbron nga përfundimi i keq."

*

"Lëmosha parandalon shtatëdhjetë lloj belash. Më e lehta prej këtyre është sëmundja e zgjebes."



Eban ibn Saidi (r.a.)

PREFEKTI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.), NË BAHREJN

Mustafa Erish

Eban ibn Saidi, (r.a.), ishte prefekti i Bahrejnit që u emërua nga ana e të Dërguarit të Allahut (a.s.)...

Ai ishte personi që e priti si mysafir Osmanin (r.a.), kur shkoi si i dërguar në Mekë ditën e Hudejbijes...

Ai ishte personi që e mori në mbrojtje Osmanin, (r.a.), duke shfaqur një sjellje heroike kundrejt politeistëve, edhe pse akoma nuk ishte bërë mysliman.

Eban ibn Saidi (r.a.), lindi dhe u rrit në një familje politeiste në Mekë. Babai i tij që njihej me llagapin Ebu Uhajha, ishte prej parisë së mushrikëve / politeistëve. Prejardhja e Eban ibn Saidit (r.a.), bashkohet te Abdimenafi me prejardhjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Eban ibn Saidi (r.a.) ishte biri i hallës së Ebu Xhehlit. Për këtë arsye, njihej për armiqësinë që kishte ndaj Islamit. Vëllezërit e tij Amri dhe Haliti u nderuan me Islamin dhe bënë hixhret për në Abisini. (Usdu'l-Gabe, I, 35.) Ndërsa Ebani luftoi kundër myslimanëve në Luftën e Bedrit bashkë me vëllezërit e tjerë të tij, Asin dhe Ubejden. Vëllezërit e tij u vranë në këtë luftë. (el-Isabe, I, 10.)

Para se Eban ibn Saidi (r.a.), të bëhej mysliman, gjendej pranë kundërshtarëve të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Megjithatë, bënte kërkime rreth fesë dhe Pejgamberit të fundit.

Eban ibn Saidi (r.a.), ishte prej tregtarëve të rëndësishëm të Kurejshëve. Ai shkonte shpesh në Sham, vend i cili ishte qendër e tregtisë dhe dijes. Një herë u takua me një prift në Sham. Kur prifti e kuptoi se ai ishte prej Kurejshëve, menjëherë i tha:

"Feja dhe Pejgamberi i fundit do të dalin në vendin e Hixhazit. Ky Pejgamber do të ndjekë gjurmët e Isait dhe Musait në rrugën e Allahut." Nisur nga këto fjalë, Eban ibn Saidi e pyeti për emrin e këtij personi. Prifti i tha: "Muhamed." Pastaj i tregoi Ebanit për disa cilësi të pejgamberit që do të dërgohej. Pasi Ebani i dëgjoi këto fjalë, i tha priftit: "Këto cilësi që i the gjenden të gjitha te ai person." Nisur nga kjo, prifti i tha: "Pushteti i këtij personi nuk do të përfshijë vetëm vendet arabe, por të gjithë botën." Pastaj shtoi edhe këto: "Kur të kthehesh në vendin tënd, shko te ai, jepi selam prej meje dhe shfaqi respekt nga ana ime!"

Zemra e Eban ibn Saidit (r.a.), u përgatit për dritën e Islamit. Kur u kthye në Mekë, tashmë kishte ndryshuar. Tashmë nuk i kishte ngelur më asgjë nga armiqësia e vjetër kundrejt Islamit dhe myslimanëve. (Usdu'l-Gabe, 1, 36.) Por për pak kohë jetoi me ato baticat-zbaticat shpirtërore të tij. Më së fundi, pas Hudejbijes u nderua me Islamin. (el-Istiab, 1, 35.) Ai mori pjesë ndërmjet Kurejshëve edhe në luftën e Uhudit. Dritën e Islamit e arriti vetëm pas Hudejbijes.

Eban ibn Saidi, (r.a.), shfaqi një sjellje heroike të paharrueshme kundrejt politeistëve në periudhën e xhahilijetit. Ai pati shfaqur një trimëri që nuk mund ta shfaqte çdokush.

I Dërguari i Allahut (a.s.), para marrëveshjes së Hudejbijes, pati dërguar në Mekë Osmanin (r.a.), për të diskutuar me të parët e Kurejshëve. Ja, pikërisht në atë kohë, Eban ibn Saidi, i cili akoma nuk ishte bërë mysliman, e mori nën mbrojtjen e tij Osmanin, (r.a.). (el-Istiab, I, 35.) Atij i pati dhënë mbështetje duke i thënë: "Mos hezito për të bërë çfarëdo që të duash!" Ngjarja ndodhi kështu:

"I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ditën e Hudejbijes deshi të dërgonte një lajmëtar për t'ua shpjeguar politeistëve mekas se

cili ishte qëllimi i ardhjes së tyre në Mekë. Në fillim thirri Omerit (r.a.) dhe diskutoi me të. Omeri, (r.a.), e shprehu kështu mendimin e tij:

"O i Dërguari i Allahut! Politeistët Kurejshë e dinë se sa armik jam unë me ta dhe se sa ashpër sillem kundrejt tyre. Megjithëkëtë, nëse dëshiron që të shkoj unë, jam i gatshëm të shkoj."

Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk tha asnjë gjë dhe heshti. Omeri (r.a.), vazhdoi: "Unë mund të të tregoj dikë që është më ndikues se unë te mekasit për këtë punë. Përveç të tjerash, ai ka atje edhe familjen dhe shumë njerëz që mund ta mbrojnë. Ai është Osman ibn Affani."

Ky mendim dhe opinion u pranua nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Për këtë arsye, e thirri Osmanin, (r.a.), dhe i tha se donte ta dërgonte si lajmëtar te Kurejshët. Pastaj e urdhëroi:

"Shko te Kurejshët! Shko te ata dhe lajmëroji se nuk kemi ardhur për të luftuar me asnjë. Ne kemi ardhur vetëm për të vizituar Bejtullahun / shtëpinë e Allahut dhe për të madhëruar shenjtërinë e saj. Pastaj do të presim devetë që kemi me vete për kurban dhe do të kthehemi. Pastaj ftoji ata edhe në Islam!" (Musned, IV, 324; Ibn Sa'd, II, 97; Vakidi, Megazi II, 600.)

Pastaj i tha edhe këto:

"Takohu me burrat dhe gratë besimtare në Mekë. Njoftoji ata për përgëzimin e çlirimit të afërt të Mekës, për faktin se Allahu i Lartësuar do ta ndihmojë fenë e Tij dhe për ditën e afërt në të cilën besimi në Mekë nuk do të fshihet, por do të nxirret në pah!" (Ibn Kajjim, Zadu'l-Mead, II, 137.)

Osman ibn Affani, (r.a.), u ngrit dhe shkoi deri në Beldah. Politeistët kurejshë i gjeti aty. Ata e pyetën: "Çfarë dëshiron të bësh?" Ai u tregoi kështu:

"I Dërguari i Allahut (a.s.), më ka dërguar te ju. Ai ju fton në Islam. Padyshim se Allahu do ta përhapë fenë e Tij dhe do ta nderojë Pejgamberin e Vet! Për këtë arsye, mos jini ju ata që do t'i dilni kundër atij në këtë çështje! Nëse të tjerë përveç jush i dalin kundër atij dhe fitojnë, kjo është ajo që dëshironi edhe ju. Në këtë mënyrë, u plotësohet edhe dëshira që keni. Por nëse Muhamedi, (a.s.), fiton kundrejt atyre, atëherë ju jeni të lirë. Ose mund të hyni në fenë që po hyjnë njerëzit, ose mund të luftoni. Por mos harroni se luftërat ju kanë dobësuar dhe ju kanë dhënë shumë humbje. Ato i kanë marrë dhe i kanë fshirë shumë njerëz të zgjedhur prej jush!"

Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut (a.s.), ju njofton se ai nuk ka ardhur për të luftuar me asnjërin prej jush këtu, por vetëm për të bërë umre. Me vete ka edhe deve për kurban. Ai do t'i therë ato dhe do të kthehet pas!" (Musned, IV, 324; Ibn Sa'd, Tabakat, II, 97.)

Zemra e politeistëve paganë nuk u zbut në asnjë lloj mënyre. Pasi e dëgjuan Osmanin (r.a.), i thanë:

"I dëgjuam ato që the. Këto nuk do të ndodhin asnjëherë. Ai nuk do të vijë dhe të hyjë në Mekë. Prandaj kthehu te zotëria yt dhe lajmëroje që të mos afrohet te ne!"

Eban ibn Saidit (r.a.), i shpërtheu damari i farefisërisë. Ai shkoi drejt Osmanit (r.a.) dhe i shfaqi atij respekt duke i thënë: " Je i mirëpritur në mesin tonë!" Pastaj e mbështeti duke i thënë: "Mos hezito të bësh çfarëdo që të duash!" Ebani e mori Osmanin (r.a.), nën mbrojtjen e tij. Zbriti nga kali dhe e hipi Osmanin (r.a.), në të. Pastaj vetë hipi te vithet e kalit. Në këtë gjendje shkuan deri në Mekë.

Osmani, (r.a.), qoftë në Beldah apo qoftë në Mekë u takua një për një me mushrikët si Ebu Sufjani, Safvan ibn Umejje e të tjerët dhe bisedoi me ta. Që të gjithë e refuzuan propozimin e Osmanit (r.a.). Pastaj shkoi dhe u takua me shumë burra dhe gra besimtare të dobëta e pa mbrojtës në Mekë. Atyre u dha sihariqin e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, duke u thënë:

"I Dërguari i Allahut, (a.s.), ju përgëzon me çlirimin e Mekës! Tashmë mbi ju ka rënë hija e ditës në të cilën nuk do të fshihet, por do të nxirret në pah besimi në Mekë!" Edhe ata i thanë: "Bëji shumë selam të Dërguarit të Allahut nga ne! Allahu që e ka sjellë atë deri në Hudejbije, mund ta fusë edhe brenda në Mekë!" (Vakidi, Megazi, II, 601; M. Asim Këksall, Historia Islame, vëll. 5, fq. 291-292.)

Menjëherë pas marrëveshjes së Hudejbijes Eban ibn Saidi (r.a.), u bë mysliman. Kur vëllezërit e tij Amri dhe Haliti u kthyen nga Abisinia, bashkë me ata shkoi në Medine.

Në vitin e shtatë të hixhretit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e emëroi Eban ibn Saidin (r.a.), si komandant të një njësie ushtarake dhe e dërgoi në anën e Nexhdit. Ebani dhe shokët e tij u kthyen me fitore nga kjo betejë. Pastaj të gjithë së bashku shkuan në Hajber për të marrë pjesë në çlirimin e tij. Por kur ata arritën, Hajberi ishte çliruar.

Edhe pse Ebani dhe shokët e tij kërkuan pjesë nga plaçkat e luftës së Hajberit, një grup sahabësh, ndër të cilët gjendej edhe Ebu Hurejra, dolën kundër kërkesës së atyre me justifikimin se nuk kishin qenë prezentë në luftë. Për këtë arsye, atyre nuk iu dha asgjë nga plaçka e luftës. Kjo praktikë është argument se ata që nuk marrin pjesë në luftë nuk mund të përfitojnë asgjë nga plaçka e luftës.

Edhe pse transmetohet se Eban ibn Saidi (r.a.), ka rënë dëshmor në luftën e Jermukut në vitin 636 të erës sonë, transmetimi tjetër se ai ka rënë dëshmor bashkë me vëllezërit e tij Amrin dhe Halitin në luftën Exhnadejn (viti 634) në kohën e Ebu Bekrit, (r.a.), është më i fortë.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Zoti (xh.xh.), na bëftë prej atyre që marrin pjesë nga heroizmi dhe dashuria e tij! Amin!



Udhëzimi i Kuranit Fisnik dhe gjendja e njeriut

Duran Ekizer

Kurani Fisnik e shpreh me një metodë mjaft të shkëlqyer dhe gjuhë të prerë se ai vetë është udhërrëfyes në udhëzim për njerëzimin: ***"Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira..."*** (Isra, 9) ***"Elif Lâm Ra. Këtë Libër ta kemi shpallur ty*** (o Muhamed)***, për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë..."*** (Ibrahim, 1-2) Edhe në ajetet e tjera të ngjashme me këto, me fjalën "errësira" është synuar shirku dhe kufri. Ndërsa me fjalën "dritë" është synuar siratu'l-mustekim / rruga e drejtë, domethënë, rruga e vetme që Allahu Teala ia ka zbritur njerëzimit, Islami.

Përsëri Kurani Fisnik, i cili na tregon se stili i jetës dhe forma e të lexuarit që ka vendosur Islami, i cili në disa ajete përsëri shprehet në formën "siratu'l-mustekim", me të njëjtën shprehje të bukur na njofton se Islami është përngjarë edhe me një rrugë. Sepse kuptimi leksikor i fjalës "sirat" është "rrugë e gjerë". Islami, në ajetin/lutjen: ***"Na udhëzo në rrugën e drejtë!"*** - të cilën e themi disa herë në ditë dhe për të cilën i lutemi e i përgjërohemi Zotit (xh.xh.), që të na udhëzojë, i është përngjarë "rrugës". Për këtë arsye, nuk është përmendur vetë Islami, por është përmendur fjala "sirat" që është gjëja me të cilin është përngjarë Islami. Në këtë mënyrë, gjerësia dhe përfshirja e gjithanshme që gjenden në këtë fjalë, pra, theksimi i këtyre cilësive të Islamit, janë bërë në një formë letrare. Nëse kalojmë përtej këtyre shpjegimeve gjuhësore dhe përpiqemi për ta kuptuar këtë ajet, mund të nxjerrim këtë të vërtetë nën dritën e të dhënave që u shprehën pak më parë: Islami është një sistem hyjnor që mund të flasë në çdo fushë të jetës, që mund të vendosë një metodë dhe mënyrë jetese në të gjitha fushat që kanë lidhjen me njeriun dhe që i përfshin të gjitha kohërat e vendet. Në këtë sistem gjendet edhe ana materiale, edhe ana shpirtërore. Ndërmjet këtyre të dyjave nuk ka ndonjë ndarje, përkundrazi, ka një përshkrim të ekzistencës që mund të njihet dhe perceptohet me udhëzimin e Zotit të Madhëruar, i Cili është krijuesi i materiales dhe shpirtërores. Kuptimi leksikor i fjalës "mustekim" që përdoret pranë fjalës "sirat" në këtë ajet, është i – e drejtë. Kjo fjalë është mbiemri i fjalës "sirat". Sepse çdo rrugë nuk është e drejtë. Për këtë arsye, ka vetëm një rrugë të drejtë. Përdorimi i fjalës "mustekim", shpreh se kjo rrugë gjithmonë është e drejtë dhe se absolutisht nuk ka devijime në të. Domethënë, kjo është rruga e vetme që të shpie te synimi.

Kurani Fisnik shprehet se të gjitha rrugët përveç "siratu'l-mustekimit" nuk të shpien te udhëzimi, sepse, shkenca e historisë na ka treguar se, të gjitha llojet e sistemeve të tjera që njeriu i ka formuar duke e lënë në plan të dytë Allahun Teala, e kanë zvarritur njerëzimin drejt shkatërrimeve. E vërteta e hidhur në planin e pasmë të këtij realiteti lidhet me faktin se njerëzimi e ka bërë veten zot. Pastaj ka nxjerrë idhujt dhe lidhja

e tyre me to është bërë një sistem besimi. Nuk është mjaftuar me kaq, por është përpjekur për t'ua imponuar të gjithëve pranimin e atyre idhujve. Për këtë arsye, Allahu Teala thotë duke i kundërshtuar të gjitha këto: ***"Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij..."*** (En'am, 153)

Historia e njerëzimit mund të themi se është historia e lidhjes së njeriut me Zotin e tij dhe historia që tregon të vërtetën nëse njeriu e ka mbajtur apo jo këtë lidhje me Atë. Kjo e vërtetë, pra, lufta ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës, gjithmonë ka qenë e pranishme në historinë e njerëzimit. Pra, udhëtarët e rrugës së drejtë janë ata që e përkujtojnë Allahun Teala në çdo fushë të jetës së tyre dhe që e sistemojnë materialen e shpirtëroren sipas fesë që ka sjellë Ai. Ndërsa pasuesit e rrugës së humbur janë ata që zgjedhin një rrugë në kundërshtim me këta të parët dhe që nxjerrin një sistem jete sipas epsheve dhe dëshirave të tyre duke e refuzuar Allahun Teala. Kjo luftë e cila ka filluar që nga njeriu i parë dhe ka arritur deri në ditët e sotme, në çdo periudhë është shfaqur në kushte dhe rrethana të ndryshme. Shembujt për këtë janë shprehur në shumë ajete të Kuranit Fisnik. Për shembull, këtë e dëshmojmë edhe në luftën ndërmjet Ademit (a.s.) dhe shejtanit, sepse shejtani doli kundër urdhrit të Allahut Teala. Pastaj e vuri veten e tij në qendër, e harroi Krijuesin e tij, hyri në një kauzë epërsie dhe shfaqi injorancën për të nxjerrë veten në pah: ***"Ai u përgjigj: "Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta".*** (A'raf, 12) Sipas tij, kjo ishte diçka e drejtë dhe ai i besoi asaj që pandehte se ishte e drejtë. Ai e formoi këtë besim dhe si rezultat e kundërshtoi urdhrin e Krijuesit të tij. Për këtë arsye, zbriti në gradën e një krijese të mallkuar dhe u nxor nga mëshira hyjnore.

Islami është një sistem hyjnor që mund të flasë në çdo fushë të jetës, që mund të vendosë një metodë dhe mënyrë jetese në të gjitha fushat që kanë lidhjen me njeriun dhe që i përfshin të gjitha kohërat e vendet. Në këtë sistem gjendet edhe ana materiale, edhe ana shpirtërore.



Pas kësaj shohim Nuhun (a.s.). Lufta që bëri Nuhu (a.s.), i vetëm me njerëzit e prishur që e kishin vënë shirkun në bazën e sistemit të jetës së tyre. Kjo luftë përmendet shpesh në Kuranin Fisnik dhe prej saj na jepen shembuj, në mënyrë që të udhëzohemi.

Ndërsa në ditët e sotme po shikojmë shfaqjen e ndryshme të të njëjtit realitet. Bota sot, në sajë të teknologjisë së komunikimit, është bërë si një fshat i vogël. Ndërsa faktorët që e formojnë jetën dhe e caktojnë rendin tonë të ditës, për fat të keq, janë në kundërshtim me Islamin. Sot, në dorën e të gjithëve, gjenden telefona që e kanë kaluar të qenët mjet komunikimi dhe janë bërë droga moderne duke e preokupuar njeriun me gjëra të pavlera. Veçanërisht rinia (duke i përjashtuar ata që i përdorin në punë të dobishme), për shkak të disa rrjeteve sociale e çon dëm kohën në një botë virtuale. Për këtë arsye, ka thurur një mur të madh ndërmjet vetes dhe Krijuesit që ia ka falë kohën. Madje, edhe në muajin e Ramazanit tashmë po përjetohen shumë devijime në emër të dukjes dhe brendësia e vlerave që e bëjnë njeriun njeri po zbrazet nga dita në ditë. Përshpirtja e ka humbur vlerën dhe dukja ka dalë në plan të parë. Edhe te klasat fetare, opinionet në kundërshtim me Islamin pothuajse kanë fituar një rëndësi si ajo e besimit.

Fëmijët tanë nëpër shkolla, pra, në periudhën e jetës së tyre më produktive dhe kritike, po përpiqen me mish e me thua për të mësuar sa më shumë, në mënyrë që të kenë një pozitë më të kënaqshme nga aspekti material në jetën e tyre të ardhshme. Brezat që po gjenden në këtë garë po shkojnë nga një provim në tjetrin dhe si rezultat i kësaj po i konsiderojnë shokët si rivalë të tyre. Kjo gjendje mund të tolerohet deri në një pikë. Por sidoqoftë, në këtë çështje duhet të përdoren këto shprehje: "O nëna dhe baballarë myslimanë! A i japim rëndësi zhvillimit të përshpirtjes së fëmijëve tanë siç i japim rëndësi zhvillimit të tyre në shkencat pozitive? A e shfaqim të njëjtin interesim ndaj fëmijëve tanë, në mënyrë që ata të fitojnë vetëdijen e namazit siç e shfaqim për pikët që do të marrin në filan provim? Po të kishim në dorë një mjet që mat përshpirtjen, vallë, sa pikë do të merrnim ne në fillim dhe pastaj fëmijët tanë? Si do të jetë përgjigja jonë kur Allahu Teala të na marrë në llogari për sa i përket çështjes së detyrës si prindër? Për shembull, sa pikë mund të marrin fëmijët tanë në mësimet si drejtësia, ndershmëria, altruizmi, lëmosha, dhikri, marrja e vetes në llogari etj.?

Këtë të vërtetë nuk duhet ta harrojmë asnjëherë: E vërteta është një dhe poseduesi i kësaj të vërtetë është Allahu Teala, i Cili e ka quajtur veten el-Hakk. Islami, të cilin e ka zbritur Ai dhe i cili është tërësia e urdhrave hyjnorë që është shpjeguar në Sunetin e të Dërguarit të Tij, është rruga e vetme e shpëtimit për ne. Asnjëherë nuk është e mjaftueshme që të kemi emër mysliman. Islami kërkon prej nesh që ta sistemojmë jetën tonë sipas rregullave që ka vendosur Allahu Teala. Jeta jonë është besimi ynë. Besimi ynë është shpëtimi ynë. Allahu (xh.xh.), na dhëntë të gjithëve vetëdijen e besimit! Amin!..



Të mësuarit LOGJIK dhe të mësuarit MEKANIK

Nuredin Nazarko

Të mësuarit është një proces kompleks, ku përfshihen një sërë aktorësh. Protagonisti kryesor i këtij procesi është nxënësi. Nuk është një proces i lehtë, siç edhe mund të konsiderohet në pamje të parë. Është një proces tepër sfidues dhe sfilitës. Duhet të heqësh dorë nga shumë kënaqësi të tjera të jetës së përditshme për t'iu përkushtuar këtij procesi. Përkushtimi është jo i shpërndarë njëtrajtësisht. Pavarësisht kësaj në këtë proces dallojmë dy tipe të mësuarish, logjik dhe mekanik.

A përbën realisht avantazh të mësuarit mekanik ndaj atij logjik apo anasjelltas?

Në qoftë se do t'i qëndrojmë besnik asaj që duhet, duhet të pranojmë se të mësuarit logjik është mëse i avantazhuar ndaj atij përmendësh. Nuk mund të flasim për disavantazhe të të mësuarit logjik, por as për avantazhe të të mësuarit përmendësh. Secili zë pjesën e vet, ka ushtruesit e vet. Nuk është e rëndësishme sasia e ushtruesve të njërit apo tjetrit lloj të të mësuarit. Me rëndësi është perceptimi që duhet të kemi mbi llojin më të avantazhuar të mësimit. Qoftë nxënësi që mëson përmendësh, qoftë nxënësi që mëson logjikisht shfaqin disa veçori të caktuara. Bazuar në sjelljet dhe qëndrimet e shfaqura nga këta dy tipe nxënësish, secili mund të nxjerrë përfundimet e veta mbi avantazhet ose disavantazhet të njërit apo tjetrit lloj të të mësuarit.

Nxënësit të cilët mësojnë përmendsh ndihen të stresuar dhe të pasigurt në vetvete. Nëse i pyet me pyetje që kërkojnë përdorimin e aftësive analitike do ta humbin fillin dhe nuk do të jenë të aftë të përgjigjen. E vetmja mundësi e tyre për tu përgjigjur saktë është, të mos ndërhysh për asnjë moment derisa të mbarojnë së recituari mësimin. Këta nxënës nuk janë të aftë të përfshihen në diskutim për të mbrojtur me argument mendimin e tyre. Kanë vështirësi të theksuara në kombinimin e fakteve. Nuk shfaqin aftësi hermenautike. Parapëlqejnë përgjigjet kallpe. Edhe pse mund të kenë një memorie për tu patur zili, kjo është katërçipërisht shumë e përkohshme. Në një kohë tjetër asgjë nga të mësuarit përmendësh nuk do t'i kujtohet. Nëse janë nxënës që kanë ambicie dhe janë edhe mekanikë, atëherë stresi i tyre psikologjik dhe gjendja e tyre emocionale nuk do të jetë aspak pozitive. Frika se mund ta humbin fillin i ngatërron akoma dhe më keq. Tek disa individë mund të krijojë edhe ankth, edhe rënie të dëshirës për të mësuar, pasi mund ta shohë veten si dështak. Në këtë situatë duhet të kemi parasysh që nxënësve që ushtrojnë këtë lloj të mësuari t'iu ofrojmë mbështetje emocionale, duke i lejuar të përgjigjen sipas mënyrës së tyre të preferuar që të ndihen të çliruar dhe të kënaqur që ia dolën të përgjigjen ashtu siç duan. Në të njëjtën kohë me kështillë të butë duhet që tu vihet në dukje e meta e këtij të mësuari dhe se ata mund t'ia dalin dhe ndryshe. E gjithë kjo që nxënësit që kanë këtë zell për të mësuar të mos ndihen të pavlefshëm. E gjithë kjo që këta nxënës këtë energji që e shfrytëzojnë për të nxënë mekanikisht ta kanalizojnë drejt të mësuarit logjik. A do të jetë proces i suksesshëm? Tek e fundit, ia vlen të përpiqesh me dëshirë dhe vullnet.

Nxënësit të cilët mësojnë me logjikë, janë më të sigurt në vetvete. Njohuritë që përftojnë i kanë më të qëndrueshme në kohë. Janë të aftë të vendosin lidhje me koncepte të mësuara më herët.

Nxënësit të cilët mësojnë me logjikë, janë më të sigurt në vetvete. Njohuritë që përftojnë i kanë më të qëndrueshme në kohë. Janë të aftë të vendosin lidhje me koncepte të mësuara më herët. Ata mund të shtrojnë pyetje me përse dhe njëkohësit të gjejnë dhe argumente për të mbështetur përgjigjen e tyre, duke gërmuar në arkivat e kujtesës së tyre. Kanë aftësi meditative dhe hermeneutike. Kanë fuqi imagjinative. Nuk ndihen të stresuar nëse harrojnë ndonjë detaj, pasiqë për ta më e rëndësishme është thelbi. Në fund të fundit të gjithë harrojnë, por harresa e thelbeve është më e rrezikshme sesa ajo e detajeve. Ndërsa nxënësit e të mësuarit përmendësh më shumë sesa për thelbin kujdesen më tepër për detajet, mundësisht të mos harrohet as pika dhe as presja.

Emocionalisht nxënësit që mësojnë me logjikë janë më të qëndrueshëm. Edhe sikur të ndodhë që të ngatërrohen diku, rikuperojnë, rifuten në diskutim. Janë tipa më kuriozë, më pak të ndrojtur. Vazhdimisht shtrojnë pyetje. Përpiqen të dalin nga skema e zakonshme, dhe të mos i qëndrojnë tërësisht besnik të verbër tekstit. Këta janë nxënësit për të cilët kemi nevojë. Kjo nuk do të thotë se nuk do t'i vlerësojmë dhe inkurajojmë nxënësit mekanikë, përkundrazi. Megjithatë nxënësit të cilët janë robër të skemave kallpe i bëjnë një shërbim të keq vetes sot dhe familjes e shoqërisë nesër. Nxënsëi i cili është mësuar të nxjerrë konkluzione duke përdorur vazhdimisht aftësinë logjikuese, do të dijë që edhe në të ardhmen të konkludojë personalisht në vendime të caktuara, për rëndësinë dhe vlefshmërinë e tyre ose jo. Nxënësi që mbetet rob i skemave kallpe dhe i mekanicizmit do t'i duhet të presë një skemë nga lart, e vlefshme ose jo s'ka rëndësi, sepse rëndësi ka që është skemë.

Të shpresojmë se kontributi i të gjithë atyre që shkon për ata që mësojnë do të synojë drejt të mësuarit logjik, drejt krijimit të personaliteteve të pavarura, të aftë për të marrë vendime dhe mbi të gjitha, drejt personaliteteve në të cilët nuk varroset njerëzorja.



TË UDHËTOSH DO TË THOTË TË KUJTOSH

Edison Çeraj

Më dhatë një mallkim, Etër të Shenjtë, kurse unë po ju jap një uratë: uroj ta keni ndërgjegjen të kulluar si e imja dhe të jeni po aq të ndershëm e besimtarë sa unë.[1]

Shumë artistë e shkrimtarë, herë shkoqur e sidomos tërthorazi, na kanë kujtuar e vazhdojnë të na kujtojnë ngurtësinë tipike të teologjisë. Teologjia nënkupton "studimin e Zotit"[2], dhe si e tillë, në thelb, teologjia merret me të pamundurën, pasi Zoti nuk mund të reduktohet e nuk duhet reduktuar në objekt/subjekt studimor, siç ndodh zakonisht me një gjë apo fenomen konkret.

Ja pse një studiues pati thënë se ka më shumë religjion te mollët e pikturuara nga Cézanne sesa te të gjitha pikturat/ikonat kishtare të marra së bashku, pikërisht ngaqë këto të fundit vuajnë skematizmin e ushqyer nga teologjia (kanonet e panegociueshme), kurse mollët e Cézanne janë frytet spotane që mundëson liria krijuese.[3] Duhet shtuar këtu se edhe Cézanne-it, për të mbërritur deri te ajo gjendje pamore, iu desh të tejkalonte skematizmin që impononin të ashtuquajturat receta artistike. Kritika në art është si teologjia në religjion, thotë Izetbegoviç-i.

Në këtë kontekst duhet kuptuar mesazhi i një poeti kur thotë se matematika të largon më shumë nga Zoti, sesa rendja pas një femre. Pa dyshim që teologjia ka edhe diçka nga matematika.

Siç e thotë Tatnjana Tolstaja te përmbledhja me ese *Intimitete*, ne nuk kemi asnjë problem me Zotin, por me ata që duan të na japin mësim për Zotin.

Një nga ata autorë që ka reflektuar vazhdueshëm për marrëdhënien e ndërlikuar mes njeriut dhe Zotit, duke na shpërfaqur kësisoj edhe problematikën e teologjisë, është Kazanxaqisi.

Këtë temë ai e trajton gati në çdo vepër, por në këtë rast do ndalojmë ca te *Udhëtim në Malin e Shenjtë*, një rrëfim që ai e shkroi në zgrip të jetës në këtë botë. Rrëfimi bazohet te ditari i mbajtur gjatë një udhëtimi në Malin e Shenjtë, që e pat ndërmarrë në moshën 30-vjeçare së bashku me mikun e tij, poetin Angjelos Siqelianos.

Gati në çdo faqe të kësaj vepre, në theb, hasim bash shqetësimin e madh për të cilin po bëjmë fjalë, që ndryshe mund ta quajmë teologjizimi i fetarisë, ose edhe çmagjepsja e transcendencës. Nëpër dialogët e shumtë që ai bën me murgjit atje, por edhe me bashkudhëtarin e tij, ndeshim kontradiktën tipike të natyrës njerëzore: herë përshpirtshmërinë, herë refuzimin. Gjen përshpirtshmërinë teksa përjeton mrekullinë natyrore të atij vendi të veçuar nga bota; teksa kundron murgjit në sakrificën e tyre; teksa dëgjon rrëfimin e ndonjërit se si i ka hyrë rrugës së murgjërisë; kur heton harmoninë e agjërimit të tyre në raport me atë copëz natyrë të virgjër; kur shesh disa murgj duke pikturuar shenjtorë në gjysmerrësirë; kur veçohet me veten dhe ndjen regëtimat e saj falë qetësisë që konservojnë këto vende, si dhe shumëçka tjetër që nuk mund të kalojë kurrsesi nga pragu i gjuhës.

Nga ana tjetër, i jepet refuzimit kur ndonjë murg rrëshket në teologji dhe trazon magjinë e përshpirtshmërisë duke dashur të fetarizojë fetarinë e Kazanxaqisit dhe mikut të tij; kur kërkon ta zbresë Zotin poshtë e të bëjë me gisht – ja, ky është; kur u tregon dy miqve se ku gjendet shpëtimi; kur kërkon t'i fusë me zor në parajsë[4]; kur u thotë se nuk ka shpresë në

1. Kështu i shkruante Kazanxaqisi Sinodit, kur ky i fundit kërkonte shkishërimin e tij.

2. *Theo* – "Zot" dhe *logos* – "fjalë/studim/disiplinë/shkencë".

3. E thënë kjo pa mohuar vlerën e disa apekteve të tjera të artit kishtar, qoftë në rastin bizantin, qoftë në atë roman.

4. "Sapo hymë në oborr, shtangëm të trembur; sikur hymë, të dënuar me njëqind e një, në ndonjë burg të terratisur, gjithë lagështirë; përreth, shtylla të ulëta në ngjyrë të zezë dhe, mes tyre, harqet, lyer në një portokalli të errët; dhe gjithë muri, i pikturuar me ikona të egra nga Zbulesa; djaj



botën tuaj; kur u tregon se çfarë pranon e çfarë nuk pranon Zoti e kështu me radhë.

Kazanxaqisi na kujton se besimi, fetaria apo përshpirtja ndodhet te qëllimi, te përpjekja, madje edhe te përvojat me veten[5], që për shkak të dukurisë teologjizuese kemi prirjen t'i konsiderojmë të parëndësishme, duke qenë se na është imponuar sistematikisht ideja[6] për të bërë vepra "të mëdha" ("...po nuk i dhashë jetës një qëllim, si mund të kaloj në vepra?"), për të "ndryshuar botën", për të "përhapur të vërtetën" etj., si një lloj kulti për punën, për ndryshimin, që me kohën priret të shndërrohet në një ideologji *sui generis*, me tipare të dukshme materialiste, sikurse ka ngjarë e po ngjet në jo pak raste.

"Dhe kur te ndokush rastiste të ndërthureshin heroizmi me shenjtërinë, atëherë ky bëhej, për mua, shembulli i njeriut. Dhe, duke mos mundur të kisha vetë as njërën as tjetrën, përpiqesha, nëpërmjet të shkruarit, të ngushëllohesha për padenjësinë time.

"Je dhi", i thosha, shpesh, shpirtit dhe mundohesha të qeshja, për të mos ia plasur vajit, "je dhi, o shpirt i ngratë; ke uri dhe, në vend që të hash mish e bukë e të pish verë, merr një letër të bardhë dhe shkruan: mish, bukë, verë. Dhe ha letrën.""[7]

Themeli i përshpirtshmërisë është vërtetësia, ndershmëria me veten, pa harruar dialogun po me veten. Në pasazhin e sapocituar hasim pikërisht këtë, madje përgjatë gjithë rrëfimit, me shumë përkorje.

Natyrisht, më së pari, ai i rrëfehet vetes, pastaj edhe lexuesit, më saktë, ndërgjegjes së heshtur të lexuesit, që për autorin është kaq imagjinare e reale njëherësh.

E meqë jemi këtu, ja se si mund të jetë i dobishëm arti për njeriun: duke i kultivuar ndërgjegjen, e cila terratiset e përzhurget shpesh nga projektimet e unit nëpër frone imagjinarë, qofshin edhe "realë", prapë imagjinarë mbesin. "Vura buzën në gaz; "unë! unë!"; ky ishte burgu i llahtarshëm, pa dyer, pa dritare, i mikut tim. Cila është kreshta më e lartë, në të cilën mund të mbërrijë njeriu? – thashë në përpjekje për ta ngushëlluar; të mundë unin; vetëm kur të mbërrijë tek kjo kreshtë, Angjelos, atëherë do të shpëtojmë."[8]

Udhëtim në Malin e Shenjtë është një tekst depërtues, që prek plagën, atë plagën që priremi ta fshehim duke u hequr sikur s'e kemi. Shumë pluhur i heqin qenies rrëfime të kësaj natyre.

Kujton, ndër të tjera, se njeriu nuk është "një mundim i kotë" dhe as mbinjeriu që pushton tokën e botën për të dhënë lajmin e një bote të re. Kujton, gjithëpoaq, shterpësinë tragjike të ndarjes në bota e vjetër dhe bota e re. Kujton, se sa më tepër t'i jepesh kësaj bote, aq më shumë i largohesh vetes, dhe bota bëhet kaq e ikshme, e lëngshme, e thërrmueshme, sa herëdokur bindesh se nuk ke më fuqi ta ndjekësh, dhe në këtë pikë të bren pikëpyetja se mos jam vonë.

Kujton, gjithashtu, se në daç të kuptosh atë që duhet kuptuar te bota, nuk është e thënë të zhytesh në të, por të shtegtosh, të shkëputesh, qoftë fizikisht, qoftë në atë mënyrën tjetër, e më pas kthehu, por mos harro. Kujto. Kumto.

dhe flakë Skëterre, prostituta, nga gjinjtë e të cilave rridhnin dy lumenj gjaku, si dhe kukudhë të frikshëm me brirë... Qejfi sadist i Kishës për t'i kallur datën njeriut; për ta çuar atë në Parajsë, jo me ndihmën e dashurisë, por me ndihmën e tmerrit." (Udhëtim në Malin e Shenjtë, përkth. Romeo Çollaku, f. 65)

5. "Thellë meje zienin rebelime të paqetë e të dalldisur, si dhe trazime shpirtërorë, nuk dija ç'të bëja, doja të gjeja njëherë përgjigjen, përgjigjen time, ndaj pyetjeve të stërlashta..." (po aty, f. 10)

6. Kështu, teologjia është ide, ideja është interpretim, dhe çdo interpr - tim është thjesht relativ. Edhe fjala ἰδέα – *idea* vjen nga greqishtja klasike, dhe një prej kuptimeve është edhe "idhull".

7. *Udhëtim në Malin e Shenjtë*, f. 12.

8. Po aty, f.22.



“Islami është po aq i hershëm në EUROPË sa është edhe KRISHTËRIMI”

Dr. Ardian Muhaj

Si titull të këtij shkrimi vendosëm fjalinë e fundit të një referati 90 minutësh të Ian Chambers, Professor i Universitetit të Napolit, në hapjen e një konference mbi kulturat e Mesdheut, mbajtur në javën e parë të nëntorit në Universitetin e Maltës. Menjëherë mbas referatit vijuan pyetjet dhe diskutimet. I pari që nxitoi të fliste ishte një profesor nga Malta, i cili e filloi reagimin e tij pikërisht duke kundërshtuar me nervozizëm të dukshëm fjalinë e fundit të Prof. Chambers që e zgjodhëm edhe për titull. Ai u shpreh i habitur se si mund të imagjinohej, pa le më të thuhej një gjë e tillë nga një personalitet i tillë si Prof. Chambers, kur nuk mund të ekzistonte asnjë pikë dyshimi se Islami ishte shumë më i vonshëm se sa Krishtërimi në Europë. Kjo sipas tij ishte diçka e ditur dhe e njohur botërisht dhe nuk kishte arsye të vihej në dyshim dhe madje as të diskutohej. Përgjigja e Chambers ishte shumë e qetë dhe u përmblodh në dy fjalë: Europa nuk është thjesht një kontinent por edhe një proces. Ai përmendi vetëm një shembull. Deri në shekullin e XII në vendet Skandinave bëheshin sakrifica njerëzore ndaj idhujve paganë dhe një pjesë e mirë e Europës ishte akoma pagane kur Islami kishte shekuj që lulëzonte pikërisht në Europë.

Për koinçidencë sapo kisha dorëzuar për botim dy zëra enciklopedikë për një histori të ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e feve në botë, botim i një shtëpie botuese të mirënjohur në SHBA. Njëri nga zërat e enciklopedisë që dy koordinatorët e botimit më kishin caktuar ishte procesi i kristianizimit të Lituanisë. Pikërisht për këtë arsye edhe ishte e lehtë të hyja në logjikimin e Prof. Chambers dhe të kuptoj edhe nervozizmin dhe reagimin profesorit maltez.

Për lexuesin e painformuar konvertimi i Lituanisë në krishtërim do të mendohej se do të ketë ndodhur që në kohët antike, pak a shumë në kohën e Konstandinit të Madh apo menjëherë mbas tij, kur edhe Perandoria Romake përvetësoi si fe zyrtare fenë e krishterë. Në fakt e vërteta është shumë ndryshe. Shteti i Lituanisë adoptoi zyrtarisht Krishtërimin si fe zyrtare, në vitin 1387, pra më se një mijë vjet mbas Konstandinit të Madh. Për çudi akoma edhe më të madhe, Lituania e fundit të shekullit XIV ishte një nga shtetet më të fuqishme të Europës së kohës, dhe kishte qenë e tillë për shekuj të tërë. Përfshinte në territoret e veta jo vetëm Lituaninë e sotme, por edhe një pjesë të Finlandës, Letoninë, Estoninë, Rusinë Balltike, Bjellorusinë, pjesë te Polonisë e Sllovakisë dhe shtrihej deri në Ukrainë.

Pikërisht në këtë kohë në tokat shqiptare një pjesë e feudalëve shqiptarë kishin pranuar sovranitetin osman dhe po në ato vite më 1389, ndodh edhe beteja e Kosovës që shndërron në vasalë osmanë një pjesë të madhe të feudalëve shqiptarë dhe ballkanas. Pra, thënë shkurt kristianizimi i një pjese të madhe të Europës veriore fillon në të njëjtën kohë me islamizimin e një pjese po aq të madhe të Europës jugore.

Mbreti i fundit pagan i Lituanisë, ishte një luftëtar i regjur kundër kryqtarëve prusianë të Urdhrit Teutonik, të cilët kishin më se dy shekuj që luftonin pa reshtur për kristianizimin e lituanezëve, livonianëve, finlandezëve, estonezëve etj. Konvertimi i mbretit lituanez ishte një hap i mirëpeshuar politik. I lëkundur mes një martese me një princeshë ruse të shtetit moskovit apo një aleance martesore me princeshën trashëgimtare të Polonisë ai zgjodhi opsionin polak, duke u martuar me Jadvigën dhe duke u bërë mbret i super-shtetit Polako-Lituanez nën emrin Vladyslav Jagielo II. (1386–1434).


Megjithatë konvertimi i mbretit dhe i oborrit mbterëror në krishtërim qe shumë më i lehtë se sa konvertimi i popullsisë. Në fakt kjo ishte edhe arsyeja pse prusianët nuk e konsideronin si të sinqertë këtë konvertim dhe i vazhduan edhe për shumë vite fushatat kryqtare kundër popujve të Baltikut lindor e verior. Në betejën e Grunvaldit të vitit 1410, më se një dekadë mbas betejës së Nikopojës (1396) kur forcat kryqtare të grumbulluara pa shumë rregull u shpartalluan nga osmanët, forcat e bashkuara të shteti Polako-Lituanez më në fund i thyen keqas forcat e urdhrit të krishterë prussian dhe presioni i kryqtarëve u eliminua përfundimisht. Paganizmi vazhdoi të tolerohej në popullsitë e Europës veri-lindore pavarësisht se zyrtarisht krishtërimi ishte shpallur fe e vetme dhe vetëm në shekullin e XVII mund të thuhet se konvertimi i këtyre popullsive në krishtërim u krye.[1]

Këtu po flasim për periudhën e fundit të shtrirjes së pranisë së Islamit në Europë, atë osmane. Por, muslimanët kishin pothuajse një mijë vjet prani në Europën Perëndimore dhe kishin krijuar një qytetërim rrezatues, një nga ciklet qytetëruese më të rëndësishme në historinë botërore, pa të cilin është e vështirë të kuptohet vetë qytetërimi i sotëm europian. Në shekullin e XI, tre shekuj mbas themelimit të shtetit islam spanjoll, Baltiku dhe Deti i Veriut, pa të cilët sot nuk mund të konceptohet Europa, akoma nuk ishin kristianizuar, dhe pa frikë mund të thuhet se ajo Europë veriore që sot përbën bërthamën më të zhvilluar të asaj që ne e njohim për Europë ishte akoma pagane e politeiste. Po ashtu pagane e politesite ishte edhe krejt Europa Verilindore dhe dhe ajo Lindore nga stepat ruse e deri në detin Adriatik.

Madje nuk duhet harruar se veçanërisht në Ballkan, kishte ndodhur një proçes historik të cilit i është kushtuar shumë pak vëmendje, por që ka qenë pjesë e evoluimit historik të kësaj zone, pikërisht ai proces të cilin bizantinisti i njohur François Dvornik e emërton si de-kristianizim apo rikthim i shumicës së Gadishullit Ballkanik në paganizëm e politeizëm pas kristianizimit të shekujve II-VI.[2] Për rreth gjysëm mileniumi shumica e Ballkanit u rikthye në paganizëm për shkak të dyndjeve dhe vendosjes në Ballkan të popullsive të ndryshme, kryesisht sllave, të cilat shkatërruan sa mundën, duke rrafshuar qytete e fshatra. Aq më tepër që një pjesë e Ballkanit veçanërisht brendësia e tij dhe zonat malore nuk ishin kristianizuar akoma kur fillojnë valët e njëpasnjëshme të dyndjeve të paganëve gjermanikë, hunë e sllavë.

Në shekullin e IX-të kur misionarët e krishterë Ciril e Method rrekeshin me vështirësi t'u mësonin sllavëve abc-në e shkrimit, muslimanët hispanikë e italikë rrekeshin të ndërtonin mjetin e parë fluturues apo thelloheshin në komentimin e filozofëve të lashtësisë.

Në përfundim mund të themi se përgjatë dy mijë vjetëve të fundit Europa, jo vetëm si kontinent dhe koncept gjeografik, por edhe si qytetërim ka qenë njëkohësisht e krishterë, islame dhe pagane (ateiste). Prania e të tri këtyre besimeve ka qenë e vazhdueshme dhe Europa nuk bën kurrfarë përjashtimi në mesin e kontinenteve të njohur që nga lashtësia. Jo vetëm Europa, por edhe Afrika dhe Azia, kanë qenë gjithnjë të tilla.



1. Më gjerësisht: Eric Christiansen. *The Northern Crusades: the Baltic and the Catholic Frontier 1100-1525.* Minneapolis: University of Michigan, 1981; S.C. Rowell, *Lithuania Ascending: A Pagan Empire Within East-Central Europe, 1295-1345.* Cambridge University Press, 1994.

2. François Dvornik, *Byzance et la primauté romaine*, Paris: Les Editions du Cerf, 1964, f. 68-69: "Il en resulta que Constantinople et Rome evoluerent dans des directions differentes. L'eloignement qui s'ensuivit eut pu etre evite si le pont de l'Illyricum n'avait pas ete detruit. Mais la disparition et la dechristianisation des provinces latines de l'Illyricum, leur occupation par les elements barbares et la perte de la domination maritime de l'Empire en mediterranee, tout cela fit que la co penetration des idees nouvelles entre l'Orient et l'Occident fut presque impossible".



Frika

"I druhen Zotit të tyre, që ka pushtet mbi ta dhe bëjnë atë që u urdhërohet." (Nahl, 50)

Një prej niveleve më të rëndësishme të udhëtimit shpirtëror është edhe frika. Frika është nga gjendjet më të vyera dhe të dobishme për zemrën. Ajetet kuranore që lëvdojnë dhe nxisin besimtarët të përfshihen nga kjo gjendje janë të shumtë. ***"Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!"*** (Ali Imran, 175) "***Mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje!"*** (Maide, 44) Nga ajetet kuptojmë që frika ndaj Allahut është urdhëresë hyjnore dhe obligim për besimtarët si të gjitha obligimet e tjera. Allahu flet me superlativa për njerëzit që i frikësohen Atij. ***"Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre, që besojnë në shpalljet e Zotit të tyre, që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët."*** (Muminun, 57-61) Kur Aishja (r.a.), e pyeti Profetin (a.s.), për grupin në ajetin: ***"Kur japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë."***, nëse bëhej fjalë për personat që kanë bërë imoralitet, kanë pirë alkool dhe kanë kryer vjedhje, pastaj i janë frikësuar Allahut për atë që kanë bërë? Profeti (a.s.), tha: *"Jo, Ata janë persona që agjërojnë, falin namazin, japin sadaka dhe frikësohen se nuk u pranohen tek Allahu."* Kurse Hasan Basriu thotë: "Betohem se janë ata që i binden Allahut dhe përpiqen sa munden në përkushtim ndaj Tij dhe përsëri frikësohen se nuk pranohen nga Allahu." Besimtari mbledh në një njësi veprën e mirë dhe frikën, kurse hipokriti të keqen dhe sigurinë. Frika e zakonshme, e cila në gjuhën arabe shprehet me fjalën "Hauf" për të gjithë besimtarët, kurse frika e shprehur me fjalën "Hashje", është më e veçantë dhe veçori e dijetarëve dhe atyre që njohin Allahun.

Kjo fjalë në Kuran është shoqëruar me diturinë si në ajetin: ***"Allahut i frikësohen vetëm dijetarët"*** (Fatir, 28), pra nga ajeti kuptojmë që frika e shprehur me fjalën "Hashjet" është veçori vetëm e atyre që njohin Allahun. Kurse Profeti (a.s.), thotë: *"Unë i druhem dhe frikësohem Allahut më shumë se çdo njëri prej jush."* "Huaf" është lëvizje, kurse "Hashjet" është qetësi. Një person përballë armikut apo rrezikut ndodhet në dy gjendje

1. Lëvizje dhe reagim për t'u larguar nga rreziku, kjo përbën frikën në kuptimin e përgjithshëm.


2. Gjendja e dytë është qëndrimi dhe vendosja në një vend ku nuk arrin rreziku, kjo përbën frikën në kuptimin e veçantë.

Të dyja këto janë në raport të drejtë me diturinë dhe frikën e Allahut. Personi që përjeton frikën "Huaf" strehohet duke u larguar, kurse personi që përjeton frikën "Hashjet" strehohet duke u kapur pas diturisë.

Ndërsa frika ka lidhje me veprimet, dashuria ka lidhje me qenien dhe cilësitë. Prandaj besimtarëve, kur të hyjnë në Xhenet do t'u shtohet besimi, por nuk do të kenë frikë. Për rrjedhojë, gjendja e dashurisë është më e lartë se gjendja e frikës. Frika e dëshiruar është frika që vendos një pengesë midis personit dhe të ndaluarës. Nëse frika e kalon këtë kufi, ajo shndërrohet në pesimizëm dhe për pasojë, e papëlqyeshme.

Zemra e udhëtarit drejt Zotit është si zogu, ku dashuria është koka, frika dhe shpresa krahët e tij. Kur të tria këto janë në rregull dhe harmoni zogu fluturon. Kur nuk është koka zogu vdes, kurse kur i dëmtohen krahët bëhet objekt i gjuetisë. Prandaj udhëtari drejt Allahut duhet të përpiqet ta ruajë mirë raportin midis këtyre tre komponentëve.

Sekreti i rinisë në moshë thyer



Ishte një çift i moshuar rreth moshës 90 vjeç, por që nuk tregonin më shumë se 60 vjeç. Të gjithë ishin të interesuar për sekretin e dukjes së tyre të rinj. Një ditë, të gjithë të interesuarit u mblodhën së bashku dhe vendosën të vizitonin çiftin e moshuar. Kur shkuan në shtëpinë e të moshuarve e pyetën plakun se cili ishte sekreti i rinisë së tij. Plaku u tha: "Do t'jua them, por më parë uluni të hamë diçka."

Pas buke, plaku i kërko i bashkëshortes të sillte një shalqi, bashkëshortja mori një shalqi në katin e dytë dhe ia solli bashkëshortit. Plaku nuk e pëlqeu shalqirin dhe i kërkoi bashkëshortes të sillte një shalqi të ri. Bashkëshortja shkoi dhe solli një shalqi tjetër, por plaku as atë nuk e pëlqeu dhe përsëri i kërkoi bashkëshortes t'i sillte një shalqi tjetër. Bashkëshortja i solli përsëri një tjetër, por edhe kësaj radhe plaku nuk e pëlqeu shalqirin. Plaku u tha mysafirëve: "Gruaja nuk diti ta zgjidhte të mirin, ejani shkojmë të gjithë bashkë, të zgjedhim në shalqi të mirë." Kur arritën në katin e dytë vunë re që në dhomë ishte vetëm një shalqi, bashkëshortja në të gjitha rastet kishte sjellë të njëjtin shalqi. Plaku iu drejtua mysafirëve: "Po tani, a e kuptuat sekretin e rinisë?" "Jo", thanë mysafirët. "Bashkëshortja, për të mos më turpëruar mua, në të gjitha rastet solli të njëjtin shalqi, sepse nuk kishte tjetër dhe në asnjë mënyrë nuk tha: 'Nuk ka shalqi tjetër, vetëm një është.' Ajo nuk më ka mërzitur mua asnjëherë; edhe unë atë po ashtu, nuk e kam mërzitur asnjëherë. Ne asnjëherë nuk e vumë në pozitë të vështirë njëri-tjetrin, në këtë mënyrë mbetëm të dy të rinj. Ky është edhe sekreti i rinisë sonë."

" NJË **LUTJE** "

"O Zoti im! Të kërkoj mbrojte nga rënia në varfëri, vështirësi dhe poshtërim. Të kërkoj mbrojtje nga bërja padrejtësi dhe rënia në padrejtësi."

" **AFORIZËM** "

"Modestia është mbajtja dietë e krenarisë."

INFORMACIONE INTERESANTE

Në bibliotekën mbretërore të Stockholmit ruhet e ashtuquajtura "Bibla e djallit", e cila peshon 350 kg.

Lëngu që gjendet në kakaon e freskët mund të përdoret në vend të plazmës.

Ngrënia e një molle në mëngjes largon gjumin më shumë se kafja.

Shpërthimet E DIELLIT

Kohët e fundit në media po dëgjojmë gjithnjë e më tepër lajme në lidhje me diellin. Shkak i kësaj janë shpërthimet e fuqishme dhe të shpeshta të Diellit. Dikush këto shpërthime i komenton si sinjal lajmërues për fatkeqësi të mëdha, dikush tjetër e hiperbolizon duke e lidhur me apokalipsin. Por përse dielli është aktivizuar pikërisht këto vitet e fundit? Për të kuptuar këtë fenomen, po ndjekim metodën e psikologëve që do të thotë të zbresim në fëmijërinë e diellit, madje deri në lindjen e tij para 4.6 miliard vitesh.

FORMIMI I DIELLIT

Para 13. 7 miliard vitesh, pas Shpërthimit të madh universi ishte i zhytur në errësirë. Kjo errësirë vazhdoi deri sa gazrat u bashkuan për të krijuar yjet që janë kandilat e universit. Në këtë periudhë fillon edhe historia e diellit. Dielli dhe planetët u krijuan nga një nebulozë gazore, e cila ruante një trysnit të caktuar. Nga rënia gravitacionale e nebulozës gjigande filloi të formohej Dielli dhe planetët e tij. Se çfarë e shkaktoi dhe e nxiti këtë rënie gravitacionale, shkencëtarët ende nuk kanë një përgjigje të prerë, por mendohet që ky proces të jetë shkaktuar nga një dallgë shoku e një supernove të largët ose të afërt. Si do qoftë, të gjitha këto janë mjete, sepse "Krijuesi i Diellit dhe Hënës është AI (Zoti)" Enbija, 33

Dielli, i cili është formuar nga grumbullimi masiv i mjegullnajave gazore, çdo ditë e më shumë po bëhet edhe më i nxehtë dhe për pasojë edhe më energjik. Ndërsa temperatura në sipërfaqe është 6000 C, në bërthamë ajo arrin vlerën 15 milion C. Duke pasur parasysh këtë temperaturë është krejt normale që dielli arrin të na ngrohë ne 150 milion km larg. Por si e siguron ai këtë temperaturë kaq të lartë?

Dielli e prodhon energjinë duke e konvertuar hidrogjenin në helium përmes zinxhirit të reaksioneve të fuzionit nuklear të bërthamës, e cila nga ana e vet është nën një trysni dhe nxehtësi të lartë. Duke qenë se këto reaksione kanë nevojë për mjedise jashtëzakonisht të nxehta, bërthama e Diellit shërben si një laborator i përkryer.

Procesi i shndërrimit të hidrogjenit në helium është burimi i energjisë kolosale që ka dielli. Nga kjo pikëpamje dielli është një burim i jashtëzakonshëm energjie. Energjia që përhap dielli për tri ditë është e barabartë me energjinë e prodhuar nga të gjitha burimet e energjisë në Tokë. Vetëm 1 e një milionta e energjisë kolosale që prodhon dielli arrin në tokë.

DIELLI HUMBET QETËSINË

Dielli, i cili prej mijëra vjetësh ngroh dhe ndriçon Tokën, kohët e fundit nuk është aspak i qetë. Në sipërfaqe të tij po ndodhin shpërthime të mëdha gazi dhe po krijohen njolla të zeza disa herë më të mëdha se Toka.

Në fakt këto shpërthime janë parashikuar nga shkencëtarët. Sipërfaqja e tokës vëzhgohet me teleskop qysh prej vitit 1609. Njollat e diellit në fillim u konsideruan si normale. Por në ditët tona pas një



sërë vëzhgimesh u vu re se aktiviteti i Diellit një herë në 11 vjet arrinte maksimumin. Pra shpërthimet në sipërfaqen e diellit janë krejt normale sipas shkencës.

Këto shpërthime nuk kanë asnjë ndikim mbi njeriun. Grimcat që përhapen në hapësirë si pasojë e këtyre shpërthimeve kur mbërrijnë në tokë përplasen në magnetosferë dhe thithen prej saj, në këtë mënyrë dëmi që mund të vije prej tyre ulet në minimum. Por këto shpërthime mund të ndikojnë shumë mbi valët e radiove dhe sistemeve të tjera elektronike. Si përfundim, diellit i duhet të paktën 4.5 miliard vjet për t'u harxhuar plotësisht. Por nuk duhet të harrojmë se Kiameti do të ndodhë në mënyrë të papritur . Për të gjithë ata që janë kureshtarë për Kiametin, dëshiroj t'u kujtoj ajetin 47 të sures En'am Thuaj: ***"Më thoni, nëse ju vjen dënimi i Allahut papritmas ose sheshazi, a do të zhdukej kush përveç popullit keqbërës?"***

A nuk ka një kurë PËR AUTIZMIN?

Nëse përpiqemi të klasifikojmë sëmundjet, sipas jush, cila prej tyre të çon drejt pashpresës? Ti gruposh në sëmundje vdekjeprurëse dhe jo vdekjeprurëse apo t'i klasifikosh në sëmundje me shpresë dhe pa shpresë? Sado të kemi frikë nga vdekja, kur mendohet në lidhje me sëmundjet vdekjeprurëse, nëse ato kanë një kurë, a mund të humbë shpresa? Për shembull, murtaja e zezë ka qenë një nga sëmundjet vdekjeprurëse më të famshme. Një sëmundje, e cila u bë shkak i zhdukjes së një të tretës së popullsisë së Evropës në mesjetë, por që në kohën tonë është zhdukur pothuajse krejtësisht, në sajë të vaksinave, antibiotikëve dhe kurave përkatëse. Mirëpo, nëse mendojmë përsëri për kohën e mesjetës, ajo pranohej si një nga llojet e sëmundjeve që nuk kishin shpresë shërimi.

Pikërisht në recetën që mund të marrë një i sëmurë mbase i pashpresë, menjëherë mbi paragrafin e fjalisë "s'ka shpresë dhe ilaç", duhet shkruar me germa të mëdha ky hadith fisnik: *"Allahu nuk ka krijuar asnjë sëmundje pa shërim!"* (Ahmed bin Hanbel, 4278.) dhe *"Përveç pleqërisë, çdo sëmundje e ka një zgjidhje dhe një ilaç."* (Buhari, 10/113.)

Ndërkohë që meditoja mbi këto hadithe, në një cep të mendjes kam ruajtur gjithmonë këtë pyetje: Po sëmundjet e trashëgueshme, pra ato gjenetike? Sepse kur shkruani një poezi, mund ta fshini një varg që nuk ju pëlqen, por nuk mund ta fshini kurrë e ta filloni nga e para një vepër shumë vëllimshme që është bërë shkak i lindjes së një kulture, një jetese dhe që ndodhet një qelizat e një shoqërie të tërë. Pra, në kuadër të përgëzimit që na ka dhënë Profeti ynë (a.s.), për sëmundjet, ne jemi të detyruar të jetojmë me sëmundjet tona gjenetike, derisa shkenca të zbulojë një kurë për to.

Pikërisht, një nga këto sëmundje, për të cilën kur shqiptojmë fjalën "shërim", menjëherë na thuhet "ah, po kjo është një sëmundje gjenetike!", është edhe sëmundja e autizimit. ADN-ja jonë, e cila është përafërsisht dy metra, ruhet në një kromozom që ka formën e kasetave të vjetra, në bërthamën e çdo qelize. Dhe, në çdo qelizë tonën gjenden dyzet e gjashtë kaseta të tilla. Ndërsa autizmi shkaktohet nga anomalitë e kasetës së pesëmbëdhjetë në triliona qeliza të të gjithë trupit të sëmurit. Pra, ka një cilësi plotësisht gjenetike.

Shpresa e kurimit të autizmit me anë të parazitëve!

"Autizmi është një problem gjenetik që fillon (të dallohet) para moshës trevjeçare dhe vazhdon gjatë gjithë jetës. Ai dëmton marrëdhëniet dhe komunikimin shoqëror. Ai bëhet shkak i sjelljeve të kufizuar dhe të përsëritura dhe pengon zhvillimin e trurit." Mirëpo, në studimet që janë kryer kohët të fundit, ka filluar të bjerë një dritë shprese edhe për këtë sëmundje "të pashpresë".

Sipas një studimi të botuar nga Fakultetit i Mjekësisë në Universitetin Baylor të Teksasit në SHBA, një bakter me emrin "L. reuteri" që ndodhet në zorrë, mund të përmirësojë marrëdhëniet shoqërore të pacientëve të sëmurë me autizëm. Në eksperimentet që janë kryer mbi minjtë, është vënë re se minjtë që nuk i kanë këto bakterie në zorrët e tyre, kanë probleme në sjelljet shoqërore. Këta minj që përjetojnë probleme të ngjashme me ato që shkakton autizmi, i janë nënshtruar një ushqyerjeje të ekuilibruar në sajë të së cilës është bërë i mundur formimi i bakterit "L. reuteri", në zorrët e tyre. Pas një farë kohe, është vëzhguar se tek këta minj është përmirësuar sjellja dhe madje është eliminuar papërshtatshmëria e tyre sociale.

Po ashtu, edhe kompania farmaceutike Coronado Biosciences është duke punuar me disa parazitë të quajtur TSO: Trichuris suis ova, CNDO-201, të cila ua kanë injektuar kafshëve, duke arritur të ekuilibrojnë sistemin mbrojtës dhe kanë pasur sukses në pakësimin e anomalive që shfaqen në trup së bashku me autizmin. Ky parazit i cili nuk shtohet kur i injektohet njeriut dhe nuk i sjell asnjë problem sistemit mbrojtës, përveç autizmit, shpresohet të kurojë edhe sëmundje të tjera si Multiple Sklerozë dhe Chronin, të cila janë pothuajse të pashpresa.



"Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t'u këshilluar me të mendarët.."

(Sad, 29)

TË KUPTOSH KURANIN, NATYRËN DHE HISTORINË

Mendja e shëndoshë nuk është vetëm një kusht për të qenë përgjegjës në aspektin fetar. Mendja duhet përdorur edhe për bërë një jetë me parime islame, prej së cilës do të jetë i kënaqur edhe Allahu. Siç kuptohet edhe nga ajeti që kemi dhënë në hyrje, një nga shkaqet e zbritjes së Kuranit na bëhet e ditur në atë formë.

Kurani, si një thesar i dijes dhe i urtësisë, i fton ata të cilëve u drejtohet të mendojnë mbi të dhe këtë, e përsërit vazhdimisht në raste të ndryshme. Për shembull, në një ajet tjetër, çështja trajtohet në këtë formë: ***"Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, me qëllim që të kuptoni!"*** (Jusuf, 2.)

Meditimi fetar kërkon aktivizimin e të gjitha mënyrave të kuptimit, me qëllim që tek njeriu të sigurohet uniteti mendje-zemër. Kurani e përdor këtë si një metodë, sepse njerëzit që nuk e kanë të gjallë botën e mendimit dhe meditimit, edhe jeta e tyre fetare do të mbetet e dobët. Për rrjedhojë, me qëllim që të fitohen disa vlera dhe sjellje të caktuara, është shumë e rëndësishme që ajetet të bëhen temë e mendimit. Por për fat të keq, nëse sot shohim marrëdhënien e myslimanëve me Kuranin, vëmë re se kjo marrëdhënie nuk ka në qendër të kuptuarit. Në thelb, kjo marrëdhënie nuk bazohet në mendim, por në ndjenja. Pra, nuk ka të bëjë me mendjen, por me adhurimet. Gjithashtu, kjo marrëdhënie synon më tepër fitimin e sevapeve dhe shpërblimeve në botën tjetër, sesa ndërtimin e një personaliteti islam dhe të kësaj bote. Si rezultat i këtij botëkuptimi për të cilin bëhet fjalë, respekti ndaj Kuranit është kthyer prej respektit ndaj urdhrave hyjnore që përmban, në respektin ndaj Librit si objekt fizik dhe në shpresimin e begatisë prej tij.

Nga një anë, Kurani u shenjtërua, por nga ana tjetër u largua nga jeta reale. Sot myslimanët nuk po ndajnë kohën e duhur për të kuptuar këtë fjalë hyjnore. Tashmë, ata duhet t'i ndryshojnë këto zakone dhe çdo ditë duhet të qëndrojnë për një farë kohe duke meditуar mbi të. Përndryshe, urdhrat dhe mësimet e tij në lidhje me besimin, adhurimin, moralin, historinë dhe shoqërinë, do të vazhdojnë të neglizhohen.

Në fakt, a nuk ka qenë kultura e shpalljes burim i frymëzimit për myslimanët e parë dhe qytetërimin Islam? A nuk duhet të jetë edhe sot kështu? Për shkak se shumica e myslimanëve e kanë neglizhuar të kuptuarit e Kuranit, ata nuk i kanë dhënë rëndësi as kuptimit të ajeteve në lidhje me natyrën. Mirëpo, këto ajete na ftojnë të kuptojmë argumentet e krijimit.[1]

Qëllimi kryesor i Kuranit në këto ajete, është të ndërtojë përfytyrimin e teuhiditt, pra, të konceptit të një Zoti të vetëm. Është e qartë se kjo formon një prapaskenë të rëndësishme në formimin e mendimit të studimit të gjithësisë e për rrjedhojë edhe të zhvillimit të shkencave natyrore. Në Kuran, funksionimi normal dhe i rregullt i natyrës cilësohet si një argument hyjnor. Po në të njëjtën mënyrë, edhe mrekullia që e tejkalon këtë normalitet apo rregullsi, cilësohet si argument hyjnor. Dhe kjo përbën një situatë të çuditshme. Mbase me këtë, kërkohet të na kujtohet fakti se, "Ashtu siç interesoheni për mrekullitë, ashtu duhet të interesoheni edhe për misteret dhe urtësitë e ajeteve të Kurani në lidhje me natyrën, të cilat to t'ju mahnitin. Pra, përse nuk meditoni mbi to?"

Në botëkuptimin e Kuranit, i gjithë krijimi është i mbushur me argumente të panumërta që e thërrasin njeriun tek Zoti i tij. I gjithë krijimi me çdo lloj forme të tij, vërteton dijen e pakufishme të Krijuesit, forcën e Tij të pashoqe dhe fuqinë e Tij të krijimit. Të gjitha krijesat, që prej kafshëve, deri tek bimët, gjallesat mikroskopike etj., janë krijuar me një përsosmëri që e mahnit njeriun. Në këtë

1. - shih. Xhathije, 3-6.

pikëpamje, i gjithë krijimi qëndron para njeriut si një libër plot me mistere që presin të kuptohen. Por për fat të keq, shoqëritë myslimane të ditëve tona nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të kuptuar natyrën dhe për të deshifruar sistemin dhe mënyrën se si funksionon gjithësia. Përkundër këtyre, atyre u tërheqin më shumë vëmendje tregimet në lidhje me mrekullitë dhe kerametet, duke treguar një interes të jashtëzakonshëm për ndodhitë e jashtëzakonshme.

Me sa po shohim, sot, me studimin e madhështisë së mënyrës së funksionimit të natyrës, po interesohen më tepër perëndimorët me qytetërimin e tyre modern. Ata, mrekullinë (!) po e kërkojnë në zbulimin e mënyrës së funksionimit të gjithësisë dhe në shndërrimin e saj në teknologji. Mirëpo, duhet theksuar se në botëkuptimin perëndimor natyra është një tërësi mundësish prej të cilave njeriu mund të përfitojë vetëm në aspektin material. Ajo nuk ka asnjë kuptim metafizik dhe shpirtëror. Për ta, natyra merr vlerë vetëm kur zbulohen ligjet e saj, të cilat pasi aplikohen në teknologji, i ofrohen përdorimit njerëzor.

Sot njeriu ka arritur në një nivel të jashtëzakonshëm në zbulimin e mistereve të gjithësisë. Mirëpo, gjithë ato dije të akumuluara në fushën e shkencës, nuk shprehin ndonjë gjë të veçantë në lidhje me falënderimin ndaj Krijuesit. Ata nuk po nxjerrin ndonjë mësim prej librit të gjithësisë. Dijet e fituara në lidhje me mrekullitë në krijimin e natyrës dhe të njeriut, nuk po i hapin rrugë një botëkuptimi shpirtëror dhe konceptit të Zotit. Këto evidentime, nuk janë vetëm për botën jomyslimane, por kryesisht vlejnë edhe për shoqëritë islame, sepse në librat e lëndëve të shkencave natyrore që jepen sot në shkollat tona, vazhdon të ndikojë botëkuptimi për të cilin po flasim. Dhe kjo nuk është asgjë tjetër përveçse struktura e një mentalitetit të copëtuar.

Kuptimi i Kuranit, natyrës dhe historisë (shoqërisë), përbëjnë tri pikat kryesore ku mbështetet qytetërimi islam. Për sa kohë që myslimanët nuk i bëjnë këto tri fusha tema të dijes dhe të botëkuptimit, nuk do të jetë e mundur të ndërtojnë një kulturë dhe një qytetërim që do t'i japë shpresë njerëzimit. Kuptimi dhe interpretimi i Kuranit nuk është konsumuar në të shkuarën dhe nuk do të konsumohet as në të ardhmen. Përkundrazi, myslimanët duhet të kuptojnë dhe ta interpretojnë Kuranin çdo shekull brenda metodave të përcaktuara.

Nga ana tjetër, botëkuptimi i myslimanëve në lidhje me natyrën dhe historinë nuk duhet të bazohet në atë të qytetërimeve të tjera. Prej tyre duhet të përfitojnë, por këto fusha duhet t'i bëjnë vetë personalisht objekt studimi brenda kuadrit të parimeve themelore islame.

Një nga pasojat që ka shkaktuar mostregimi i interesit të duhur të myslimanëve në kuptimin e Kuranit, është edhe fakti se një pjesë e rëndësishme e Kuranit përbëhet nga tregime, ku flitet për ligjet që kanë shkaktuar ngritjen dhe rrënimin e shoqërive të ndryshme. Nisur nga kjo, myslimanët duhet të zhvillojnë doktrina në lidhje me shkencat shoqërore të frymëzuara prej Kuranit. Por për fat të keq, kërkimet në këtë fushë janë ende në gjendje të pamjaftueshme.

Kurani Fisnik pret të kuptohet dhe të studiohet me kujdes të madh në këtë aspekt. Studimet që do të bëhen në këtë fushë, nuk duhet të jenë vetëm teorike, por në të njëjtën kohë, duhet të synojnë edhe zbatimin e tyre në jetën reale. Këtë aludon edhe Allahu në Kuran, kur thotë: ***"...Vallë! A nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë se si ka qenë fundi i popujve, që kanë jetuar para tyre?.."*** (Jusuf, 109; shih. En'am, 11.)

Çështja që prek ajeti i mësipërm, nuk nënkupton konfirmimin e historisë së popujve të shkuar prej librave të historisë, por duke shkuar vetë personalisht në vendbanimet e tyre të vjetra. Pra, është e domosdoshme të bëhet një interpretim i ri i historisë duke u nisur prej zbulimeve arkeologjike dhe argumenteve konkrete. Mirëpo, është e vështirë të thuhet se myslimanët po bëjnë studimet e nevojshme edhe në këtë fushë, sepse shkenca e arkeologjisë që jepet ende në universitetet tona, bazohet kryesisht në kërkimet e bëra nga të huajt, e për rrjedhojë edhe në gjykimet dhe studimet e tyre.

Si përfundim, për arritjen e një rigjallërimi dhe rindërtimi duhet të pohojmë se kultura e shpalljes, duhet të bëhet burimi i dijes dhe jetës sonë.

Profeti (a.s.), ka thënë:

"Nëse do të mbështeteshit ashtu siç duhet tek Allahu,
do të furnizoheshit ashtu siç furnizohen zogjtë të cilët në mëngjes dalin të uritur,
e në mbrëmje kthehen të ngopur!"

(Tirmidhi, Birr, 3)

MBËSHTETJA TEK ZOTI... SI ZOGJTË!

Sa i përket zogjve që dalin të uritur nga foletë në agim dhe kthehen të ngopur në mbrëmje... Si çdo mëngjes, edhe këtë herë çdonjëri prej tyre u ngrit në fluturim i uritur... I qetë, me shpresë e me dëshirë... Më pas, pa qëndruar në pritje, përqafoi qiellin me flatrat e tij. Besnik, i përzemërt dhe i sinqertë... Fluturuan me kënaqësi mes reve të bardha, vallëzuan me hare duke lëshuar krahët mbi erë dhe shpuan qiellin për të zbritur në thellësitë e tij... Kush i shihte, pandehte se ishin sundimtarë të qiellit, por ata vetëm sa po kalonin përmes qiellit pa kërkuar ta posedojnë atë.

Ajo që i bënte ata të fluturonin dhe të ishin optimistë pa i mbajtur shpresat tek qielli, ishte se ata furnizimin nuk e prisnin prej qiellit, por prej Sunduesit të qiellit... Ndërkohë që ne ecnim, prej qiellit tonë kalonin zogj. Ngritëm kokën dhe ata ishin gjithmonë në lartësi... qielli blu është shtëpia e tyre. Me sa duket, na kaploi dëshira dhe zilia... filluam të vraponim, aq sa mbetëm pa frymë. Mirëpo, nuk e dinim se të vraposh, nuk ishte e njëjtë sikur të fluturosh... E çfarë na pengonte neve të fluturonim me dy krahë, kur ata fluturonin me dy flatra? Po, edhe neve duhet të kishim flatra... jo vetëm dy, por tre, katër, pesë, e madje edhe më shumë... Duhej të bënim llogari e plane për të garantuar edhe çështjen e fluturimit si çdo gjë tjetër! U llogaritën të gjitha mundësitë deri në detajet më të imta, u bënë statistikat dhe u eliminuan të gjitha rreziqet.

Çdo gjë ishte në rregull, por nuk u bë!.. Nuk arritëm ta shijonim dot atë kënaqësi. Flatra kemi, apo jo? Po, dhe me tepricë! Mirë, por pse nuk mund të fluturojmë? Sepse flatrat e shpirtit tonë janë të thyera! Po çfarë është ajo që e bën me flatra shpirtin tonë? Mbështetja tek Zoti! Këtë e thoshte Profeti që njihte qiejt dhe sillte lajme prej andej. Ai na ka bërë të ditur se ne mund të rrihnim flatrat së bashku me zogjtë e të ndiheshim të lirë si ata duke u mbështetur tek Allahu... E nëse do të ndiqnim gjurmët e zogjve, këmbët tona do të lëshonin tokën. Ai na tregon se për të shpëtuar prej peshave që na tërheqin drejt tokës dhe të ngrihemi lart, na duhet të mësojmë shumë prej zogjve. Prandaj ai na jep shembull zogjtë dhe thotë: *"Nëse do të mbështeteshit ashtu siç duhet tek Allahu, do të furnizoheshit ashtu siç furnizohen zogjtë të cilët në mëngjes dalin të uritur, e në mbrëmje kthehen të ngopur!"* (Tirmidhi, Zuhd, 33.)

Zogjve mund t'u ngjajnë vetëm ata që mbështeten plotësisht tek Allahu... Dhe këtë mund ta bëjnë vetëm ata që kanë hall qiellin dhe dëshirojnë të fluturojnë... Të mbështetesh tek Allahu nuk do të thotë të rrish në vend, por të fluturosh. Kjo është vepër e atyre që i kanë sytë në lartësitë qiellore. Vepër e atyre që kanë ëndrra, ideale dhe synime të mëdha dhe mbështeten tek "Ekberi", tek më i Larti...

Ai që furnizon milingonat, peshqit, e zogjtë, Ai na furnizon edhe ne. Për këtë duhet të jemi të vetëdijshëm, sepse shpirtrat që nuk kanë besuar, nuk janë mbështetur dhe nuk janë përkushtuar, nuk mund ta ndjejnë këtë kënaqësi... Ata që përjetojnë mjerimin e mosbesimit dhe ata që mbështetjen tek Allahu e konsiderojnë dembelizëm, nuk mund ta dinë se si mbështetja në Allahun e vë në lëvizje njeriun me gjithë qenien e vet... Vetëm ata që i hapin duart drejt qiellit mund ta shijojnë mbështetjen tek Allahu... Ata që ndoqën të dërguarit që sillnin lajme prej qiellit e dinë shijen e saj... Vetëm ata që njohin Sunduesin e vetëm të shtatë qiejve mund të ngrihen deri tek mbështetja në Allahun. Prandaj, mbështetja tek Allahu është vepër e njerëzve të qiellit, jo të "esfel-i safilin"-ëve (më të ulëtit e të ulëtëve)...

Ata që nuk arrijnë t'i shkëpusin këmbët prej tokës, si mund ta dinë çdo të thotë të fluturosh? Ata që janë lidhur në tokë me njëmijë e një lloj prangash, si



mund të lëvizin? Ata që merren me lloj-lloj hallesh të tokës, si mund të marrin hise prej qiejve? E si mund t'i lejojë ata egoizmi i vet, lakmitë dhe luftërat e pambarim t'i besojnë një qenieje tjetër përveç vetes së tyre? Nuk i lejon! Në këtë situatë, për ta, edhe dita, edhe nata është një... Njeriu bëhet peng i dyshimeve dhe frikës. Ai harron se çdo gjë e ka një Sundues dhe përpiqet vazhdimisht të sundojë gjithçka. Qetësia e braktis atë qetësisht dhe zhurmat plaçkitin brendësinë e tij. Ndërsa pyetjeve pa përgjigje nuk u vjen fundi.

Shqetësimi i furnizimit, ankthi i jetesës dhe angazhimi me këtë botë nuk e lënë asnjëherë rehat. Dyshimet, ankthet, pritshmëritë, probabilitet, vallë-t, sikur-et, mbase-t nuk kanë fund për të. Ai humbet në vorbullën e skenarëve të fatkeqësive...

Pa besuar Atë, nuk mund të arrijë paqen zemra e njeriut. Pa u mbështetur tek Ai, nuk mund ta dijë ç'është qetësia. Pa i zënë besë Atij, nuk mund ta ndjejë veten të sigurt. Kemi nevojë të zëmë besë, të besojmë e të strehohemi, sepse jemi të dobët. Jeta jonë, vdekja jonë, madje edhe furnizimi i ynë është në dorën e Tij. Kur i besojmë kësaj dhe mbahemi tek Ai, atëherë mund të shijojmë ëmbëlsinë e mbështetjes tek Ai. Atëherë mund të shpëtojmë prej hamallëkut të peshave të panevojshme, e të lehtësohemi. Prej peshave që kërrusin belin tonë dhe prej tepricave që nuk jemi të detyruar të bartim, mund të shpëtojmë vetëm atëherë kur punët tona t'ia besojmë Atij. Ne nuk mund të jemi sundimtarët e gjithçkaje, nuk mund të mbajmë gjithçka nën kontroll, nuk mund t'i llogaritim të gjitha mundësitë dhe nuk mund të harrojmë dobësinë dhe të qenit njeri, e të hymë në rolin e Zotit. Jemi të detyruar të kuptojmë se peshoret nuk peshojnë vetëm materien, llogaria nuk mund t'i lihet vetëm numrave dhe ajo nuk mund të bëhet vetëm me matematikë.

Ne përpiqemi ta nxjerrim qiellin nga bota jonë dhe synojmë të ndërtojmë një botë për veten tonë vetëm në tokë. Dhe, as që jemi të vetëdijshëm se po e burgosim veten në tokë, ndërkohë që sipër kemi qiejt pakufi. Madje as që e ngremë kokën të shohim zogjtë që fluturojnë në paqe. Fakti që nuk ngopemi, nuk dimë të ngopemi dhe nuk jemi të kënaqur me atë që meritojmë, na ndan prej zogjve dhe nuk mund të fluturojmë. Ne nuk arrijmë të shpëtojmë prej ngushtësisë së shpirtit pavarësisht gjithçkaje që kemi. Nuk arrijmë ta kuptojmë se boshllëkun brenda vetes nuk mund ta mbushim me materialen.

Por, a ka më të qetë se ai që thotë: ***"...Më mjafton Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh!"*** (Teube, 129.) E çfarë tjetër mund ta bëjë njeriun të përjetojë lehtësinë që i jep ajeti: ***"...Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai!.."*** (Talak, 3.)? E çfarë mund ta pengojë njeriun nga ngritja pasi të ketë thënë: ***"Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë!.."*** (Nisa, 132.) dhe ***"O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde!"*** (Al-i Imran, 26.)? Mjafton që ai të ngrejë kokën e të shohë zogjtë. Një harabel i vogël, një pëllumb, ose një pupëz mund t'i tregojë rrugën...

Profeti ynë (a.s.), na dha shembull zogjtë, por a ka ndonjë prej nesh që mund t'u bëhet shembull zogjve?..



ILAÇI SHËRUES
I DHUNËS DHE INJORANCËS

SEKRETI I FAMILJES

I Madhi Zot unitetin, apo të qenit Një, e ka veçuar vetëm për veten e Tij. Çdo gjë e ka krijuar në çift. Po ashtu edhe njeriun e krijoi çift, burrë dhe grua.

Krijoi me vullnetin e Tij familjen me anë të bashkimit të burrit dhe të gruas. Dhe kështu, njerëzimi u zhvillua nga Ademi dhe Havaja me anë të formimit të familjes së parë në emër të Zotit.

Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun të dobët dhe të pafuqishëm, në mënyrë që ai që prej momentit të lindjes të ndjejë nevojë për dashurinë e nënës dhe edukimin e babait. Më pas, me fshehtësinë e përkohshmërisë dhe urtësinë e plakjes, prindërit i bën që të kenë nevojë për fëmijët e tyre.

Në këtë mënyrë lind dhe krijohet një shoqëri e lidhur ngushtë me ndjenjat dhe virtytet e bukura të dashurisë, mëshirës, besnikërisë, bindjes, dhembshurisë dhe respektit. Ademi (a.s.), babai i parë i gjithë kësaj familjeje të madhe, ishte gjithashtu një pejgamber.

Urtësia Hyjnore i dhuroi burrit dhe gruas disa të drejta dhe detyra të përshtatshme me karakteristikat e tyre të krijimit. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për kopenë tuaj. Burri është bariu i familjes dhe ai është përgjegjës për kopenë e tij. Gruaja është bareshë e shtëpisë dhe ajo është përgjegjëse për kopenë e saj." (Buhariu, Vesajat, 9)

Në këtë botë të mbushur me sprova i Madhi Zot dëshiroi formimin e familjes dhe krijimin e një strukture shoqërie në përputhje me kënaqësinë e Tij.

Andaj sipas kësaj urtësie:

Pejgamberët i zgjodhi nga familjet fisnike, të pastra dhe të moralshme. Ndërkohë që përhapnin urdhëresat hyjnore tek njerëzit, ata shpalosnin edhe moralin, sjelljen dhe urtësinë e tyre ashtu sikurse dëshironte i Madhi Zot, por përpara se ta praktikonin këtë edukim tek popujt e dërguar, ata në radhë të parë e ushtronin në familjet e tyre.

Edhe i nderuari i kësaj bote, Pejgamberi (a.s.), rrjedh nga një familje e ndritur, e pastër në moral, e kujdesshme në hallalin martesor; pasardhëse e familjes së Ibrahimit (a.s.) dhe Ismailit (a.s.).

Pas një rinie të pastër dhe të moralshme, në moshën njëzet e pesë vjeçare krijoi së bashku me nënën e besimtarëve, Hatixhen (r.a.), familjen më të qetë, më të lumtur dhe me të bukur të botës. Kjo familje dhuroi më pas martesën e bekur në mes të Fatimes (r.a.) e Aliut (r.a.) dhe pasardhësit e tyre Hasanin e Hysejnin, duke i treguar njerëzimit sekretin e krijimit të familjes më të lumtur dhe më të hajrit në botë, atë të familjes së Ehli Bejtit.

Tradita e Profetit të Zotit (a.s.), dhe morali i tij i lartë luajnë një rol të rëndësishëm në lumturinë e jetës sonë familjare...

KRITERET E FAMILJES SË LUMTUR...

Kriteri ynë më i vlefshëm është ai i të Dërguarit të Allahut r. Ekuilibri i lumturisë sonë është i nderuari i botës, Pejgamberi (a.s.). Ndërsa pasuria dhe cilësia e botës së tij shpirtërore vjen e shpalosur më së miri tek ne në karakterin e sahabëve të ndritur, shokëve të tij më të mirë.

Mashkull apo femër, grua apo burrë, djalë apo vajzë apo kushdo qoftë, do ta arrijë lumturinë dhe kënaqësinë në të dy botët në sajë të përpjekjeve të tij për

t'ia pështatur kriteret personale sa më shumë të jetë e mundur formës së asaj familjeje të bekuar.

Gjatë historisë së ymetit të Muhamedit (a.s.), e cila i ka kaluar tanimë katërmbëdhjetë shekuj, personat apo shoqëritë që u kanë kushtuar kujdes këtyre kritereve hyjnore, janë bërë pjesë e mëshirës. Ndërsa ata që qëndruan larg këtyre kritereve, u bënë pjesë e dhunës dhe dëshpërimit.

Në ditët e sotme; zemrat e ngurtësuara, të cilat kanë braktisur Sunetin dhe traditën mëshiruese të Pejgamberit (a.s.), duke rënë pre e robërisë dhe forcës, ushtrojnë dhunë ndaj gruas.

Sipas Islamit, femra në statusin e nënës, fsheh Xhenetin nën këmbët e saj, si grua mbrohet nga ligji, si fëmijë rritet në mes bukurive natyrore; për fat të keq sot shtypet, dhunohet, dëbohet nga shtëpia, detyrohet të prostituojë, torturohet dhe shfrytëzohet në çdo lloj forme.



Porse:

Sa i hidhur është përfundimi i një diamanti në koshin e mbeturinave! Sa i pafat është ai diamant, i cili përfundon në mbeturina! I ngjashëm me lulen e mbirë në cepin e një kalldrëmi që është e destinuar për t'u shtypur nga këmbët e kalimtarëve.

E NGJASHME ME KOHËN E INJORANCËS...

Edhe përpara se drita e Islamit ta zhdukte errësirën e periudhës së injorancës, gjendja e femrës ishte po ashtu e shkretuar. Foshnjet e lindura vajza, sapo vinin në këtë botë, përballeshin me fytyrën e zemëruar të babait. Nën ulërimat e pashpresa të nënës rrëmbeheshin nga duart e saj për t'u groposur më pas të gjalla.

Edhe nëse shpëtonte nga vdekja, vuajtjet e saj nuk mbaronin. Gjatë armiqësive të lindura në mes të fiseve, ofendimi më i madh që i bëhej armikut ishte nëpërkëmbja e ndonjë femre.

Edhe nëse martohej nuk mbaronin vuajtjet për të. Në kohën e anarkive, aty ku drejtësia dhe ligji nuk ekzistonin, e martuar qoftë apo e pa martuar, femra ishte gjithmonë një gjallesë e nënçmuar, e shtypur, e privuar nga të drejtat, e përdorur si plaçkë ose si diçka e rëndomtë, e cila shërben vetëm për të ngopur dëshirat seksuale.

Përfshirja e prostitucionit në mbarë shoqërinë dhe vala rrëmbyese e imoralitetit po e dërgonin gruan drejt shtigjeve akoma më të pakapërcyeshme. Brezi i ardhshëm ishte i pambrojtur. Qoftë nëna, qoftë bashkëshortja, qoftë fëmija... Gruaja ishte e pambrojtur!..

Ajo ishte periudha e terrorit të vërtetë. Shpallja hyjnore e Pejgamberit tonë të dashur r, erdhi si përgjigje ndaj këtij terrori të egër dhe brutal.

Në suret mekase ndjekin njëra-tjetrën paralajmërimet e mëposhtme:

"Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet. Për çfarë faji ishte vrarë: Atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur *(për këtë Ditë).***"** (Tekvir, 8-9, 14)

"Kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s'di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!" (Nahl, 58-59)

I dërguari si mëshirë për mbarë botën, dhurata më e mirë e njerëzimit, Pejgamberi (a.s.), nuk u mjaftua vetëm me çlirimin e njeriut qoftë burrë apo grua, fëmijë apo i moshuar, nga duart e arrogancës, dhunës, poshtërsisë dhe urrejtjes, por mbrojti me mëshirë e dashuri kafshët dhe bimët.

Në njëfarë mënyre, i strehoi nën krahët e tij të mëshirës të gjitha krijesat...

KRAHUN E TIJ TË MËSHIRËS E SHTRIU PËR GJITHËSINË...

Zemra e tij nuk u pajtua me dëmtimin e pemëve, qoftë edhe me shkundjen e tyre të panevojshme...

Ndërhyri me mëshirë...

Nuk u pajtua asnjëherë me mjeljen e kafshëve në kushte të papastra dhe sjellje të ashpër, sidomos mjeljen e gjithë qumështit duke mos lënë aspak për të voglin e saj.

I dha rëndësi mësimit të pastërtisë, dashurisë dhe mëshirës.

Nuk ishte i kënaqur me bisedat e stërgjatura gjatë udhëtimit mbi kafshë.

Mësoi të përsosurën dhe të hijshmen.

Zemra i tha të mos e shqetësonte nënën e qenushit, e cila po i jepte gji të voglit të saj, andaj vendosi ta ndryshojë drejtimin e gjithë asaj ushtrie të madhe.

Praktikoi sakrificën dhe sjelljen e mirë.

Sidomos kur pa një fole milingonash që po digjej nga zjarri u skuq nga zemërimi, madje edhe devetë e mbingarkuara erdhën dhe u ankuan tek ai.

Shkurtimisht, në atë vend ku drita e tij, u përhap, dhuna u shua njëherë e mirë përgjithmonë; prania e tij, i la vend mëshirës, hijeshisë dhe të bukurisë.

> *"Mos ta urrejë ndonjëri gruan e tij. Nëse nuk i pëlqen një sjellje e saj, do t'i pëqejë një sjellje tjetër."*
>
> *(Muslim, Rada, 61)*

Ashtu sikurse të gjitha krijesat e tjera edhe gruaja është bërë pjesë e mëshirës së Pejgamberit (a.s.).

Femra zuri vend në pallatin mbretëror, në fronin e krenarisë së të qenit nënë. U përcaktuan të drejtat dhe detyrat në formën më të përshtatshme të krijimit të saj si në martesë, divorc, trashëgimi, në shtëpi, në publik apo në çdo situatë tjetër. Gjeti respektin dhe krenarinë e humbur.

Pejgamberi (a.s.), për ta realizuar këtë gjë, i foli ymetit të tij;

U FOLI NDËRGJEGJEVE

Urdhëroi dhe tha: *"Më i miri ndër ju është ai i cili sillet më mirë me familjen e tij!.."* (Ibn Maxhe, Nikah, 50; Darimi, Nikah, 55)

"Mos i rrihni gratë!.. Ata që i rrahin gratë e tyre, nuk janë më të mirët në mesin tuaj." (Ebu Davud, Nikah, 42; Ibn Maxhe, Nikah, 51)

Me sjelljen e tij u kthye në një shembull të pashoq të jetës familjare.

Duke u nisur nga fakti se nëna e njerëzimit Havaja u, ishte krijuar nga brinjët e burrit, Pejgamberi (a.s.), këshillonte që të mos ushtrohej forcë, dhunë apo presion mbi gratë të cilat paraqitnin sjellje të gabuara, sepse një veprim i tillë nuk do të japë rezultat, por të punohet për t'i edukuar me sugjerime dhe këshilla të mira dhe të dobishme.

Urdhëronte që çështjet e vogla të mos zmadhoheshin, si dhe këshillonte që durimi, mbështetja tek Zoti e kënaqësia për atë çka posedon janë rrugë më të hajrit për njeriun.

Përhapi urdhërin hyjnor:

"Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, duroni sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, pikërisht për këtë Allahu do t'ju sjellë shumë të mira." (Nisa, 19)

Sa bukur e tregon ky shembull sjelljen e butë dhe të çiltër që rekomandonte i Dërguari i Allahut (a.s.), ndaj gruas dhe ndaj gjinisë femërore në përgjithësi:

"Mos ta urrejë ndonjëri gruan e tij. Nëse nuk i pëlqen një sjellje e saj, do t'i pëqejë një sjellje tjetër." (Muslim, Rada, 61)

KUJDES QË TË MOS THYHEN KRISTALET!

Tek arabët ishte zakon që gjatë udhëtimit të nxiteshin devetë me anë të këngëve dhe melodive në mënyrë që të ecnin më shpejt. Gjatë një udhëtimi, një skllav i quajtur Enxheshe duke kënduar i shpejtoi ritmin e ecjes devesë me melodinë e tij. Me qëllim që të mos shqetësoheshin gratë të cilat ndodheshin mbi devetë, Pejgamberi (a.s.), me një krahasim të këndshëm i thotë:

"O Enxheshe! Kujdes që të mos thyhen kristalet!" (Buhari, Edeb, 95; Ahmed, III, 117.)

Sa shembull të bukur ka zgjedhur i Dërguari i Allahut (a.s.), në rastin e përngjasimit të grave me kristalet. Këshilla të rëndësishme të cilat na tregojnë ndjeshmërinë dhe delikatesën që posedon shpirti, mendja dhe trupi fizik femëror.

Pejgamberi (a.s.), u mundua gjithë jetën e tij, me qëllim që drejtësia, morali i lartë dhe sjelljet e mira të mbizotëronin si brenda familjes ashtu edhe në shoqërinë përreth. Edhe në fjalët e tij të fundit nuk harroi që t'ia linte emanet ymetit (popullit) të tij këto këshilla:

Enesi (r.a.), tregon kështu:

Gjindeshim pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), në momentin e vdekjes së tij. Para se të ndërronte jetë, na tha tri herë;

"Kijeni frikë Allahun në çështjen e namazit!"

Pastaj vazhdoi dhe tha:

"Frikësojuni Allahut për njerëzit të cilët ndodhen nën urdhrin tuaj, frikësojuni Allahut për të dobëtit si: gratë e veja dhe fëmijët jetimë..." (Bejhaki, Shuab, VII, 477)

Profeti (a.s.), i kushtoi rëndësi të madhe sidomos të drejtave të personave të dobët brenda shoqërisë, të cilët ishin më të rrezikuar për t'u shtypur, nënçmuar, keqtrajtuar apo lënë pas dore. Kështu që para se të vendoste ligjet që imponoin drejtësinë, u mundua të edukojë ndërgjegjet dhe zemrat e njerëzve. Shkatërroi arrogancën e periudhës së injorancës dhe themeloi çiltërsinë e besimit dhe madhështinë e Islamit. Kur filluan të zbrisnin ajetet në lidhje me sistematizimin e së drejtës familjare, shokët e nderuar ishin kthyer në një shoqëri të përsosur, saqë në shenjë respekti ndaj Profetit (a.s.), përdornin gjithmonë shprehjet:

"Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë" ose "Nëna dhe babai im të qofshin falë o i Dërguari i Allahut!..."

Tanimë kjo shoqëri e tëra, duke përfshirë mashkull e femër, fëmijë e të moshuar, zbatonte me përpikmëri urdhrat jetësore të Profetit (a.s.), duke mos pranuar asnjë formë tjetër adhurimi përveç adhurimit ndaj Zotit të Gjithësisë.

Kështu që ajo femër e periudhës së injorancës (para-islame), në të cilën përveç lidhjes biologjike nuk kishte asnjë vlerë tjetër dhe ku shfrytëzohej dhe dhunohej vazhdimisht, në shekullin e artë (periudhën e parë islame), ajo fitoi vlerat jetësore të dërguara nga i Madhi Zot nëpërmjet të Dërguarit të Tij (a.s.) dhe arriti një shkallë të lartë duke u quajtur "femër e denjtë dhe e devotshme"...

FEMRA E DEVOTSHME

Prej mbështetësve të parë shpirtërorë të Pejgamberit të Zotit (a.s.) dhe e para e cila i besoi mesazhit të tij, ishte gruaja e parë dhe nëna e besimtarëve, Hatixhja (r.a.).

Urtësia dhe caktimi hyjnor deshën që Pejgamberi (a.s.), të rritej jetim, pa mbështetjen e prindërve, por pati në krahë një grua të devotshme sikurse Hatixhja (r.a.). Ajo i dhuroi qetësi dhe lumturi në familje dhe për një kohë të gjatë ishte shtylla kryesore për mbështetjen materiale dhe shpirtërore të tij. Më pas edhe ajo bashkëshorte dhe grua e begatë ndërroi jetë. Pejgamberi (a.s.), së bashku me të kishte kaluar vitet më të vështira të shpalljes hyjnore. Sa e sa probleme dhe fatkeqësi kishin përballuar së bashku. Asnjë fatkeqësi nuk e preku aq shumë zemrën e Pejgamberit (a.s.), sa vdekja e Hatixhes (r.a.). Atij viti ku humbi këtë grua të begatë iu dha emri "viti i dëshpërimit".

Edhe gradën e lartë të dëshmorit të parë në Islam e fitoi një grua, Sumejja (r.a.).

Ajo çka e shndërroi Omerin e egërsuar nga zemërimi, me shpatën e zhveshur dhe qëllimin për të "vrarë Pejgamberin (a.s.)" në Omerul-Faruk (Omerin e drejtë), ishte vendosmëria e mbushur me besim e motrës së tij, Fatimes (r.a.).

Lindën dhe u edukuan në këtë periudhë të artë për njerëzimin nëna të tilla si bija e Pejgamberit të Zotit (a.s.), Fatimja (r.a.)...

U rritën figura madhështore në fushën e diturisë dhe edukimit, si ajo e nënës së besimtarëve, Aishes (r.a.), e cila ishte njëra prej themelueseve të para të shkencave të Fikhut dhe Hadithit.

Kopja e parë e Kuranit Famëlartë iu besua nënës së besimtarëve, Hafsës (r.a.).

Lindën nëna si Esmaja, bija e Ebu Bekrit, vendimtare si një fortesë e palëkundshme përballë dhunës dhe padrejtësive. Nesibja (r.a.), trimëreshë që u bë mburojë në luftë përkrah Pejgamberit të Zotit (a.s.).

I cilësuar si kalifi i pestë dhe sunduesi i një periudhe të artë, Omer bin Abdulazizi, ishte nipi i një shitëseje qumështi, e cila dridhej nga frika ndaj Zotit dhe në shpirtin e saj mbizotëronte ndjenja e mirësisë.

Në këtë shoqëri të mbështjellë me mëshirë, femra ishte një heroinë e padukshme. Ato rritën Fatihët, çliruesit e vendeve dhe të zemrave prej Semerkandit e deri në Kajravan, brenda një kohe të shkurtër. Ato u kthyen në simbol të heronjve në luftërat çlirimtare dhe fitoret e shumta. Njëra prej këtyre fitoreve ishte edhe ajo e Çanakkale-së.

NJË NËNË MËSHIRUESE

Hudhejfe (r.a.), tregon kështu:

Një ditë nëna më pyeti:

"Kur je takuar për herë të fundit me Pejgamberin (a.s.)?"

Unë iu përgjigja;

"Ka disa ditë që nuk e kam takuar dot."

Ajo u zemërua shumë dhe më kritikoi shumë ashpër.

Atëherë unë i thashë:

"Nënë e dashur! Prit, mos u zemëro! Po shkoj menjëherë tek i Dërguari i Allahut (a.s.), ta fal namazin e akshamit së bashku me të dhe t'i kërkoj që të lutet për mua dhe për ty." (Tirmidhi, Menakib, 378; Ahmed, V, 391-2.)

Nëna të ngjashme merituan gjithmonë respektin më të lartë, dashurinë e pafundme dhe falënderimet

e përjetshme për veprat, fjalët dhe këshillat e tyre të arta. Andaj një sahab vjen një ditë dhe pyet;

"Kush është personi më i rëndësishëm, të cilin duhet ta ndihmoj dhe të sillem mirë me të?"

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

"Nëna jote!"

Sahabiu e pyeti;

"Po pas saj kush vjen?"

Pejgamberi (a.s.), u përgjigj;

"Nëna jote!"

Sahabiu e pyeti përsëri:

"Po pastaj kush vjen?"

Pejgamberi (a.s.), përsëri u përgjigj:

"Nëna jote!"

Kur sahabiu e pyeti përsëri:

"Po pastaj kush vjen?"

Këtë herë i Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj;

"Babai yt!" (Buhari, Edeb, 2)

Një shembull i gjallë i respektit për nënën, është sjellja që shpaloste i Dërguari i Allahut (a.s.), kundrejt nënës së tij të qumështit. Sa herë që e shikonte nënën e tij të qumështit, Halimen, e thërriste "O nëna ime e dashur!", i paraqiste respektet më të ngrohta, e shtrinte rida-në (pelerinën e tij) dhe i thoshte të ulej mbi të. Nëse kishte ndonjë nevojë, ia plotësonte menjëherë. (Ibn Sa'd, I, 113, 114)

"O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!"

(Furkan, 74)

Ata që tregojnë respekt ndaj nënës së tyre dhe sillen në formën më të mirë me të, meritojnë gjithmonë përgëzimin e Zotit të Gjithësisë dhe të Pejgamberit (a.s.).

Një ditë i Profeti (a.s.), urdhëroi dhe tha:

"Më kishte marrë gjumi dhe e pashë veten time në Xhenet. Dëgjova zërin e dikujt i cili po lexonte Kuran. Pyeta;

"Kush është ky?"

Më thanë:

"Ky është Harith bin Nu'man."

Më pas Pejgamberi (a.s.), vazhdoi duke thënë:

"Ja kështu fitohet mirësia, ja kështu fitohet mirësia!"

Harithi (r.a.), ishte një sahabi, i cili sillej shumë mirë me nënën e tij. (Ahmed, VI, 151-152; Hakim, IV, 167.)

Edhe figurat e ndritura në historinë e Islamit, të cilat ndoqën rrugën e artë të Pejgamberit (a.s.), përmenden ndër shekuj për shembullin e respektit dhe të dashurisë që treguan ndaj nënës.

Imami Azam Ebu Hanife, e kundërshtoi ofertën e kalifit të asaj kohe, Mensurit, në postin e gjykatësit të Bagdatit, për shkak se nuk dëshironte të mbarte pëgjegjësinë e dhënieve të fetvave. Si përfundim u burgos. Edhe në atë gjendje madje, i vetmi shqetësim që kishte, ishte se nëna e tij do të dëgjonte lajmin dhe do të mërzitej për këtë gjë.

Abdurrahman Xhami shprehej shumë bukur, ndërsa fliste për domosdoshmërinë e falënderimit të përjetshëm ndaj nënës së devotshme kur thotë:

"Si të mos e dua nënën time. Ajo më mbajti për një kohë në barkun e saj, për një kohë në krahët e saj, ndërsa gjithë jetën në zemrën e saj."

Në këtë formë dëshironte që në fillim të respektohej nëna e tij, po ashtu të fitonte edhe sevapet e sadakasë së vazhdueshme (sadekatul-xharije).

Pas atyre burrave që kanë ndyshuar popujt dhe botën fshihet gjithmonë një nënë e devotshme.

Edhe nënat me meritën e plotë të respektit dhe të falënderimit, janë gjithmonë lapidarë të vetësakrifikimit për fëmijët e tyre. Në portretin e tyre është mëshiruar gjithmonë morali i ëmbël, si cilësi dalluese në të gjitha format e edukimit dhe për këtë arsye merituan domethënien e fjalës:

"Nëna është një shkollë më vete"

Ato nuk janë thjesht nëna të fëmijëve të tyre, por nënat e të gjithë ymetit të Muhamedit.

ZGJIDHJA E VETME, DEVOTSHMËRIA

Zgjidhja e vetme është një edukim i cili u flet shpirtërave, një edukim i moralshëm, i cili lulëzon zemrat, praktikon devotshmërinë, praktikon mirësinë.

Feja jonë mbron këta pesë faktorë si përmbledhës të të gjitha rregullave dhe moralit islam:

1. Mbrojtja e jetës;
2. Mbrojtja e mallit (pasurisë);
3. Mbrojtja e fesë;
4. Mbrojtja e mendjes;
5. Mbrojtja e brezave (gjeneratave).

Në këto pika nuk bëhet asnjë tolerim. Nëse nuk u kushtohet rëndësi brezave të ardhshëm, familjes

dhe martesës, nëse nuk parandalohet imoraliteti dhe alkooli, atëherë nuk është e mundur mbrojtja as e jetës dhe as e pasurisë. Po ashtu, nëse nuk i dilet për zot fesë dhe nuk zbatohet devotshmëria, nëse nuk qëndrohet larg nga imoralja dhe egoizmi, atëherë mbrojtja e familjes dhe e gjeneratave nga mashtrimet e djallit dhe kurthet djallëzore është e pamundur.

Kurani Famëlartë na mëson se duhet të lutemi në këtë mënyrë për një familje të qetë dhe të mbarë:

"O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!" (Furkan, 74)

Një brez i artë dhe një grua e mirë buron vetëm nga një shoqëri e devotshme.

Gratë e ndershme dhe të sjellshme meritojnë burra të urtë dhe të devotshëm. Në familjet e privuara nga devotshmëria dhe të zhytura në gjynahe nuk mund të ketë qetësi dhe lumturi, por gjithmonë padrejtësi dhe zemërim.

Për një brez të mbarë, për fëmijë të hajrit, është e domosdoshme që kafshatat e përziera me gjak para se të lindë dhe të përziera në qumësht, pasi të lindë të jenë të hallallit. Kafshatat i japin fëmijës energjinë e duhur në sajë të mënyrës më të cilën ato janë fituar. Kafshata haram bëhet shkak i errësirës, shthurjes dhe dhunës tek fëmija, ndërsa kafshata hallall i bëhet qetësi, udhëzim dhe mëshirë.

Një familje e qetë nuk formohet e vetme, ka nevojë për mbrojten e Zotit, pasimin e të Dërguarit (a.s.), ka nevojë për përpjekje dhe dua (lutje).

Kjo dua (lutje) e shprehur në ajetin e mësipërm të Kuranit, zë vend pas renditjes së më shumë se dhjetë cilësive të robërve të devotshëm të Allahut. Domethënë, qetësia në familje arrihet vetëm atëherë kur cilësitë e radhitura në Kuran të përputhen me një jetë modeste, të ndritur me dhikër dhe namaz nate, të mbushur me frikë për Ahiretin, larg rrugëve që të çojnë në imoralitet, shpërdorim dhe koprraci. Larg dhunës, padrejtësisë dhe gënjeshtrës, e nënshtruar me pendim dhe zbukuruar me vepra të mira, jo e verbër dhe e shurdhër përballë urdhrave hyjnore, por e gjallë, e ndjeshme dhe vigjilente.

Dijetari i madh i Pakistanit, Muhamed Ikbali, e shpreh në këtë formë poetike pozicionin e femrës myslimane brenda një shoqërie të tillë të devotshme:

O FEMRA MUSLIMANE!

"O ti femra myslimane! Mbulesa jote është perdja e nderit tonë. Drita në fytyrën tënde, është vaji e kandilit të besimit tonë.

Pastërtia në krijimin tënd, është mëshirë prej Zotit, është forca e fesë, është themeli i ekzistencës së ymetit tonë.

Ti je ajo që ua mëson shehadetin (dëshminë islame) për herë të parë fëmijëve të sapo ndarë nga qumështi. Dashuria jote rregullon çdo punë, çdo lodhje, çdo mendim e çdo fjalë.

O ti femra myslimane në të cilën janë lënë amanet mirësitë e fesë së Zotit! Zjarri i kësaj feje të madhërueshme është ndezur me frymën tënde.

Ky shekull është hipokrit, mashtrues, pamjen e jashtme e ka të zbukuruar, ndërsa përbrenda mban erë. Hajdutët e këtij shekulli ia presin rrugën karvanëve, të cilët shtegtojnë në rrugën e fesë dhe besimit.

I "mençuri" i këtij shekulli është i verbër, nuk e njeh Krijuesin.

Vetëm ata të cilët kanë dalë jashtë njerëzillëkut mund t'i nënshtrohen zinxhirëve egoistë të këtij shekulli.

Sytë e këtij shekulli janë të mbuluar me gjak dhe pasion rebelues. Shikimin e ka të pamëshirshëm. Qerpikët i ngjajnë kthetrave të cilat dëshirojnë të nënshtrojnë çdo pre që u bie në dorë.

Ai që bie në kurthet e këtij shekulli mendon se është i lirë. Ka pirë helm nga duart e tij dhe akoma mendon se është i shëndetshëm.

Ti je uji i jetës për fidanin e njerëzisë. Ti je ajo që ruan amanetin e këtij ymeti.

Zbulo dhe medito mbi cilësitë e tua të larta në krijimin tënd të pastër! Fatimja e nderuar (r.a.), është një shembull i rrallë për ty, mos i ndaj sytë dhe zemrën tënde prej saj!

Deri atëherë kur, edhe prej degëve të pemës tënde të lindë një fryt si Hysejni; dhe prej lulishtes së trëndafilave të rikthehet edhe njëherë ajo stinë."

O Zoti ynë! Na dhuro në familjet tona qetësinë dhe lumturinë që i dhurove familjes së të Dërguarit Tënd (a.s.)...

O Zoti ynë!

Bëji familjet tona burime të mirësisë dhe bereqetit. Na i ruaj prindërit dhe na i udhëzo fëmijët tanë.

Amin!..

القدوس

Es-Selam

Ilir Hoxha

MANIFESTIMI I QETËSISË DHE PAQES

Kuptimi leksikor i fjalës selam është, *"të jesh larg prej çdo lloj mangësie dhe të mete trupore e shpirtërore. Të gëzosh qetësi, paqe dhe gëzim"*. Kur i atribuohet Allahut, nënkupton, *"Atë që është i pastër prej çdo mangësie që mund të vijë në mendje, që nuk i ndryshon gjendja si qeniet e krijuara, që është i pamundur të zhduket, që me gjithëpërfshirshmërinë e Tij, është burimi i sigurisë dhe i fal hare kësaj bote dhe botës tjetër"*.

Fakti që kjo fjalë është bërë emër i Allahut të Madhëruar në trajtën paskajore, tregon se kur thuhet, "të jesh i sigurt dhe të japësh siguri me kuptimin e plotë të fjalës", të të vijë në mendje Allahu, sepse përveç Tij askush nuk e ka këtë fuqi dhe se vetëm Ai është burimi i pashoq dhe i pakufishëm i qetësisë, paqes dhe sigurisë, që janë edhe qëllimet më të mëdha të jetës së njeriut.

Nëse e mendojmë se, edhe në kohët kur e ndjejmë veten më tepër të sigurt, na afrohen tinëzisht pa e vënë re fare nga jashtë dhe brenda nesh, sëmundje, kriza sociale dhe shumë rreziqe të tjera, do ta kuptojmë më mirë se vetëm "Ai" është i sigurt në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Përmbajtja e këtij emri, vë në dukje dy çështje themelore: Faktin se Allahu i Madhëruar është i pastër prej çdo mangësie dhe se është burimi i sigurisë. E para prej këtyre cilësive, është e afërt me kuptimin e emrit "Kuddus", ndërsa e dyta me kuptimin emrit "Mu'min". Sipas Elmallëllës, kjo është arsyeja që emri "Selam", në vendin e vetëm ku e cilëson Allahun në Kuran[1], është përmendur midis këtyre dy emrave.

Në Kuran, fjalët që burojnë prej rrënjës, "s-l-m", kalojnë në 140 vende. Në të shumtën e rasteve, këto fjalë janë përdorur me kuptimin e "suksesit në këtë botë dhe shpëtimit në botën tjetër". Nisur nga kjo, manifestimi i emrit "Selam", vazhdon që prej lindjes deri në vdekje dhe prej aty deri në ringjallje.[2]

Në jetën e kësaj bote paqja dhe siguria është për atë që ndjek udhëzimin e ardhur nga Allahu.[3] Allahu i Madhëruar, ka dëshiruar siguri për të gjithë profetët e Tij[4]. Pas tufanit, njerëzit zbritën të sigurt prej anijes së Nuhut.[5] Zjarri u urdhërua të bëhet i sigurt/shpëtim për Ibrahimin (a.s.).[6] Ne jemi urdhëruar që sa herë të hyjmë në shtëpitë tona, të përshëndetim me selam, që është një dëshirë për bollëk, begati dhe hare.[7] Përshëndetja me emrin "Selam", është konsideruar si simbol i myslimanizmit.[8] Gjithashtu, prej nesh është kërkuar që kur të përballemi me njerëz grindavecë e injorantë, të themi "selam" dhe të largohemi prej aty.[9] Ndërsa Nata e Kadrit, si një mirësi prej Allahut, është një natë e mbushur me paqe dhe siguri deri në mëngjes.[10]Kur Melekët ua marrin shpirtin njerëzve të mirë, i përshëndetin me selam.[11]Xheneti është vendi i selamit (sigurisë dhe paqes)[12]dhe këtë siguri e paqe mund ta arrijnë vetëm robërit durimtarë.[13]Në xhenet

1. - shih. Hashr, 23.

2. - shih. Merjem, 15, 33.
3. - shih. Taha, 47.
4. - shih ajetet përkatëse në suren Saffat
5. - shih. Hud, 48.
6. - shih. Enbija, 69.
7. - shih. Nur, 61.
8. - shih. Nisa, 94.
9. - shih. Kasas, 55; Furkan, 63.
10. - shih. Kadr, 5.
11. - shih. Nahl, 32; Ahzab, 44.
12. - shih. En'am, 127.
13. - shih. Ra'd, 24; Furkan, 75.



do të hyhet në mënyrë të sigurt e në paqe.[14] Allahu do t'i përshëndesë me "selam" banorët e xhenetit[15] dhe, po ashtu edhe banorët e xhenetit do të përshëndetin njëri-tjetrin me "selam".[16]

Selami, që është simboli i qetësisë dhe paqes, është një fjalë që do të dëgjohet vazhdimisht në çdo cep të xhenetit.[17] Kurani, na lajmëron se në ditën e kijametit, asgjë nuk do të ketë dobi për njeriun përveç zemrës së paqësuar (kalbi selim).[18] Sipas Kushejrit, "kalbi selim", nënkupton një zemër të pastër, të shëndetshme dhe të pastruar prej urrejtjes dhe zemërimit. Kjo, është një shkallë që mund të arrihet vetëm me dorëzimin e zemrës tek Allahu dhe me anë të shpëtimit prej ndjenjave të idhujtarisë, urrejtjes, gjynaheve dhe mosbindjes ndaj Allahut.

Zemra e paqësuar, është një strukturë shpirtërore dhe morale në të cilën nuk gjendet urrejtje, tradhti, qëllim i keq dhe smirë. Njeriu që e zotëron këtë zemër, ushqen qëllime të mira ndaj të gjithë myslimanëve. Gazaliu thekson se, që njeriu të takohet me Zotin e tij me zemër të paqësuar, është kusht që aftësitë e tij të mendimit, të mos jenë në anë të kundërt. Dhe kjo, mund të realizohet vetëm nëse mendja arrin të mbizotërojë gjithmonë egon.

Fjala "Islam", që buron prej të njëjtës rrënjë me fjalën "Selam", shpreh dorëzimin pa kushte ndaj Allahut dhe nënshtrimin ndaj Tij.[19] Në të njëjtën kohë, fjala Islam, që përmban edhe kuptimet "silm/paqe" dhe "selamet/shpëtim", mund të përkufizohet si "një rrugë dorëzimi që premton paqe në këtë botë dhe shpëtim në botën tjetër". Nëse shihet nga kjo pikëpamje, manifestimi më i madh i emrit "Selam", është vetë "Islami". Gjithashtu, edhe termi "teslimijet/dorëzim", i cili rrjedh prej kësaj rrënje, është një nga kuptimet që formojnë thelbin e Islamit, që është feja e Allahut.

Në shumë ajete, është urdhëruar dorëzimi i plotë ndaj Allahut.[20] Po ashtu, është bërë e ditur se, devotshmëria më e mirë, mund të arrihet në sajë të dorëzimit[21] dhe se në xhenet mund të hyjnë vetëm ata që ia dorëzojnë veten Allahut.[22] Mbi të gjitha, i gjithë universi është dorëzuar ndaj Allahut dhe arritja e shpëtimit, është e mundur vetëm me shfaqjen e dorëzimit.[23]

Po ashtu, edhe fjala "mysliman", vjen nga e njëjta rrënjë me emrin "Selam" dhe shpreh dorëzimin ndaj Allahut duke qëndruar larg gjynaheve, por edhe arritjen e shpëtimit si rezultat i këtyre. Në këtë mënyrë, myslimani, tek i cili manifestohet emri i Allahut "Selam", siç e përkufizon edhe Profeti ynë (a.s.), "është ai prej dorës dhe gjuhës së të cilit janë të sigurt njerëzit (nuk dëmton askënd në asnjë mënyrë)".

Në bazë të asaj që na ka mësuar Profeti (a.s.), pas dhënies së selamit në fund të namazit, bëhet duaja që fillon me, "Allahumme ente's-selam ue minke's-selam...". Fjala "selam" që përdoret këtu dhe që shpreh madhërim, përmendet edhe si emër i Allahut, por edhe si theksim se shpëtimi/siguria vjen prej Tij. Kjo praktikë, tregon se namazi është një mjet që të çon drejt shpëtimit.

Për ruajtjen e gjallërisë shoqërore, është kusht që ndër njerëz të përhapet dashuria, siguria dhe paqja. Sukseset individuale e shoqërore, mund të kenë mundësi zhvillimi vetëm në ambiente të tilla paqeje. Për arritjen dhe vazhdimësinë e këtij ambienti që është manifestim i emrit Selam, Profeti (a.s.), na ka urdhëruar të përshëndesim njëri-tjetrin me këtë emër të Allahut, i cili në të njëjtën kohë është edhe një lutje. Kur e përshëndesim njëri-tjetrin me emrin e Allahut, Selam, ne kemi dëshiruar prej Allahut për personin tjetër të gjitha mirësitë që përfshin ky emër.

Njeriu, tek i cili manifestohet ky emër i bukur i Allahut, sjell paqe dhe hare, duke përhapur qetësi përreth vetes. Askush nuk dëmtohet aspak prej tij. Ai është i durueshëm ndaj problemeve që i hapin të tjerët. Nuk debaton me injorantët dhe indiferentët. Qëndron larg prej çdo sjellje të ulët që është në kundërshtim me dinjitetin njerëzor. Gjithashtu, ai qëndron larg të dyshimtave dhe jeton si një njeri i matur, fisnik dhe shembullor. Ai është bërë njësh me harmoninë dhe rregullin që gjendet në thelbin e ekzistencës. Një njeri i tillë, ka arritur një bashkim që fal qetësi me të gjitha sendet dhe ndodhitë. Ai ka arritur shpëtimin, ka gjetur paqen për veten dhe fal qetësi edhe përreth vetes.

14. - shih. Hixhr, 46; Kaf, 34.
15. - shih. Jasin, 58.
16. - shih. Junus, 10; Ibrahim, 23.
17. - shih. Merjem, 62; Uakia, 26.
18. - shih. Shuara, 89.
19. - shih. Huxhurat, 17.
20. - shih. Nisa, 65; En'am, 14; Haxh, 34; Gafir, 66; Ahzab, 56; Zumer, 54.
21. - shih. Nisa, 125
22. - shih. Bekare, 112.
23. - shih. Al-i Imran, 83.



ISMAIL FARUKI

MBARTËS I SHQETËSIMIT TË LINDJES DHE PERËNDIMIT

JETËSHKRIMI:

Dr. Ismail Raxhi Faruki është lindur në qytetin Jafa të Palestinës, në vitin 1921. Mësimet e para islame i filloi në xhami dhe në shtëpinë e tij, nga duart e të atit, i cili ishte kadi fetar. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në shkollat domenikane franceze, pastaj mbaroi bachelorin për filozofi në Universitetin Amerikan të Bejrutit në vitin 1941. Në kohën e protektoratit anglez punoi prefekt i krahinës së Xhelilit, deri në kohën e krijimit të shtetit sion, ku për një periudhë kohe iu bashkëngjit rezistencës dhe pastaj emigroi në Amerikë. Atje arriti të marrë dy diploma magjistrature, njëra në filozofinë fetare nga Universiteti Indiana në vitin 1949, ndërsa tjetra nga Universiteti Harward në vitin 1951. Në vitin 1952 mbrojti doktoraturën në Universitetin Indiana me temë: "Teoria e mirësisë: Aspektet metafizike dhe epistemologjike të vlerave".

Pas zotërimit të tij të filozofisë perëndimore, historisë dhe mësimeve të dy feve, hebraike dhe të krishtere gjatë studimeve të tij në Amerikë, Faruki ndjeu nevojën e thellimit në njohjen e fesë së tij islame. Kështu që udhëtoi për në Egjipt ku dhe studioi katër vjet në Ez'her (1954-1958). Aty ndërtoi një kulturë të qëndrueshme islame, pastaj kthehet në Perëndim dhe fillon mësimdhënien në Universitetin McGill të Kanadasë, studiues në fakultetin e teologjisë në të njëjtin universitet, ku studimet e bëra aty sollën si rrjedhojë librin e tij me vlerë: "Morali i krishterë, analizë historike dhe metodike e ideve të tyre mbizotëruese".

Në vitin 1961 Faruki kaloi në Pakistan për të marrë pjesë në themelimin e Institutit të Kërkimeve Islame në Karaçi. Pastaj, kthehet në Amerikë, profesor në Universitetin e Çikagos (1963-1964) dhe në Universitetin Sirakuza (1964-1968), pastaj vendoset në Universitetin Temple, në të cilin qëndroi përreth 18 vite, nga viti 1968 deri në vitin që vritet (bie dëshmor) në 1986.

AMBASADORI I PRERË NË BESË:

Tradita e mbretërve të vjetër është që ambasadorët, të cilët përcjellin letrat e tyre të mos vriten. Këtë traditë politike ata e konsideronin prej shenjave të besës dhe fisnikërisë. Por ambasadori i Lindjes së Mesme në Perëndimin e Krishterë, Ismail Faruki u vra pabesisht dhe tradhtisht.

Faruki erdhi në Perëndim duke mbartur me vete zullumin e Lindjes, ndërkohë që gjeti në pritje të tij zullumin e Perëndimit, ku adhurimi i Izraelit kishte zënë vendin e fesë së krishterë. Më 18 Ramazan

1406 - 27 maj 1986, Ismail Faruki u vra me goditje me thikë, ai dhe bashkëshortja e tij, dr. Limja Faruki, studiuese e artit dhe arkitekturës islame, për shkak të qëndrimeve të tij të prera në mbrojtje të çështjes së tij dhe çështjes së popullit palestinez dhe për shkak të diskreditimit që i bëri ideologjisë sioniste dhe rrënjëve të saj. Dhe për shkak të punës së tij të palodhur në fushën e thirrjes islame dhe kulturës së tij në shoqërinë amerikane. Megjithëkëtë, idetë e Farukit nuk vdiqën, por ato formuan energji në rrugën e vështirë, në të cilën eci, rrugën e fjalës së vërtetë përballë zullumqarëve.

DIJETARI ENCIKLOPEDIST

Ismail Faruki ishte shembulli i dijetarit enciklopedist mysliman. Ai kishte njohuri të thella në filozofi, në fe, në histori dhe në lloje të ndryshme të shkencave njerëzore. Ai zotëronte në mënyrë perfekte arabishten, frëngjishten dhe anglishten. Gjithashtu ai shkruante në këto tri gjuhë, sikur secila prej tyre të ishte gjuhë nëne.

Dr. Xhemal El-Berzukhi tregon njëherë se në vitin 1972 ftoi Farukin për një darkë në shtëpinë e tij. Aty miku i ftuar foli rreth një orë përpara një grupi pasues të feve të ndryshme. Në fund të bisedës, një prift kërkoi të marrë fjalën dhe tha: "Mësova sonte për krishterimin, më shumë se sa kam mësuar për të gjatë studimeve të mia përgjatë tridhjetë viteve të kaluara".

Tradita e mbretërve të vjetër është që ambasadorët, të cilët përcjellin letrat e tyre të mos vriten. Këtë traditë politike ata e konsideronin prej shenjave të besës dhe fisnikërisë. Por ambasadori i Lindjes së Mesme në Perëndimin e Krishterë, Ismail Faruki u vra pabesisht dhe tradhtisht.

Ismail Faruki la pas një pasuri të çmuar intelektuale, prej tyre njëzet e pesë libra dhe më shumë se njëqind studime e shkrime në fushën akademike. Pjesa më e madhe e librave të tij, akoma janë në origjinal në gjuhën angleze dhe ato më të vërtetë janë një kontribut cilësor në çlirimin e mendjes së myslimanit dhe rinovimit të mendimit islam. Disa prej librave të tij janë përkthyer në gjuhën arabe si, "Atlasi i civilizimit islam". Ashtu siç u diplomuan nga duart e tij një numër i madh dijetarësh të specializuar në fushën e feve, prej tyre: Prof. Dr. Muhamed Halife Hasen, drejtor i Qendrës Karadawi për Mesatarizmin Islam dhe Rinovim në Douha.

Kontributi i Farukit në lëmin e rinovimit mund të përmblidhet në katër fusha: Civilizimi islam, Analogjia e feve, Isalmizimi i dijeve dhe Dukuria sioniste.

CIVILIZIMI ISLAM

Në fushën e civilizimit islam, Faruki dhe bashkëshortja e tij, Limja, shkruajnë një libër voluminoz dhe shumë të vlefshëm, "Atlasi i Civilizimit Islam", libër i cili "lindi jetim nga të dy prindërit", ashtu siç e shkroi në parathënien e tij, dr. Hisham Et-Talib, sepse dr. Ismaili dhe bashkëshortja e tij ranë dëshmorë, ndërkohë që libri akoma ishte në shtypshkronjë. Qe begati e Allahut, që libri doli dëshmitar i atyre të dyve dhe mbrojtës i mundit dhe sakrificës së tyre. Libri në fjalë është ajka e mendimit të tyre në periudhën e pjekjes (intelektuale) dhe kompetencës (shkencore). Ndoshta, ekzistenca e këtij libri është argument, i asaj që Perviz Mensur shkroi në fjalën ngushëlluese në varrimin e Farukit, duke thënë: "Me të vërtetë boja e dijetarit është më e fortë se thika e tradhtarit".

Ky libër dallohet për gjerësinë e vizionit dhe shtrirjen e tij në kohë dhe vend. Sepse njohuritë e gjera, të cilat i kultivoi Faruki në historinë e feve, sidomos në hebraizëm dhe krishtianizëm dhe eksperiencën e thellë, të cilën e fitoi Limja në artin dhe arkitektologjinë islame, i bëri ata të dy ta vendosin Civilizimin islam në një kontur të gjerë e të pashembullt. Të dy autorët adoptuan një metodë të re, në të cilën sqaruan "kontenkstin", brenda të cilit lindi ky Civilizim, "esencën" unike, e cila sillej rreth tij, "formën", me të cilën shprehte veten e saj dhe "zbulesat", me të cilat shfaqet (këto janë katër lëmitë e librit).

ANALOGJIA E FEVE

Në fushën e studimeve të analogjisë së feve, Faruki redaktoi "Atlasin e Historisë së Feve të Botës" dhe shkroi një kapitull të veçantë për Islamin në këtë atlas. Ashtu siç shkroi një parathënie të mjaftueshme, ku sqaron lartësinë e Mesazhit Islam dhe superioritetin e tij ndaj të gjitha feve, përfshiu të gjitha virtytet, me të cilat kanë ardhur mesazhet qiellore të mëparshme dhe u mbështet në mendje

dhe logjikë. Shkroi librin "Morali i krishterimit", në të cilin kritikoi bazat teorike dhe historike të kësaj feje përmes burimeve të saj parësore. Disa priftërinj të Universitetin McGill, në të cilin Faruki shkroi librin, u munduan ta ndalojnë botimin e tij, me pretekstin se libri lëkund besimin e krishterë në zemrat e lexuesve.

Faruki ka edhe libra të tjerë në fushën e fesë, si: "Islami dhe fetë e tjera", "Trilogu hebraik-krishterik-islamik" dhe si bashkautor i librit "Fetë e mëdha aziatike". Shto këtu edhe librat e tij të veçantë për Islamin, si "Teuhidi dhe kushtëzimet e tij në mendim dhe jetë".

ISLAMIZIMI I DIJES

Në fushën e islamizimit të dijes, Faruki vendosi bazat e teorisë së riformulimit të dijeve njerëzore dhe shoqërore bashkëkohore, me formulim islam, ku këto njohuri kthehen në ndihmëtare pozitive për kulturën e myslimanëve dhe jo rrjedhë përmbytëse, duke i marrë identitetin, fenë dhe besimin atyre.

Shkroi librin "Morali i krishterimit", në të cilin kritikoi bazat teorike dhe historike të kësaj feje përmes burimeve të saj parësore. Disa priftërinj të Universitetin McGill, në të cilin Faruki shkroi librin, u munduan ta ndalojnë botimin e tij, me pretekstin se libri lëkund besimin e krishterë në zemrat e lexuesve.

Faruki ekzaminoi sëmundjen e myslimanëve bashkëkohorë në sistemin e tyre intelektual dhe arsimor të përgjithshëm dhe mungesën e një shtytësi të fortë dhe mendimi dinamik në kulturën e tyre. Ai kritikoi dualizmin e arsimit, mes atij fetar tradicional dhe civil bashkëkohor, çfarë dha si rezultat një qenie të copëtuar e të lëkundur, që nuk dinte tjetër, veçse imitimit: Imitimin e gjyshërve, të cilët kanë ikur, ose të perëndimorëve të ndryshëm, në fe dhe kulturë. Ndërsa, ajo që kërkohet është një arsim, në të cilin rrjedh shpirti islam përmes mësimdhënies së lëndës së Civilizimit Islam në të gjithë universitetet dhe degët e tyre, pa marrë parasysh specialitetin e tyre.

Ndërsa specialistët në studimet islame, patjetër duhet të zhyten në shkencat e reja njerëzore për pasurimin dhe ndërtimin e aftësive të tyre teorike, për të qenë në nivelin kulturor-intelektual bashkëkohor.

Faruki themeloi së bashku me dr. Abdulhamid Ebu Sulejman Institutin Shkencor të Mendimit Islam, për të qenë qendër kriticizmi dhe planifikimi për kulturën e përbërë, të cilën e ka të nevojshme myslimani sot.

DUKURIA SIONISTE

Në lëmin e njohjes së dukurisë sioniste Faruki shkroi tre libra: "Islami dhe problemi i Izraelit", "Rrënjët e sionit në fenë hebraike" dhe "Popujt bashkëkohorë në fenë hebraike". Idetë e tij dalloheshin për thellësi e gjerësi. Faruki ishte i thelluar në historinë e fesë hebraike dhe evoluimin e civilizimit perëndimor.

Ai e vendosi sionizmin në këtë rrjedhë historike dhe arriti në përfundimin se myslimanët e sotëm e kanë keqkuptuar armikun më të rrezikshëm të tyre, që është Izraeli, duke e shikuar atë thjesht si një dukuri kolonialiste perëndimore, apo thjesht përsëritje e luftërave të kryqëzatave, e në fakt ai është e gjitha kjo dhe shumë më tepër. Pastaj e vuri lindjen e Izraelit në rrjedhën e tre ideve të rëndësishme:

- Kalimi ekzistencial i gabimit në krishterim (ontological passage of guilt).

- Tërheqja dhe kthimi i epokës së iluminizmit evropian në arritjen e barazisë për hebrenjtë.

- Centrizmi etnik në fenë hebraike.

Në këtë mënyrë hebrenjtë shkulën rrënjët e tyre nga Evropa dhe i mbollën në Palestinë, dhe janë ata pikërisht mbartësit e gjithë këtyre peshave.

Por, e vërteta është se ai e bëri këtë shumë vonë dhe se puna e tij, ishte thjesht zgjidhje kalimtare dhe pesimiste, që nuk është zgjidhje përfundimtare për dilemën hebraike. Ajo është dilemë krishterimi perëndimor, ku nuk mund të zgjidhet në kurriz të një ymeti madhështor, që po përparon sot rishtas drejt teatrit të historisë.

E mëshiroftë Allahu Ismail Farukin, mbartësin e shqetësimit të Lindjes dhe të Perëndimit.

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

MOS PUNONI! PUSHONI!

Idris Arpat

Problemi psikologjik që shfaqet me fillimin e punës në krye të javës, pas pushimit të fundjavës dhe i cili njihet edhe si "sindroma e së hënës", është një prej problemeve më të mëdha në perëndim në lidhje me sektorin e punës. Dita që fillon me armiqësi në të hënën dhe me sy që nuk dinë të hapen, vazhdon me stres e vështirësi. Pesimizmi që ndjehet gjatë gjithë ditës së hënë dhe të martë, lehtësohet disi me veprimtaritë që bëhen në fundjavë. E mërkura kalon pak më lehtë. Sidoqoftë, ka kaluar gjysma e javës dhe në mendje kanë filluar të vijnë vërdallë planet për fundjavë. E enjtja kalon duke menduar se çfarë do bëhet në fundjavë. Ndërsa ditën e premte është pothuajse e pamundur të përqendrohesh për shkak të mendimeve në lidhje me planet për fundjavë. Gjithsesi, fundjava vjen dhe përpiqesh ta shijosh minutë për minutë me shpresën që të mos mbarojë kurrë. Pas saj vjen përsëri e hëna, përsëri puna, përsëri stresi...

Në vitet e kaluara, një gazetë kishte zhvilluar disa reportazhe me shumë shkrimtarë të famshëm për të mësuar se ku dhe kur do t'i bënin pushimet. Por vetëm një shkrimtar dha përgjigje ndryshe nga të tjerët. Ai tha kështu:

"Vendi im për pushime është në krye të daktilografit tim, ndërsa koha është çdo ditë që bëj punën time. Unë e dashuroj punën time, prandaj për sa kohë që punoj, e konsideroj se jam me pushime."

Kur i lexova këto fjalë, më erdhi në mëndje thënia e Konfucit:

"Bëni punën që dashuroni, që të mos punoni!"

Nëse nuk dëshironi të vuani prej sindromës së të hënës, nëse e konsideroni të padurueshme të jetoni çdo ditë minutë për minutë si në torturë deri në fund të javës dhe, nëse e keni të vështirë ta filloni javën me fytyrë të vrenjtur dhe pa dëshirë, mund të bëni vetëm një gjë: Të bëni punën që dashuroni!

Puna që bëni tani, mund të mos jetë ajo që dashuroni. Nëse keni aftësi dhe mundësi, ndërrojeni punën dhe filloni të bëni punën që dashuroni. Nëse nuk keni mundësi, atëherë përpiquni ta dashuroni dhe të ndjeni kënaqësi prej punës që bëni. Mendoni për njerëzit të cilët kanë dobi prej prodhimit ose prej shërbimit tuaj. Përpiquni të imagjinoni fytyrat e njerëzve të cilëve u lehtësohet puna, gëzohen dhe buzëqeshin në sajë të punës suaj. Mendoni se sikur të mos jeni ju, nuk do të jetë as ajo punë, ose të paktën nuk do të bëhet aq mirë sa e bëni ju. Nuk them të ngarkoni mbi supe të gjithë peshën e vendit të punës. Por them që çfarëdo pune të bëni, nëse e bëni me gjithë zemrën dhe dashurinë tuaj, do të bëheni njeriu që e bën më mirë atë punë. Edhe nëse dy bukë kanë të njëjtat përbërje, përgatitje dhe pjekje, ajo që bëhet me dashuri, do të dallohet menjëherë. Në të njëjtën mënyrë dallohet edhe cilësia e çdo pune që bëhet me dashuri. Në këtë mënyrë, edhe njerëzit që përfitojnë prej prodhimit apo prej shërbimit tuaj bëhen të lumtur, edhe ju do të pushoni, duke e bërë punën tuaj me dashuri.

Tashmë hiqni dorë prej lodhjes duke punuar dhe pushoni duke punuar!..





KATROR, PASTAJ KUB, MË PAS BUSULL

Edison Çeraj

Ndoshta nuk e teprojmë nëse themi se katrori është fara dhe arketipi i gjithë artit islam.

Që këtu duhet thënë se, në thelbin e tij, arti e tejkalon si kohën ashtu edhe hapësirën, pra çdo lloj ngjyrese të mundshme që i mbivendoset për arsye kryesisht studimore/klasifikuse; domethënë, nuk ka art islam, hebre, të krishterë, laik, budist, me këtë apo me atë kombësi e kështu me radhë. Arti është ai që është pavarësisht kush e bën e në ç'hapësirë shfaqet.

Por, siç mund ta marrim me mend, ka raste e kontekste kur këta përcaktorë bëhen të pashmangshëm, në veçanti kur duam të shënjojmë një fenomen a çështje të caktuar që lidhet me këtë apo atë shpërfaqje/pamësi të krijimtarisë artistike.

Nga tri format bazë, rrethi, trekëndëshi dhe katrori, katrori gëzon një lloj harmonie të plotë, dhe si i tillë edhe siguri. Rrethi është disi i papërballueshëm, kurse trekëndshi ushtron trysni.

Edhe Burckhardt-i e nis librin e tij *Arti i Islamit* pikërisht me Katrorin, domethënë me Qabenë. Siç do e shohim në vazhdim, Katrori apo Kubi nuk është vetëm një orientim ritual, por edhe burimi i estetikës islame e më gjerë. Motivi i katrorit, në një trajtë apo në një tjetër, është i pranishëm pothuajse në të gjithë artin islam, në veçanti në rastin e dekoreve të ndryshme.

Kjo na jep të kuptojmë se etika (rituali) dhe estetika (krijimtaria artistike) janë një sipas botëkuptimit islam. Ndarje të tipit "art laik" dhe "art fetar" janë plotësisht të huaja në botën islame.

Meqë në këtë kontekst kemi nevojë për një penë të thukët si ajo e Burckhardt-it, rreshtat në vijim na i mundëson bujaria e tij. Natyrisht, vende-vende, kemi perifrazuar dhe përshtatur, kuptohet duke mos e cenuar thelbin.

Siç e dimë, çdo musliman kthen fytyrën e tij nga Qabeja për të recituar lutjet kanonike dhe çdo xhami është e orientuar në drejtim të saj. Çdo gjë rrjedh së këndejmi.

Ka edhe një arsye tjetër për të folur rreth Qabesë: ajo është objekti i vetëm i ndërtuar që luan një rol detyrues në adhurimin e muslimanit. Nëse nuk është një vepër arti në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, – jo më tepër se një kub me mure – ajo i përket atij rendi gjërash që mund të quhen "protoart", përmasa shpirtërore e së cilës përkon me mitin apo me Zbulesën, varësisht prej pikëpamjes. Kjo nënkupton që simbolizmi i brendshëm i Qabesë, në formën dhe ritet që e bashkëshoqërojnë, përmban në gjendje embrionale gjithë çfarë shprehet nga arti i shenjtë i Islamit.

Roli i Qabesë si qendër liturgjike e botës muslimane lidhet ngushtësisht me faktin se ajo shpërfaq lidhjen e Islamit me traditën abrahamike dhe, që këtej, me origjinën e të gjitha besimeve monoteiste. Sipas Kuranit, Qabeja qe ndërtuar nga Abrahami dhe i biri, Ismaili, dhe qe Abrahami i cili pikënisi pelegrinazhin vjetor në këtë faltore. Qendër dhe origjinë: këto janë dy aspektet e një realiteti shpirtëror të vetëm, apo sërishmi, siç mund të thuhet, dy mundësitë themelore të çdo përshpirtshmërie.[1]

Për shumicën e muslimanëve, të falesh duke e drejtuar fytyrën nga Qabeja apo nga Meka, që është e njëjta gjë, shpreh *a priori* një zgjedhje. Me këtë akt, muslimani dallon nga hebrenjtë, që falen me fytyrë nga Jerusalemi, dhe të krishterët, të cilët "orientohen" duke u kthyer nga lindja e diellit. Ai zgjedh t'i bashkohet "fesë së qendrës", që i përngjet pemës, prej të cilës burojnë të gjitha fetë e tjera. "Ibrahimi nuk ka qenë hebre e as i krishterë", thotë Kurani,

1. "E gjithë ekzistenca e popujve të antikitetit dhe e popujve tradicionalë në përgjithësi mbizotërohet nga dy ide udhëheqëse: ideja e Qendrës dhe ideja e Origjinës." (F. Schuon, *Light on the Ancient Wolrd*, Londër, Perennial, Books, 1965, f. 7)

"por i veçuar (*hanif*) dhe i dorëzuar (*muslim*)..." (3/67) Kuptimi i këtyre fjalëve është se besimi i Abrahamit – që është tipizimi i vërtetë i muslimanit – është i pastër nga përveçimet dhe kufizimet e përfaqësuara (në sytë e muslimanëve) nga koncepti hebre i popullit të zgjedhur mbi të gjithë të tjerët, dhe nga dogma e krishterë e një shpëtimtari të vetëm (Biri i Zotit).

Duhet të theksojmë se shpjegimi kuranor i ndërtimit të Qabesë nga Abrahami nuk thekson rolin e tij si paraardhës i arabëve, – bijve të tij përmes Ismailit dhe Haxherit – por funksionin e tij si apostull i monoteizmit të kulluar dhe universal, që Islami synon ta përtërijë. Cilado qoftë baza historike[2] e këtij rrëfimi, është e papërfytyrueshme që Profeti ta ketë shpikur atë për motive pak a shumë politike, larg arsyeve të sinqeritetit. Arabët e epokës paraislame ishin të dhënë pas gjenealogjisë – që në të gjitha rastet është një tipar i nomadëve – dhe nuk do ta kishin pranuar kurrë ndërfutjen e një paraardhësi, gjer më sot të panjohur.[3] Nëse Bibla nuk i referohet asnjë faltoreje të themeluar nga Abrahami dhe Ismaili në Arabi, kjo ndodh sepse nuk ekziston asnjë arsye të përmendet një faltore e vendosur jashtë tokës dhe fatit të Izraelit. Ajo nuk e ka njohur kurrë fatin shpirtëror të ismailitëve me përfshirje në premtimin e Zotit për Abrahamin. Le të theksojmë përfundimisht, – pa u larguar shumë nga tema jonë – se është tipike për një "gjeometri" hyjnore, e cila është e saktë dhe e paparashikueshme njëherësh, të përdorë një faltore abrahamike të humbur në shkretëtirë dhe të harruar nga komunitetet e mëdha fetare të kohës, si një pikënisje për përtëritjen e monoteizmit në shtëpinë semite.[4] Pyetja që kaq shumë studiues të Islamit i bëjnë vetes, se ç'ndodhi me Mekën që solli një fe të re?, mund të shtrohet anasjelltas: për ç'arsye kjo fe e re u shfaq fillimisht në këtë vend?

Kjo formë e shquar arkaike e faltores së Mekës përputhet me origjinën abrahamike atribuuar asaj. Në të vërtetë, ajo është rrënuar dhe rindërtuar shpesh, por bash emri i saj, Qabe, që do të thotë "kub" është një garanci se forma e saj nuk është modifikuar thelbësisht. Ajo është disi e çrregullt: dymbëdhjetë metër e gjatë, dhjetë metër e gjerë dhe rreth gjashtëmbëdhjetë metër e lartë.

Tradicionalisht ndërtesa mbulohet me një "mbulesë" (*kisweh*) që ndërrohet çdo vit dhe, që prej periudhës abaside, bëhet në pëlhurë të zezë qëndisur me gërma të arta, që në një stil të goditur dëshmon njëkohshëm aspektin abstrakt dhe atë misterioz të ngrehinës. Tradita e "veshjes" së faltores duket të jetë futur nga një mbret i lashtë himiarit dhe me gjasë është pjesë e një tradite fort të nderuar semite, e cila është e huaj në stil për botën greko-romake: të veshësh një shtëpi, kësodore, do të thotë ta trajtosh atë si një trup të gjallë apo si një arkë që mbart pushtet shpirtëror, dhe kjo është mënyra si e kuptonin atë arabët. Lidhur me të njohurin Gur të Zi, ai nuk është mbyllur në qendër të Qabesë, por në një mur të jashtëm afër njërit prej këndeve. Ai është një meteorit, pra një gur i rënë nga qielli, dhe Profeti e ka konfirmuar karakterin e tij të shenjtë.[5] Përfundimisht, do të përmendin rrethinën e jashtme, përafërsisht rrethore, të *haramit*, që është pjesë e faltores.

Qabeja është e vetmja faltore islame që mund të krahasohet me tempullin. Ajo quhet rëndom "shtëpia e Zotit" (*bejtu 'Llah*) dhe në fakt ka karakterin e një "banese hyjnore", aq paradoksale sa mund të tingëllojë në një mjedis musliman, ku ideja e transcendencës hyjnore mbizotëron gjithçka. Por, Zoti "banon", si të thuash, në qendrën e parrokshme të botës, ashtu siç "banon" në qendrën e brendshme të njeriut. Duhet kujtuar se e Shenjta e të Shenjtave në Tempullin e Jerusalemit, që ishte një farë "banese" hyjnore, kishte formën e kubit, bash si Qabeja. E Shenjta e të Shenjtave, apo debiri, mbante Arkën e Besëlidhjes, ndërsa brendësia e Qabesë është e zbrazët[6], ose përmban vetëm një perde, që tradita orale e quan "perdja e Mëshirës Hyjnore (*rahmeh*)".

Kubi është i lidhur me idenë e qendrës, qëkur është sintezë kristalore e hapësirës gjithëmbarë, ku secila nga faqet e tij përkon me një nga drejtimet kryesore, përkatësisht zeniti, nadiri dhe katër pikat kardinale. Sjellim ndërmend se pozicionimi i Qabesë nuk përkon plotësisht me këtë skemë, sepse janë katër këndet dhe jo anët e Qabesë që korrespondojnë me katër pikat kardinale; sepse, pa dyshim, pikat kardinale, në konceptin arab, nënkuptojnë katër "shtyllat këndore" (*erkan*) të universit.[7]

Takimi i të gjithë akteve të adhurimit mbi një pikë të vetme bëhet i dukshëm në afërsi të Qabesë, ku moria e besimtarëve përkulet në faljen e përbashkët nga të gjitha anët drejt një qendre të vetme; ndoshta nuk ekziston ndonjë shprehje më e drejtpërdrejtë dhe më e prekshme e Islamit.[8]

2. Për një histori të shenjtë është e mundur të jetë më e vërtetë - në kuptimin e përmbajtjes së një realiteti më të lartë - sesa një referim pastërtisht empirik ose historik i ngjarjeve.

3. Shih: Y. Moubarac, *Abraham in the Quran*, coll. Etudes muslmanes, Paris, Vrin, 1958.

4. Ekzistojnë forma monoteizmi edhe jashtë familjes semite apo a - rahamike.

5. Për të gjithë popujt e antikitetit, një gur i rënë nga qielli mund të jetë vetëm i shenjtë; doemos, pasi gjërat janë çfarë ato nënkuptojnë.

6. Kjo është e vërtetë edhe për "qelizën" e disa tempujve hindu, "qelizë" apo rrjetë (gharbagriha) që ka gjithashtu formën e kubit.

7. *Apokalipsi* i Shën Gjonit e përshkruan Jerusalemin Qiellor si një sintezë të pavdekshme të botës në formën e një kubi.

8. Brenda Qabesë nuk ka më "orientim" ritual. Dallimi midis çdo dre - timi kovergues zhduket, dhe tradita e Profetit kërkon që të kryhen katër lutje të shkurtra në çdo anë të faltores. Kështu, në qendrën shpirtërore të botës, kundërtitë apo kundërkahjet që karakterizojnë botën nuk janë më mbizotëruese, por të mbizotëruara. Sipas një interpretimi sufi, Qabeja përkon me zemrën si vatër e "Pranisë" hyjnore, dhe rrotullimet e pelegrinëve përreth Qabesë të ndërmendin rrotullimin e përhershëm të mendimeve apo meditimeve rreth qendrës së parrokshme të shpirtit.



Hutbe të zgjedhura

Naim Drijaj

Këshilla drejtuar studentëve

Ajetet e para që iu shpallën Pejgamberit tonë Muhamedit (a.s.), ishin pesë ajetet e para së sures "El-'Alak" ku Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë)."*** (Alak, 1) Urdhri hyjnor "Lexo" nuk i drejtohet vetëm Pejgamberit (a.s.), personalisht, por i drejtohet të gjithë ymetit mysliman.

Zoti (xh.sh.), thotë: ***"Dije se nuk ka Zot tjetër të vërtetë përveç Allahut!"*** (Muhamed, 19) Pra, nuk është thënë "besoje" por "dije", ngase besimi pa dije mund të devijojë.

Allahu i madhëruar thotë: ***"Allahu do t'i ngrejë në shkallë të larta ata të cilët besuan prej jush dhe atyre të cilëve u është dhënë dija, Allahu di çdo gjë që punoni."*** (Muxhadile, 11)

Dituria është fitimi më i mirë, pozita më e ndershme, depozita më e çmuar, fryti më i ëmbël, nuk ka fitim më të madh se pronari i dijes, i cili me diturinë e tij udhëzon për të mirë dhe ndalon nga e keqja. Imam Shafiu (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Nuk vjen gjë e mirë prej atij që nuk e do diturinë. Prandaj, mos u miqëso me një njeri të tillë, sepse dituria është jeta e zemrave dhe pishtari i arsyes". Islami nuk ka bërë ndonjë dallim ndërmjet vajzave dhe djemve për sa i përket edukimit dhe arsimimit të tyre. Në këtë pikëpamje, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Dituria është detyrim për çdo mysliman."* (Ibn Maxhe) Sufjan ibn Ujejne ka thënë: "Ai i cili e kërkon diturinë i është besatuar Allahut."

Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Njerëzit kanë nevojë më shumë për t'u pajisur me dituri, sesa të pajisen me ushqim dhe pije. Sepse për ushqim njeriu gjatë ditës ka nevojë vetëm një apo dy herë, kurse për dituri njeriu ka nevojë deri në çastin e vdekjes".

DITURIA KA SI SYNIM KRYESOR:

1. Zhdukjen e injorancës. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Transmetoni prej meje qoftë edhe një ajet!"* (Buhariu)

2. Përsosjen e moralit. Profeti (a.s.), ka thënë: *"Myslimani më i mirë është ai që ka moralin më të mirë."* (Tirmidhiu) Ndërsa në një hadith tjetër Ai thotë: *"Jam dërguar që t'i përsos virtytet e moralit."* (Hejthemiu, sahih)

3. Zgjidhjen e problemeve të njerëzve. Këtë e kuptojmë më mirë nga hadithi i personit që vrau 100 vetë. Në fakt, kishte mbytur 99, por për shkak të këshillave të gabuara që mori nga një i "ditur" e vrau edhe atë. Ne nuk kemi nevojë veç për dijetarë që kanë njohuri të thella fetare, por kemi nevojë për dijetarë që Zoti (xh.sh.), u ka dhënë dije dhe urtësi.

4. Ruajtjen e shoqërisë nga dukuritë dhe sjelljet negative.

5. Luftimin e ideologjive dhe bindjeve të gabuara. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Kush bën një vepër që nuk është në përputhje me udhëzimin tonë nuk i pranohet."* (Muslimi)

TË NDERUAR STUDENTË DHE STUDENTE

1. Universitetin që ju keni zgjedhur të vazhdoni studimet e larta duhet ta shikoni si një mirësi dhe dhuratë nga Zoti (xh.sh.).

2. Islami dhe feja e do njeriun që të jetë sa më i dobishëm, dhe një njeri i arsimuar dhe i ditur në përgjithësi është më i dobishëm sesa një njeri i paditur dhe jo i arsimuar. Allahu (xh.sh.), thotë: ***"A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?!"*** (Zumer, 9)

3. Myslimani duhet t'i reflektojë mirësitë e kësaj feje kudo që të jetë.

Studenti mysliman në shkollë të lartë e paraqet këtë me dy gjëra:

a). Me sjellje të mirë, komunikim të mirë me kolegët, pedagogët, duke dhënë një shembull të mirë tek të tjerët.

b). Kualitet dhe rezultate maksimale në mësime. Duke i bërë këto, indirekt ju i shërbeni edhe davetit islam.

4. Rezultatet, sjelljet dhe sukseset tuaja janë respektimi më i mirë që mund t'u bëni prindërve tuaj.

5. Vlerësimi i kohës. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Dy nga begatitë apo mirësitë e Zotit, shumica e njerëzve nuk ua dinë vlerën, shëndetit dhe kohës së lirë."* (Buhariu) Koha është gjëja më e shtrenjtë që duhet të kujdesesh për të, ndërsa është gjëja më e lehtë që mund të humbësh.

Unë jam një udhëtar i shkretë

NË RRUGËN E JETËS

Mehmet Dinç

Unë udhëtoj shumë shpesh për shkaqe të ndryshme. Pothuajse një herë në çdo javë dal jashtë qytetit dhe në shumicën e rasteve udhëtoj më avion. Rruga është e gjatë, koha është e gjatë dhe shokët e rrugës janë të shumtë në numër e të ndryshëm në karakter. Pothuajse në kushte të njëjta, ndani të njëjtin vend me njerëz të moshave dhe karaktereve të ndryshme. Në këtë mënyrë, dashje apo pa dashje, njiheni me shumë njerëz. Si rezultat i vëzhgimeve që kam bërë përgjatë udhëtimeve dhe njohurive që kam marrë në lidhje me shokët e rrugës, kam vënë re se ka dy tipa udhëtarësh.

Tipi i udhëtarit të parë është udhëtari pesimist. Këta lloj udhëtarësh mbartin një tension të gatshëm dhe të paarsyeshëm, të gjithë i shikojnë pak me dyshim sikur duan të thonë: "Nga rashë këtu?" – dhe sillen sikur po presin të dalë ndonjë problem qoftë edhe nga gjëja më e vogël. Ata nuk flasin asgjë përveç ankesave për udhëtarët që kanë rreth e rrotull dhe dialogët që të tjerët përpiqen të formojnë me ta i përfundojnë shpejt duke dhënë përgjigje të shkurtra dhe të ftohta. Prej mimikës që shfaqin gjatë shërbimi të ushqimit e bëjnë të qartë se nuk do të pëlqejnë asgjë gjatë rrugës. Për këtë arsye, marrin një lugë nga ushqimi ose nuk marrin fare dhe e kthejnë mbrapsht. Pastaj fillojnë të reagojnë në mënyrë që ta dëgjojnë edhe të tjerët, në lidhje me shijen, kripën, llojin apo dhënien e ushqimit. Ata i kontrollojnë shpejt të gjitha kanalet në ekranin që kanë përballë dhe e mbyllin pa pëlqyer asgjë. Pastaj përpiqen të flenë tërë nerva. Pas përpjekjeve të gjata, shfryjnë shumë dhe nuk flenë dot, ngrihen në këmbë dhe fillojnë të ecin lart e poshtë. Ata që flenë rehat apo ndjekin me gjithë qejf ndonjë prej kanaleve, i shohin me zemërim. Kur rrotat e avionit prekin tokën, menjëherë ngrihen në këmbë dhe përpiqen të marrin valixhet e tyre. Pastaj presin pesëmbëdhjetë minuta me valixhe në duar dhe ua bëjnë zeher çdo sekondë atyre që kanë pranë. Ndërsa pas udhëtimit kanë nevojë të pushojnë të paktën dyfishin e kohës që udhëtojnë.



Tipi i udhëtarit të dytë është udhëtari i gëzueshëm. Këta lloj udhëtarësh çdo udhëtim të tyre e fillojnë me një emocion të sigurt se do të përballen me një lumturi të re dhe e fillojnë vetë të parët dëfrimin e udhëtimit me shikimet kureshtare e fytyrat e qeshura të tyre. Në fillim të udhëtimit, i urojnë udhëtim të mbarë atyre që kanë pranë dhe bisedojnë me ta njerëzisht. Ose shikojnë poshtë sikur kanë parë gjënë më interesante të botës nga avioni që po fluturon dhe çdo herë mahniten nga ato që shikojnë. Ndërkohë që vazhdojnë të fluturojnë, e hapin ekranin që kanë përpara dhe e ndjekin me kënaqësi deri në fund filmin që kanë zgjedhur. Pastaj fillojnë të flenë me ndonjë muzikë rehatuese që e gjejnë te kanalet e muzikës. Habia e ëmbël që kanë në fytyrat e tyre kur zgjohen për të ngrënë ushqimin, u japin përshtypjen sikur kanë fjetur në një shtrat mjaft të rehatshëm. Në vaktin e ushqimit patjetër gjejnë diçka që e pëlqejnë dhe e shijojnë. Edhe nëse njeriu është i ngopur, përsëri i vjen për të ngrënë kur i sheh ata se si i hanë ushqimet që kanë përpara. Pastaj, në çdo ndërrim avioni, sado e shkurtër që të jetë koha, zbresin nga avioni, shkojnë në aeroport dhe përpiqen për të zbuluar gjëra të reja. Për shkak të tipit që kanë, patjetër gjejnë diçka të re për të zbuluar. Fundin e rrugës e përjetojnë me kënaqësi dhe ndërsa avioni i afrohet aeroportit, marrin kënaqësi nga çdo sekondë. Pasi ta mbarojnë udhëtimin, ua tregojnë atyre që i presin ato që kanë përjetuar përgjatë udhëtimit sikur të mos ishin lodhur aspak.

Në të vërtetë, edhe kjo jetë është një udhëtim. Të gjithë ne jemi udhëtarë në këtë udhëtim. Ne e kemi në dorë që të bëhemi udhëtarë pesimist dhe ta shohim me sy negativ çdo gjë përgjatë udhëtimit duke ia bërë vetes dhe të tjerëve përreth zeher të gjithë udhëtimin. Gjithashtu, ne e kemi në dorë që të bëhemi udhëtarë të gëzueshëm, ta shijojmë çdo çast të udhëtimit dhe të gjejmë / përjetojmë shumë gjëra interesante që mund të tregohen në lidhje me udhëtimin tonë. Për këtë arsye, zgjedhja më e drejtë do të ishte kjo: Të shpëtojmë nga të gjitha sjelljet pesimiste duke e lënë pas çdo gjë që kemi përjetuar dhe ta kalojmë me gëzim e hare çdo moment këtej e tutje.

Udhëtim të mbarë!

Si ndikojnë idetë e reja që prezantohen mbi kreativitetin

ÇFARË NA SHTYN NE T'I PREZANTOJMË DHE T'I NDAJMË MENDIMET TONA?

Ndoshta na ka rastisur të gjithëve të jemi të pranishëm në raste kur një folës na fton për të ndihmuar në gjenerimin e ideve të reja dhe në çast atmosfera mbulohet nga heshtja. Heshtje, ose reagime të ftohta e të stepura; pa u përpjekur të krijojmë lidhje të reja, pa bashkëpunim, pa përpunim të ideve të pakta që na ofrohen.

PSE NDODH KJO?

Kohët e fundit, një grup studiuesish nga Zvicra këtë pyetje e analizuan në këndvështrimin e një perspektive të re – jo më në një qëndrim ballë për ballë, por në kontekstin e një bashkëpunimi kreativ, online, i gjithi virtual. Pyetja ishte: "A është e rëndësishme që idetë të na paraqiten të plota e të rregullta apo në vend të kësaj të paraqiten si të papërfunduara dhe provizore?"

Secilit prej pjesëmarrësve në shqyrtim (drejtues të ekzekutivit ose studentë të masterit të Administrim-Biznesit) iu caktua një partner anonim, me të cilin do të ndërvepronte nëpërmjet një portali virtual në internet. Atyre iu (tha) komunikua:

"Ju jeni pjesë e një detyre në të cilën jeni ngarkuar që t'i jepni këshilla drejtorit strategjik të programit. Si mund ta rrisë vlerën e programit drejtori pa lëvizur në mënyrë drastike koston apo buxhetin e përgjithshëm? Mund të na sugjeroni çdo lloj ndryshimi që dëshironi."

Pjesëmarrësit shkëmbyen idetë e tyre nëpërmjet këtij portali dhe në këtë mënyrë mund të përpunonin idetë e tyre ose të partnerëve të tyre duke i zhvilluar ato. Çdo pjesëmarrësi i ishte caktuar një shenjë ngjyrë portokalli ose blu për të treguar idenë e tyre (në raport me atë të partnerit), dhe çdo ide e shprehur duhej të shoqërohej me një ikonë.

Disa çifte pjesëmarrësish u fokusuan tek ikonat të cilat ishin dizenjuar qëllimisht që të dukeshin të plota dhe të realizuara në mënyrë perfekte. Të tjerë çifte u përqendruan tek ikonat që ishin dizenjuar të dukeshin si të papërfunduara, provizore dhe pa finesë...

Partnerët gjeneruan idetë e tyre në mënyrë të pavarur dhe interaktive për dhjetë minuta, interval gjatë të cilit u regjistrua çdo ndërveprim që ata bënin mes tyre.

Profesionistë adekuatë vlerësuan realizueshmërinë dhe kreativitetin e ideve të paraqitura dhe vërejtën nivel më të lartë kreativiteti në çiftet që kishin zgjedhur ikona të paplota dhe të keqskicuara, se sa në çiftet, ikonat e të cilëve ishin të rafinuara e të rregullta. Gjithashtu, shpesh shihej që partnerët, të cilët kishin zgjedhur ikona të paplota dhe të çrregullta, i përpunonin dhe i zhvillonin idetë që prodhonin.

Pse ndodh kështu?

Studiuesit pohojnë që ikonat e plota dhe të realizuara në mënyrë perfekte, na krijojnë ndjesinë e të përsosurës dhe në njëfarë mënyre na dekurajojnë për të ndërvepruar, duke krijuar përshtypjen sikur nuk duhej të kishe pasur kurrë kontakt me ta ose të të bëheshin pjesë e ndërgjegjes. Në të kundërt, ikonat e skicuara keq dhe të paplota na shtyjnë në mënyrë të pavetëdijshme drejt bashkëveprimit dhe përpunimit të ideve.

Megjithëse simbolet veprojnë si ngacmues abstraktë dhe ndikojnë mendimet tona, ato janë gjithashtu fizike. Karakteristikat precize dhe detajet konkrete me të cilat janë bërë dhe ekzistojnë në botën fizike mund të nxisin dhe të stimulojnë mendimet tona dhe reagime të motivuara në mënyra të ndryshme. Disa tregues fizikë (burime të pjesshme, imazhe, shënim) mund të na ftojnë të bashkëpunojmë me ta

duke eksploruar, improvizuar e shtjelluar. Tregues të tjerë fizikë (burime të tjera apo imazhe), në një tjetër mënyrë, mund të na dërgojnë sinjale si “hiq dorë”, duke na dekurajuar lehtësisht të bashkëveprojmë më tej, fizikisht apo mendërisht, me idetë.

Ka një ngjashmëri mes mënyrave se si i përvetësojmë idetë tona nëpërmjet formës së shkruar dhe si mund t’i përvetësojmë dhe t’i zhvillojmë në mënyrë interaktive ato për projekte të pashkruara, siç është gjenerimi i ideve për një punë artistike tredimensionale, një ndërtesë, një kopsht etj. Në librin “Përtëritja e mendjeve: Të rimendosh kreativitetin për të frymëzuar ndryshimin” fq. 58 thuhet:

“Gjatë fazave të para të gjenerimit të ideve të reja, është e rëndësishme të mos synosh perfeksionin ose idealen tek planet ose prototipet me të cilët punon. Hulumtimet dhe zbulimet tona të para mund të kërkojnë një nivel mesatar detajesh – planifikime të pjesshme ose prototipe me rendiment të ulët, të cilët janë vetëm të përafërta me korrekten dhe jo shumë precize. Kjo mund të funksionojë më mirë nëse ndërmerren me një shkallë të moderuar të kontrollit të njohjes, duke e lënë derën e hapur për spontanitet dhe orientime të paparashikueshme. Ka shumë përfitime nëse operojmë me hapa të vegjël dhe nëpërmjet përpjekjeve të shumta, qofshin ato edhe të vogla. Të proceduarit në këtë mënyrë na jep feedback të menjëhershëm, mundësi për t’u rikalibruar dhe sesnin e progresit, duke na orientuar drejt objektivave të synuar.

MENDO PAK:

• Si është e mundur që detaje kaq të imëta – të perceptuara në botën konkrete, në fjalë, imazhe apo zhurma – të ndikojnë në tendencat tuaja për të ndërvepruar me idetë që të prezantohen?

• A ju ftojnë imazhet dhe tekstet (figurat, shënimet, skicat) që ju përdorni, për të bashkëvepruar në përpunimin e ideve me të tjerët?

• Cilat janë “ikonat” në diapazonin tënd krijues, dhe, a janë ato perfekte apo janë ftuese drejtë perfeksionit?





Cilat **FIRMA** duhet të zgjedhim për **VESHJET** tona?

Shefika Kaja Meriç

Islami ka vendosur ligje universale. Feja jonë nuk ka vendosur ligje dhe rregulla të veçanta për individët. Jeta e jetuar sipas ligjeve të Islamit është shpëtim për të gjithë njerëzimin. Ajo na tregon rrugën për të fituar të mira në këtë botë dhe në tjetrën.

Islami ka rregullat e veta rigoroze për femrat dhe meshkujt, rregulla këto që duhen ndjekur. Në fund të fundit besimtar quhet një person i cili i ndjek rregullat e fesë.

LE T'U HEDHIM NJË SY KËTYRE PYETJEVE:

Cila duhet të jetë lidhja e një myslimani me modën?

Çfarë duhet të bëjë një mysliman për të qenë në modë?

Cilat duhet të jenë rregullat që duhet të ndjekë një mysliman në veshjen e vet?

Në fakt, përgjigjja e këtyre pyetjeve ka shumë kohë që është dhënë në një mënyrë të prerë, por ne do t'i kujtojmë ato gjëra edhe një herë.

SI FILLIM TË SHOHIM SHPJEGIMIN E KËTYRE DY TERMAVE:

Çfarë do të thotë veshje firme dhe modë?

Firma është një term që përdoret për të dalluar produktet e ngjashme të prodhuara nga kompani të ndryshme.

Moda përfshin koncepte si veshje, art, muzikë, teatro, ushqim, arkitekturë etj.

Myslimanët nuk duhet të kenë dëshirë ose fiksim për të ndjekur modën. Në qoftë se keni nevojë për një shembull të cilin do e imitoni, ai duhet të jetë shembulli i të gjitha kohërave dhe që nuk vjetrohet kurrë: shembulli i Pejgamberit të nderuar salallahu alejhi ve selem. Ne duhet të duam, të veshim dhe të pëlqejmë gjërat që Ai ka dashur, veshur dhe pëlqyer.

Moda që ndjek një grua myslimane duhet të shkojë paralelisht me rregullat e Islamit. Asnjë modë nuk duhet të dalë nga rregullat që ka vendosur feja jonë. Në pikën ku moda i bie ndesh veshjes islame, gruaja myslimane duhet të ndjekë fenë e vet pa asnjë dyshim.

Në fakt, ajo që quhet modë është një lloj jetese e cila ndiqet nga ne dhe që del nga rregullat morale. Gratë dhe vajzat e reja duhet të jenë shumë të kujdesshme në këto tema. Ne duhet të jemi të kujdesshëm në momentin që përpiqemi të imitojmë njerëzit e famshëm, duhet të shikojmë edhe vlerat njerëzore të atij personi.

Ajeti kuranor i ka përcaktuar rregullat që duhet të ndjekë një femër myslimane:

Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre *(nga e ndaluara)****, ta ruajnë nderin e tyre*** *(nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)* ***dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre*** *(të kokës)* ***dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim*** *(si skllave)****, ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i***

dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët** (për tokë)**, në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin! (Nur, 31)

Allahu (xh.sh.), i ka dhënë shumë rëndësi kësaj teme, këtë e shohim nga mënyra e detajuar në të cilën është shpjeguar kjo gjë, sepse në Kuran në përgjithësi gjejmë të dhënat kryesore dhe nuk ka thellime në detaje. Në momentin kur tema është karakteri dhe personaliteti i femrës myslimane shfaqet një shpjegim i detajuar.

Nuk ka rëndësi se çfarë veshim, veshje firme apo jo, ato duhet të jenë të gjitha sipas rregullave të fesë sonë!.. Të gjitha mendimet e tjera janë gjëra tona personale që nuk kanë të bëjnë me fenë islame.

Diçka tjetër të cilën duhet të kemi kujdes është edhe fakti që nganjëherë termi i të veshurit në modë me termin e të veshurit bukur ngatërrohen. Në fillim duhet të marrim parasysh rregullat e fesë sonë dhe pastaj duhet të kujdesemi për të veshur gjërat të cilat na shkojnë. Bukuria apo siguria që fiton një njeri nga veshjet e modës që përdor shuhet në momentin që ajo modë e humb suksesin e vet. Besimtarja duhet të ketë një stil të vetin dhe një qëndrim origjinal.

Veshja e një rrobe firmato duke e treguar atë, duke i bërë reklamë nuk i shkon një besimtareje. Për më tepër që ky qëndrim tregon krenari dhe arrogancë. Pejgamberi yen i nderuar i ka dënuar ato që krenohen me veshjet e tyre.

Le ta përfundojmë këtë shkrim me ajetet që flasin në lidhje me rregullat që duhen ndjekur në fenë tonë:

"O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: 'Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t'ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t'ju lëshoj si është më mirë." (Ahzab, 28)

"O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme! (Ahzab, 32)

"O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre** (të kokës)* ***përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë." (Ahzab, 59)

DUAJA JONË:

O Allah! Strehohemi tek Ti për të na mbrojtur nga mëkatet e kësaj kohe të shthurur që na duken të bukur e tërheqës! Përsërisim fjalët e Jusufit (a.s.): "Padyshim egoja të çon në rrugë të gabuar. Vetëm në qoftë se Allahu të mëshiron..."

O Allah, na mbro edhe ne ashtu siç e ke mbrojtur Jusufin (a.s.), nga ai mëkat i keq, por në dukje tërheqës. Na bëj prej atyre që pendohen me sinqeritet të thellë. Na i fal gabimet e të kaluarës. Mos na ndaj nga Resulallahu dhe shokët e Tij, bëj që gjithmonë të ecim në gjurmët e tyre... Amin.



Jetimi im, i mjeri im, i vetmi im

Ajshenur Vurall

Sa emër me vlerë është emri "Fatime" për myslimanët. Ai ishte emri i bijës së Pejgamberit, (a.s.) dhe emri i bashkëshortes së Ebu Talibit, që u kujdes për të Dërguarin e Allahut (a.s.), pas vdekjes së nënës së Tij, Emines. Ne duhet të diskutojmë shumë rreth kësaj zonje, sepse ajo është një zonjë shembullore për njerëzit, në mënyrë që ta kalojmë me sukses njërën prej sprovave më të mëdha... Ajo i shërbeu një fëmije jetim, e ushqeu dhe e rriti atë. Këtë e bëri në një mënyrë aq të përsosur, saqë kur ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), hyri në varrin e saj, u shtri aty për një kohë dhe këmishën e tij ia dha asaj për qefin, në mënyrë që të mos ndëshkohej në varr... E kujtoi atë gjithmonë me mirësi. Sa fat i madh!..

Edhe sot ka ngjarje që i dëgjoj vazhdimisht dhe që më kujtojnë nënën Fatime... Kam dëgjuar nga vetë jetimët apo nga shumë njerëz që nuk kanë nënë ose nëpërmjet disa të tjerëve se ç'heqin jetimët. Edhe pse shumë zonja që kanë zemër të butë e të mëshirshme prej nëne, tolerancën dhe dhembshurinë që shfaqin ndaj fëmijëve të tyre, nuk mund ta shfaqin ndaj fëmijëve të të tjerëve kur ata ngelin nën përkujdesjen e tyre, nëna Fatime, e sfidoi drejtësinë. Ajo nuk ulej në sofër pa ardhur Pejgamberi dhe nuk i lejonte fëmijët të hanin derisa të vinte Ai. Ajo së pari i jepte Atij për të ngrënë, pastaj fëmijëve të saj...

Në ajetin e 6 të sures Duha, thuhet: "A nuk ishe nevojtar dhe të strehoi?". Fjala "strehim" që shprehet këtu, nuk është një strehim i rëndomtë... Ka shumë ajete në Kuranin Famëlartë që urdhërojnë mbikëqyrjen e të drejtave të jetimëve, duke filluar nga ajetin 8 i sures Insan, ku thuhet: "...Kujdesen për jetimin."

Qendra e energjisë së zemrës sime, burimi i shëndetit thotë:

"Të kujdesesh për jetimin nuk do të thotë t'i blesh dy palë rroba për Bajram. Do të thotë t'i heqësh barrën, rëndesën e problemeve të tij psikologjike..." Kjo gjendje në popull ka zënë vend duke u shprehur në këtë mënyrë: "Jetimi u dhimbset shumë njerëzve, por janë të paktë ata që e ushqejnë."

O Allah, falu mëshirë atyre që kanë nën përkujdesje jetimë!

Fal mëshirë në zemrat e tyre, në mënyrë që të kujdesen për jetimët dhe Emineve e Abdullahëve të mos u ngelet koka pas...

Bëji ata të mëshirshëm, zgjerojua të ardhurat, që të mos u vijë rëndë gjendja e jetimëve, t'u duken të këndshëm dhe t'u pëlqejnë...

Lësho mëshirë rreth tyre që fjalët përreth të mos ua rëndojnë barrën, por përkundrazi t'u lehtësohet...

Jetimi i Amines... Kur po i vdiste nëna, ai i qëndronte te koka. Sa tablo e paharrueshme dhe e dhimbshme që është kjo për një fëmijë gjashtë vjeç!.. Ç'dramë e madhe!. Sa gjendje të vështirë përjetojnë dhe do të përjetojnë jetimët, çfarëdo moshe qofshin deri në Kiamet!

Poeti thotë: "A ju ka vdekur juve babai? Mua më vdiq dhe u verbova."

Kushedi sa vjeç ishte, por me sa duket ishte burrë i madh... Sado që të jetë, kur vdesin prindërit fëmija ngel jetim... Ka edhe shembuj të këndshëm, siç është ky:

Një mikeshë tregon se kur i vdiq nëna e burrit, ajo tregohet e mëshirshme ndaj tij duke thënë me respekt ndaj Pejgamberit (a.s.): "Tashmë u bëre si Ai..."

Anadolli është vendi i grave të kulturuara, qofshin ato të ditura ose jo... Çfarë perlash fshihen në kraharorin e saj... Në njërën anë jetimët, të cilëve u plaçkitet prona e pasuria, vajza që shtypen në punë të rënda, ndërkohë që djemtë rrinë, në anën tjetër ka gjyshër fisnikë si Abdulmuttalibi, zonja si Fatma dhe xhaxhallarë si Ebu Talibi, të cilët sillen më të mëshirshëm me ta duke thënë: "Është jetim dhe e ka zemrën të brishtë", që u bëjnë mirësi më shumë se fëmijëve të tyre...

O Zot, lehtësojua sprovën dhe qetësojua zemrat!.. Ti je streha dhe mbështetja e vetme për jetimët të cilët shtypen, ngaqë nuk kanë njerëz që përkujdesen për ta...

O Zot që në ditën e gjykimit do të marrësh në llogari secilin prej nesh, mëshiroji jetimët dhe ata të cilët përkujdesen për ta... Amin!..



Lumturia në familje

Zahide Topçu

Lumturia në familje është një temë shume rëndësishme. Nuk ka rëndësi gjinia, sepse çdo burrë apo grua që është i/e lumtur në familje përhap lumturi në çdo ambient që e rrethon. Ndërsa njeriu që nuk ka lumturi në familje është gjithmonë i mërzitur dhe i shqetësuar.

Allahu (xh.sh.), i ka krijuar të gjitha gjallesat në çift dhe secili ka nevojë për tjetrin. Edhe njerëzit janë krijuar në çift, dhe partneri është gjithmonë pjesë e pandarë dhe plotësuese e partnerit tjetër.

Mendja e një njeri mund të kuptohet duke vëzhguar gjërat që ai dëshiron të arrijë. Një grua e zgjuar nuk është e dhënë pas rehatisë të kësaj bote dhe pas të mirave që ajo mund të ofrojë, prandaj ajo do të jetë e lumtur edhe në qoftë se jeton në pallate mbretërore, edhe në qoftë se jeton në kasolle. Sado të bukura të jenë të mirat e kësaj bote një ditë do t'u vijë fundi dhe gjithsesi ato kanë të meta, prandaj nuk mund ta kënaqin kurrë zemrën e një njeriu. Gjëja e vetme që të jep qetësi është besimi në Allah dhe nënshtrimi para Tij. Asnjë gjë tjetër nuk mund ta lumturojë shpirtin.

Burrat gjithashtu nuk duhet ta kërkojnë lumturinë tek puna dhe karriera. Të dyja këto sjellin me vete shumë ankth dhe vështirësi.

Lumturia në familje vjen në çastin kur bashkëshortët e dëgjojnë njëri- tjetrin dhe përpiqen të kuptojnë se çfarë janë gjërat që mund ta bëjnë tjetrin të lumtur. Gruaja duhet të kuptojë dëshirat e burrit të vet dhe me aq sa ka mundësi duhet t'i plotësojë ato; kurse burri duhet të gjejë rrugë për të arritur tek zemra e gruas së vet.

Gruaja e mirë është si një lule që përhap aromë të këndshme rreth e rrotull. Gruaja duhet të tregohet e zgjuar dhe ta bëjë për vete burrin dhe familjen e tij. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë gjë, është duke qenë e bindur ndaj burrit dhe e kujdesshme me fëmijët. Krenaria dhe kokëfortësia nuk të sjellin asnjë gjë të mirë.

Gruaja e mirë dhe e zgjuar është një thesar i paçmuar. Burri duhet ta dijë vlerën e një gruaje që i njeh Allahun dhe Resulallahun, që e bën më së miri detyrën e vet ndaj fesë, që ka respekt ndaj burrit të vet dhe që e mbështet burrin në punët e tij. Në qoftë se burri nuk ia di vlerën, le të frikësohet se mund të mbesë pa të, sepse gjërat që nuk ua din vlerën, të merren.

Në martesë burri dhe gruaja duhet të jenë si një mbulesë që fsheh mangësitë dhe problemet e tjetrit. Ata duhet ta mirëkuptojnë njeri- tjetrin dhe të mundohen që t'i falin gabimet. Edhe problemi më i vogël në qoftë se diskutohet shumë, zmadhohet dhe ne jemi dëshmitarë se si janë shkatërruar familje nga një zënkë krejt e vogël. E kundërta ndodh tek familjet e zgjuara, të cilat edhe problemet më të mëdha i zvogëlojnë aq shumë derisa të zhduken krejtësisht.

Fëmijët të cilët rriten në familje në të cilat mbizotëron paqja dhe dashuria janë të lumtur. Ata nuk janë njerëz të stresuar dhe nuk kanë mllef apo urrejtje për njerëzit.

Prindërit në fillim duhet të kenë kujdes sjelljet e tyre, sepse në atë mënyrë do të bëhen shembull i mirë për fëmijët e tyre. Fëmija e mëson në familje dashurinë për nënën dhe babanë, mirësjelljen dhe edukatën ndaj njerëzve të tjerë, respektin ndaj më të mëdhenjve dhe mëshirën ndaj më të vegjëlve.

Shtëpitë tona duhet të bëhen çerdhe në të cilat të mësohet feja jonë. Në to duhet të flitet për Allahun dhe të Dërguarin e Tij në çdo moment. Nëna dhe babai, që janë mësuesit më të rëndësishëm, nuk duhet të harrojnë që t'u mësojnë fëmijëve të tyre shembullin më të mirë të njerëzimit.

Shkurtimisht mund të themi se lumturia që ndodhet brenda zemrës duhet të përçohet në familje, kurse lumturia në familje duhet të kalojë edhe në rrugë e kudo. Zemra e myslimanëve duhet të jetë e mbushur me mëshirë, dashuri dhe paqe. Allahu i begatoftë edhe shtëpitë tona me këto të mira. Amin.

Përgatitja e disa ushqimeve themelore

Dr. Betyl Inall

Në kohën kur foshnjat arrijnë në muajin e 4-6 nënat fillojnë të bëjnë këto pyetje:

- Cilat janë produktet me të cilat duhet ta filloj ushqimin e fëmijës tim?

- Sa herë në ditë duhet ta ushqej?

- Si duhet ta përgatis ushqimin e fëmijës tim dhe sa duhet t'i jap?

- Çfarë duhet të bëj, në qoftë se ushqimi i shkakton alergji fëmijës etj.

Një pjese të këtyre pyetjeve jam përpjekur t'u jap përgjigje në shkrimet e mia, kurse në këtë material do të flas për përgatitjen e disa ushqimeve themelore.

Lëng dhe pure frutash

Fruta si molla, pjeshka dhe dardha lahen dhe u hiqet lëkura. Grihen në grirëse xhami, pastaj kullohen në një shami të hollë. Në fillim jepet nga 1 ose 2 lugë ëmbëlsire nga lëngu i frutave dhe me kalimin e kohës kjo sasi rritet.

Për të bërë pure frutash nuk e kullojmë





lëngun e frutave të grira. Banania mund të jepet pasi është shtypur me pirun. Në kohët e para i jepet 1/3 e bananeve të mëdha. Fëmijës mund t'i jepet edh përzierje: mollë- dardhë ose dardhë-banane. Këto përzierje janë të këndshme dhe fëmija juaj do t'i pëlqejë ato. Brenda lëngut të frutave dhe puresë nuk duhet hedhur sheqer.

Supë dhe pure me perime

Përbërësit: një karotë e vogël, një patate, dy gota ujë.

Në fillim karota dhe patatja lahen. Pasi u pastrojmë lëkurën karotës dhe patates, i ndajmë ato në pjesë të vogla dhe i vendosim në një tenxhere të cilës i hedhim dy gota ujë; presim sa të zbuten. I kalojmë nga një sitë metalike. Si fillim, fëmijës i jepet një ose dy lugë pastaj dalëngadalë rritet sasia.

Fëmija, që në javën e parë ushqehet me supë perimesh, javën e dytë mund të ushqehet edhe me pure perimesh.

Supa me perime fillon me patate dhe me karota. Në javët në vazhdim mund t'i shtoni spinaq, majdanoz, lakra, rrepë dhe pak oriz, makarona ose gjëra të ngjashme.



Në fundin e një muaji supës mund t'i shtoni dhe një lugë të vogël vaj ulliri dhe një lugë gjelle mish të grirë viçi. Me anë të mishit të grirë ju e pasuroni atë me proteina dhe me kalori. Mishi i grirë mund të jepet edhe në formë qofteje.

Muhalebi

Përbërësit: një gotë qumësht, tri lugë të vogla miell orizi, tri lugë të vogla sheqer ose muhalebi e përgatitur në një gotë uji dhe gjashtë masa pluhur.

Para moshës një-vjeçare nuk është e mirë që të përdoret qumësht lope. Le të përshkruajmë përgatitjen e muhalebisë:

Përzieni një gotë qumësht dhe miellin e orizit dhe vendosini në zjarr derisa të bëhet një masë kremi. Pak para se ta largoni nga zjarri shtoni sheqerin. Muhalebia mund të bëhet edhe nga ushqim pluhur i gatshëm. Ngrohni muhalebinë e bërë nga një gotë ujë dhe hidhni brenda 6 masa pluhur. Jepet nga mosha 5-6 muajshe.

Kosi

Përbërësit: 100 ml ushqim i gatshëm, një lugë çaji kos.

Për fëmijët më të mëdhenj se një vjeç: 200 ml qumësht, një lugë ëmbëlsire kos.

Për fëmijët deri në një vjeç ushqimi duhet përgatitet për një ditë. 100 ml qumështi të gatshëm i shtojmë 1 lugë çaji kos dhe e lëmë që të vijë për 3-4 orë. E lini në frigorifer për 2-3 orë.

Kur fëmija kalon moshën një-vjeçare përgatitet me qumësht lope. Vloni 200 ml qumësht. Prisni që të arrijë një nxehtësi që e duron dora juaj. Shtoni një lugë ëmbëlsire kos.

Foshnjat që ushqehen në mënyrë natyrale mund të konsumojnë kos që nga mosha 5 ose 6 muajshe. Kosi është më i dobishëm në qoftë se e lini të presë një ditë dhe pastaj e konsumoni.

Pureja e frutave dhe përzierjet e kosit do të jenë një vakt shumë i këndshëm për foshnjën tuaj. Mënyra më e lehtë për ta përgatitur një ushqim të tillë është të shtypni bananen dhe ta përzieni me kos. Fëmijës suaj do t'i pëlqejë shumë kjo shije.



XHINXHERI ME MJALTË

Xhinxheri dhe mjalti mund të konsumohen në formën e tonikut apo shurupit. Kjo arrihet duke krijuar një përzierje të dy ingredientëve duke i holluar pak me ujë. Ky lëng i vjen në ndihmë aparatit tretës për shkak të vlerave fantastike të xhenxhefilit. Për më tepër, si xhenxhefili ashtu edhe mjalti kanë vlera antioksidante, dhe si rrjedhojë rrisin fuqinë e sistemit imunitar. Mjafton një lugë me tonik mjaltë dhe xhenxhefil që njerëzit që kanë një sistem tretës të dobët, të ndihen më mirë. Përgatitja është mjaft e thjeshtë. Vloni një enë me 500 ml ujë dhe shtoni xhinxherin e prerë në rriska. Rreth 10 cm gjatësi rrënje xhinxheri është e mjaftueshme. Xhinxheri vlon në ujë për 5-7 minuta dhe më pas hiqet nga zjarri dhe lihet të ftohet pak. Shtohet rreth 200 ml mjaltë dhe pasi të ftohet e gjithë përzierja mund të ruhet në frigorifer dhe të konsumohet çdo ditë. Në ditët kur imuniteti është në rënie një gjysmë gote nga ky shurup do të mjaftojë. Toniku me xhenxhefil dhe mjaltë ka një nivel të lartë proteinash e si rrjedhojë ndihmon sistemin tretës, stimulon shpërbërjen e yndyrave. Nga ana tjetër, toniku stimulon rritjen e florës intestinale që përshpejton tretjen dhe lehtëson lëvizjet e zorrëve. Së fundmi, toniku me mjaltë dhe xhenxhefil ka aftësinë të thithë përbërësit e tjerë nga ushqimi dhe të reduktojë mbetjet. Toniku mund të përdoret edhe nga fëmijët për t'i qetësuar nga dhimbjet e stomakut. Toniku është një zgjidhje që të qetëson se sa një kurë e mirëfilltë medicinale. Për këto arsye, dhe shumë të tjerë shumë njerëz në mbarë botën, mbajnë gjithmonë xhenxhefil dhe mjaltë në shtëpinë e tyre dhe përgatisin këtë pastë sa herë që kanë kollë ose ftohen. Karamelet me xhenxhefil dhe mjaltë janë gjithashtu një variant shumë popullor i kësaj përzierje magjike. Nëse keni fytin të acaruar dhe nuk jeni në gjendje të flisni, atëherë duhet të konsumoni këto karamele me xhenxhefil dhe mjaltë dhe fyti juaj do të shërohet menjëherë. Përfitimet shëndetësore të mjaltit dhe xhenxhefilit në kurimin e sëmundjeve respiratore nuk kanë të krahasuar. Ndoshta nuk e dinit, por mjalti është një ndërmjetësues i shkëlqyeshëm për të transmetuar vlerat e barishteve dhe erëzave si xhenxhefili apo xhinxheri në organizëm. Si mjalti ashtu edhe xhenxhefili kanë vlerat e tyre të veçanta, por kombinimi i të dyjave i jep organizmit një bonus shtesë. Mënyra më e mirë për të konsumuar mjaltë dhe xhenxhefil është të përziesh një lugë me lëngun e xhenxhefilit dhe një lugë mjaltë. Vlerat e mjaltit me xhenxhefil Shëndeti i zemrës: Toniku i mjaltit dhe xhenxhefilit është plot antioksidantë që zbusin sjelljen agresive të substancave të quajtura prostaglandin. Këto substanca përthithen nga acidet e yndyrës në formën e enzimave. Prostaglandinat gjenden në të gjithë trupin dhe ndihmojnë funksionet e të gjithë organeve. Sa i përket shëndetit të zemrës, toniku i mjaltit dhe xhenxhefilit zbut çrregullimet e enëve të gjakut, ul tensionin e gjakut dhe rrezikun e sëmundjeve si arterosklerozës dhe atakut në zemër. Asma: Besohet se përzierja e mjaltit me xhenxhefil dhe piper të zi mund të trajtojë ose të minimizojë efektet e astmës. Ky kombinim është natyralisht çlirues dhe anti inflamator dhe rregullon fluksin e oksigjenit në mushkëri dhe relakson enët e gjakut në mushkëri. Problemet e frymëmarrjes: Përzierja e mjaltit me xhenxhefil është një variant natyral i një medikamenti që rrit sekrecionet e bronkeve dhe pastron mushkëritë nga mukusi. Kjo do të thotë se mjalti me xhenxhefil ofron çlirim të menjëhershëm për njerëzit që vuajnë nga kolla, i ftohti, fyti i tharë dhe rrufa. I nevojshëm në betejën kundër kancerit: Mjalti me xhenxhefil arrin të reduktojë të vjellat dhe të përzierat që shkaktohen nga kurat e kemioterapisë pas diagnostikimit me sëmundjen e kancerit. Këto procedura janë aq intensive sa shkaktojnë shumë të vjella tek pacientët të cilët detyrohen të përdorin zgjedhje alternative. Xhenxhefili përshpejton zbrazjen e stomakut sepse ka aftësi në përmirësimin e tretjes. Në këtë mënyrë ndjesia e të vjellës reduktohet. Të përzierat nga kemioterapia shkaktohen si pasojë e cisplatinës, një përbërës i kurës. Xhenxhefili arrin të balancojë efektet e këtij përbërësi. Xhenxhefili gjithashtu sugjerohet të përdoret nga gratë shtatzënë sepse redukton të vjellat dhe të përzierat si pasojë e shtatzanisë. Nëse e kombinojmë me efektet natyrale të mjaltit, të dyja ofrojnë një zgjedhje të mirë për të parandaluar këto dy simptoma të shkaktuara nga një sërë burimesh të ndryshme .



FRUTAT DHE PERIMET QË NGJAJNË ME ORGANET NJERËZORE

Po t'i hedhim një sy formës sonë trupore dhe formës së frutave dhe perimeve do të shohim një ngjashmëri befasuese që provon më së miri shprehjen e mësipërme. Nëse shikon pjesën e brendshme të karrotës nga larg do të duket sikur ajo i ngjan syrit. Sa më shumë t'i afrohesh, aq më shumë do të dallosh tiparet e irisit të syrit dhe bebes së syrit. Patatja e ëmbël nga ana tjetër ka ngjashmëri të madhe me pankreasin, por nuk është ngjashmëria ajo që e bën këtë perime shumë të shëndetshme për këtë organ. Xhenxhefili i ngjan stomakut. Por ka edhe shembuj të tjerë të ngjashmërisë së formave të ushqimeve me organet e trupit të njeriut. Arrat ngjajnë me trurin, arrat kanë dy hemisfera, një mburojë si një kafkë dhe nyje plot. Një arrë e zakonshme ngjan jashtëzakonisht me trurin në shumë nivele. Dhe truri i njeriut është ai që përfiton më shumë nga arrat. Këto të fundit janë të vetmet ndër frutat arrore që përmbajnë sasi të mëdha Omega 3 që mbrojnë funksionet e trurit, sidomos po të kihet parasysh që truri i gjitarëve përbëhet dhe ka nevojë për të njëjtat acide. Karotat ngjajnë me sytë pjesa e brendshme e karotës i ngjan syrit të njeriut deri në perfeksion. Po ta shohësh nga larg mund të dallosh edhe formën komplekse të irisit. Karrotat janë tejet të pasura me beta karoten që luftojnë kataraktin e syrit dhe degjenerimin e shikimit si pasojë e moshës (një simptomë që prek 25% e njerëzve mbi moshën 65 vjeçare). Rrushi ngjan me mushkëritë, degët me rrush të kujtojnë kapilarët dhe flluskat e vogla që gjenden në bronket e që njihen ndryshe si qeset e mushkërive të cilat ndihmojnë kalimin e oksigjenit nga mushkëritë në gjak. Rrushi njihet për aftësitë e tij në uljen e rrezikut të kancerit të mushkërive dhe përbërësit që gjenden në farat e rrushit minimizojnë rrezikun e astmës së shkaktuar nga alergjitë. Domatet ngjajnë me zemrën Ashtu si zemra e njeriut, edhe domatet janë të kuqe dhe zakonisht përmbajnë katër ndarje. Domatet janë një burim i pasur i lykopenit që parandalon sëmundjet koronare dhe që neutralizon efektet e dëmshme të kolesterolit të keq. Për më tepër, domatet janë të pasura me folat që ndihmojnë prodhimin e qelizave të kuqe që përcjellin oksigjenin, të njëjtat qeliza që kalojnë përmes zemrës nëpër të gjithë trupin. Avokadot ngjajnë me organin femëror të riprodhimit Fruti i avokados ka formën e organit të riprodhimit femëror. Ky frut ka nevojë për nëntë muaj që të çelë e të piqet. Në zemër të tij ka fara çuditërisht të mëdha që përngjasojnë me fetusin në organin e femrës. Avokado është një burim i pasur me acid folik. Studimet kanë treguar që nëse një grua ha një avokado në javë, hormonet e saj janë më të balancuara, mund të humbasë peshën e akumuluar gjatë shtatzanisë dhe parandalojë kancerin e qafës së mitrës. Portokalli ngjan me gjirin. Portokalli kanë ngjashmëri të madhe me gjinjtë e femrës. Ato janë gjithashtu të rëndësishëm për shëndetin e gjinjve, lëvizjen e limfës (një lëng i qartë që mban produktet e mbeturinave të indeve dhe qelizat e sistemit imunitar (mbrojtës) brenda dhe jashtë gjoksit. Ngjashmëria mes frutave si portokalli apo qitro me gjinjtë mund të jetë thjesht rastësi. Qitro përmban substance të njohura si limonoidë që parandalojnë zhvillimin e kancerit tek kafshët dhe qelizat e gjirit tek njeriu. Fasulet ngjajnë me veshkat Fasulet shërojnë dhe mbrojnë funksionet e veshkave. Për më tepër ato kanë të njëjtën formë si ky organ. Selinoja ngjan me kockat. Selinoja trung-gjatë ngjan me kockat dhe padyshim u bën mirë atyre. Selinoja ka aftësi t'u japë kockave shumë forcë. Selinoja është burim i pasur silikoni që është pjesë e strukturës molekulare për të cilën kockat kanë nevojë që të jenë të forta. Një tjetër rastësi e çuditshme është që kockat kanë 23% sodium dhe selinoja ka po aq. Nëse ju mungon sodiumi në dietën tuaj atëherë trupi e merr nga kockat duke i dobësuar ato. Bimë të tilla plotësojnë nevojat e kockave dhe të trupit. Kërpudhat ngjajnë me veshët Nëse pret një kërpudhë përgjysmë do të shohësh që ka formën e veshit të njeriut. Konsumimi i kërpudhave përmirëson dëgjimin thonë ekspertët. Kërpudhat janë ndër të paktat ushqime që përmbajnë vitamin D. Kjo vitaminë është e rendësishme për kocka të shëndetshme, edhe për ato më të voglat fare që ndodhen në vesh që shërbejnë për përçimin e tingujve në tru. Shembuj të tjerë Xhenxhefili- Një copë xhenxhefil ngjan me stomakun, dhe një nga vlerat e tij ka të bëjë pikërisht me qetësimin e stomakut. Patatet e ëmbla – Ato kanë ngjashmëri të madhe me pankreasin. Patatet e ëmbla ndihmojnë në stabilizimin e nivelit të sheqerit në gjak tek diabetikët.



GJUMI, MISTERET E NJË TË TRETËS SË JETËS

Është nata ajo që i jep kuptimin ditës. Dhe falë gjumit që bëjmë natën përvojat e ditës marrin dhe gjejnë një kuptim dhe kanë një logjikë.

Pyetja që dukej se ishte e destinuar për të mbetur pa një përgjigje (përse flemë?) po shndërrohet në fakt në një pus të vërtetë të mbushur me mrekulli për shkencën dhe kjo hap pas hapi ndërsa eksperimentet shkencore nxjerrin në pah rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë për mirëqenien dhe vetë jetën tonë, orët e errësirës së natës.

Në fakt të jetosh pa gjumë është e pamundur dhe kjo jo vetëm në aspektin e lodhjes fizike. Nëse nuk do të ishte gjumi, pra pauza mes ditëve, atëherë nuk do të ekzistonte as reflektimi dhe as ndarja e ngjarjeve nga njëra-tjetra.

Ndërsa gjatë gjumit truri ynë përjeton dhe përpunon të gjitha përvojat e ditës. I çmonton, i kategorizon dhe i vendos ato në zona të ndryshme të tij. Dhe aty qëndrojnë në formën e kujtimeve për rreth një muaj, një vit, apo për gjithë jetën sipas rëndësisë së tyre apo impaktit emotiv që na kanë lënë.

Ky lloj spastrimi është ajo ndjesi që në mëngjes e quajmë "çlodhje", apo "mendje të lehtë". Pa këtë rregullim që bëhet gjatë natës në trurin tonë do të mbizotëronte rrëmuja dhe ne vetë nuk do të përjetonim kurrë ndjenjën e mirë dhe të këndshme e plot energji që na dhuron në mëngjes një gjumë i mirë natën. Dhe për më tepër të gjitha përvojat e një dite më parë do të përfundonin në një kosh të madh dhe të paformë me pak mundësi për t'u rikuperuar më pas.

Por mrekullitë e gjumit nuk marrin fund këtu.

Sipas profesorit të shkollës mjekësore në Harvard i cili studion gjumin e njeriut përmes vullnetarëve që flenë në klinikën e tij, gjumi është një magji më vete. Robert Stickgold që konsiderohet si një nga pionierët e studimeve në lidhje me funksionimin e gjumit tregon se organizmi ynë i të menduarit, gjatë natës, nuk kufizohet vetëm në rregullimin, pra vendosjen rregull në tërësinë e ngjarjeve që përjetojmë gjatë ditës, por në shumë më tepër.

Sipas tij ajo çka truri njeh në mëngjes është shumë më tepër se tërësia e kujtimeve të një nate më parë. Gjatë natës bëhet përpunimi i përvojave dhe në një farë mënyre integrimi i përvojave të reja jetësore me ato të vjetra.

Ndërkohë, mund të thuhet se jo vetëm që gjumi shërben për të organizuar dhe klasifikuar përvojat e ditës, por dhe përvojat e ditës shërbejnë për të na dhënë ose jo një gjumë të mirë pra në cilësinë e tij. Kështu për shembull, veprimtari të ndryshme shkaktojnë gjumë të ndryshëm. Kur jemi para një provimi apo një gare sportive edhe lloji i gjumit është i ndryshëm krahasuar me rastin kur jemi të qetë dhe mund të ndodhemi për shembull para një dite pushimi. Gjumi është një nga tri shtyllat kryesore të shëndetit të njeriut së bashku me dietën në radhë të parë dhe ushtrimet fizike në radhë të dytë.

Gjumi jo vetëm që zë një të tretën e jetës sonë, por na bën edhe më inteligjentë. Ndërkaq, na mban edhe në formë dhe na ruan nga sëmundje të ndryshme të zemrës, të cilat në mungesë të tij do të agravoheshin dhe do të ishin më të shpeshta.

Kështu, mungesa e gjumit, ose mos ngopja me

gjumë e rrit hormonin e grelinës që është i lidhur me oreksin dhe ul atë të leptinës që ka të bëjë me ngopjen. Mungesa e pushimit jo vetëm aktivizon gjithë mekanizmin e stresit, por krijon edhe probleme të vërteta fizike. Lidhja mes gjumit, obezitetit dhe të ushqyerit është shumë më e madhe nga sa mendojmë.

Ka nga ata që flenë gjatë, nga ata të cilëve u flihet në mënyrë të vazhdueshme dhe nga ata që kanë një marrëdhënie të vështirë dhe shpesh të përvuajtur me gjumin për arsye nga më të ndryshmet.

Ekspertët thonë se, nëse një individ fle më pak se 7 orë në ditë, atëherë ai ka një rrezik shumë të madh që të ndikojë për keq në shëndetin e tij. Por kjo nuk vlen për të gjithë, sepse ka njerëz që vetëm me pak orë gjumë, arrijnë që të jenë jo vetëm në shëndet të mirë mendor dhe fizik, por shumë aktivë dhe prodhimtarë edhe në veprimtaritë dhe karrierën e tyre.

Për shumicën nga ne, çdo orë që është para orës pesë të mëngjesit mund të konsiderohet fare mirë si "mesi i natës", pra një kohë gjatë së cilës duhet fjetur dhe parë ëndrra.

E megjithatë ka njerëz që çohen rregullisht, e madje të ngopur me gjumë shumë më herët, të themi në orën katër të mëngjesit. Dhe këtë nuk e bëjnë sepse kanë krijuar një zakon të kushtëzuar nga ndonjë punë që u është dashur ta kryejnë kaq herët. Jo. Arsyeja është e thjeshtë dhe e qartë.

Në këtë orë, ata çohen, sepse janë të ngopur me gjumë, pra kanë marrë atë sasi gjumi që u duhet për të vazhduar të qetë dhe me cilësi veprimtarinë e tyre "zgjuar". Madje, zgjime të tilla nuk ndodhin vetëm gjatë ditëve të punës, por edhe gjatë fundjavave, apo pushimeve të gjata të vitit. Por ndërkohë që do të mendoni se nëse këta njerëz çohen kaq herët, atëherë duhet që domosdoshmërisht të bien herët edhe në darkë.

Do të befasoheni kur të dëgjoni se kategoria e njerëzve për të cilët po flasim bie në gjumë ekzaktësisht pas mesit të natës, pra gjithsej i takon që të flenë vetëm katër orë.

Dhe në vend që në raste të tjera këta njerëz të ishin plot nerva dhe me mungesa të theksuara të përqendrimit, siç u ndodh personave që nuk janë ngopur me gjumë, në të kundërt ata janë brilantë dhe të kthjellët si të kishin fjetur gjatë gjithë ditës.

Dhe janë edhe shumë rezultativë në punën që bëjnë. Njerëz të tillë nuk e kanë të nevojshme që ta nxisin veten për të qenë në një formë të tillë. Ata thjesht janë ashtu në mënyrë të natyrshme. Nga mjekët, ose më mirë nga specialistët njihen me termin "gjumëpakët" dhe për ta janë plotësisht të mjaftueshme katër orë gjumë. Maksimumi pesë në rastet ekstreme. Ata nuk kanë nevojë as për kafeinë, apo për ndonjë produkt tjetër, për të qenë në gjendje "esëll". Dhe sikur ky "bekim" të mos mjaftonte, ata janë edhe shumë "elegantë" zakonisht. Disa shkencëtarë nga Kalifornia kanë zbuluar së fundi një lidhje gjenetike.

Kështu, në shumë raste, nëna dhe vajza kanë të njëjtat zakone përgjumjeje, pra ose janë nga ata të zakonshmit që bien herët dhe çohen vonë, ose bëjnë pjesë në atë "elitë" qeniesh që bien shumë vonë dhe çohen herët, duke qenë në formë shumë të mirë. Në këtë rast, kemi të bëjmë me të njëjtin variacion gjenetik, si te nëna edhe te vajza.

Ky lloj gjeni mendohet që është i pranishëm 2 deri në 3 për qind të popullsisë së planetit. Pra është një gjen shumë i rrallë dhe si pasojë edhe i çmuar. Ata që flenë kaq pak, zakonisht janë edhe shumë të motivuar, energjikë, çka mund të shpjegojë edhe faktin se shpesh njerëz të mëdhenj, të cilët kanë arritur shumë në jetë dhe kanë pasur jetë intensive, kanë qenë persona që kanë bërë pjesë në kategorinë e atyre që flenë shumë pak dhe që zakonisht çohen në orët e para të ditës.

Një nga ata ka qenë edhe Margaret Theçer që zakonisht shquhej për rezistencën që kishte ndaj seancave dhe debateve të gjata politike në Parlament dhe në qeveri.

Një tjetër njeri me një "dhunti" të tillë ka qenë Leonardo da Vinçi, i cili nuk flinte kurrë më shumë se pesë orë në ditë.

E megjithatë, pjesa më e madhe ndër ne e dinë mirë se të paktën pa shtatë orë gjumë nuk është e mundur që të përballosh një ditë pune me përqendrimin e duhur.

Por cili është sekreti i orëve të pakta të gjumit?

Ka shumë nga ata që e konsiderojnë gjumin humbje kohe. Në një familje ku një baba ka një mundësi të tillë dhe çohet herët, edhe fëmijët si pasojë përpiqen që të kenë të njëjtën marrëdhënie ndaj gjumit. Ky është një rast kur ky zakon mund të ushtrohet dhe të krijohet, edhe pse jo gjithmonë është i suksesshëm.

Rastet e suksesshme zakonisht kanë të bëjnë me faktorin gjenetik. Por ndërsa ky fenomen, apo ky tipar është shumë i rrallë dhe "pasuri" e pak personave, njerëzit e zakonshëm, pra shumica, duhet patjetër që të bëjnë shtatë orë gjumë çdo natë.

Marrëdhënia me gjumin është gjithnjë personale dhe nuk duhet që të forcojmë veten që të jemi ata që nuk jemi apo të bëjmë ato gjëra që në fakt do të na dëmtonin, edhe pse të tjerët nuk dëmtohen. Në rast të kundërt do të rrezikonim shëndetin.

O njerëz!
Ne ju krijuam ju
prej një mashkulli
dhe një femre dhe
ju bëmë popuj e fise,
për ta njohur
njëri-tjetrin.
Më i nderuari
tek Allahu është
më i devotshmi.
Vërtet, Allahu
është i Gjithëdijshëm
dhe për Atë asgjë
nuk është e fshehtë.

(Huxhurat, 13)



ISSN 2227-3611